



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

RAPORTI NË HIJE PËR **KAPITULLIN 23**

PËR PERIUDHËN TETOR 2023 – SHTATOR 2024



RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2023 – SHTATOR 2024



RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2023 – SHTATOR 2024

Botues:

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Për botuesen:

Dr. Simonida Katsarska

Redaktore:

Dr. Simonida Katsarska

Autore:

Angella Delevska

Beba Zhagar

Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, Dhjetor 2024



Ky raport në hije është hartuar në kuadër të projektit “Ndërtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit nga pikëpamja e anëtarësimit në BE”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Hyrje	7
Metodologjia	9
1. Gjyqësori	10
Dokumente strategjike	11
Organet drejtuese	13
Pavarësia dhe paanshmëria	20
Përgjegjësi	29
Profesionalizmi dhe kompetenca	35
Cilësia e drejtësisë	40
Efikasiteti	47
2. Lufta kundër korrupsionit	53
Kadri institucional	56
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit	56
Prokuroria Publike	60
Kadri ligjor	65
3. Të drejtat themelore	68
Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut	70
Avokati i Popullit	72
Tortura ose lloj tjetër i trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese	74
Burgje dhe paraburgime	76
Mbrojtja e të dhënave personale	79
Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	81
Liria e shprehjes	83
Presioni mbi gazetarët	84
Të drejtat e fëmijës	86
Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit	88
Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	88
Persona me aftësi të kufizuara	91
Gjinia	94
Gjuha e urrejtjes	96
Vepra të urrejtjes	97
LGBTI+	98
Romët	99
Bibliografi	102

Lista e shkurtësive

ASHMAA	Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele
AMDP	Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale
AKMIS	Sistem i automatizuar informatash për menaxhim me lëndët gjyqësore
AGJPP	Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GRECO	Grupi i shteteve kundër korrupsionit
ESHS	Enti Shtetëror i Statistikës
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ENER	Regjistri i vetëm kombëtar elektronik i rregulloreve
EPI	Instituti për Politikë Evropiane
ERA	Akademia e së Drejtës Evropiane
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IRI	Instituti Ndërkombëtar Republikan
IRL	Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese
PPRMV	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
LGBTI	Komuniteti lezbik, homoseksual, biseksual, trans dhe interseks
AMSHA	Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
SHMJR	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
AIM	Agjencia Informative Mediatike
MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MRT	Radiotelevizioni Maqedonas
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
OJQ	Organizatë joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
LSDM	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
PSP	Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe rezultojnë nga përmbytja e monitorimit të paligjshëm të komunikimeve (Prokuroria Speciale Publike)
KPPRMV	Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut
SPGM	Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve të medias
KGJRMV	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
DSK	Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim
DULA	Drejtoria për udhëheqjen e librave amë
Sindikata e PAOGJSHQ	Sindikata e Punonjësve të Administratës, Organeve Gjyqësore dhe Shoqatave Qytetare të Republikës së Maqedonisë
DPF	Drejtoria e Policisë Financiare
KHDNJ	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Hyrje

Ky raport në hije bashkon në një tërësi të vetme koherente të gjitha gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet që dolën nga monitorimi i fushave të përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Ky është raporti i nëntë i tillë i publikuar nga Instituti për Politika Evropiane - Shkup (EPI), duke marrë parasysh komentet dhe opinionet e institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare. Tetë periudhat e mëparshme mbulojnë periudhat në vijim: tetor 2014 – korrik 2015,¹ korrik 2015 – prill 2016,² maj 2016 – janar 2018,³ qershor 2018 – mars 2019,⁴ prill 2019 – mars 2020,⁵ prill 2020 – shtator 2021,⁶ tetor 2021 – shtator 2022⁷ dhe tetor 2022 – shtator 2023.⁸

Raporti mbulon periudhën nga fillimi i tetorit 2023 deri në fund të shtatorit 2024. Ai përfshin gjithashtu të dhëna relevante nga periudha para tetorit 2023, kur ato janë të nevojshme për kontekstualizimin ose sqarimin e risive të periudhës aktuale raportuese. Periudha e raportimit është e harmonizuar me periudhën raportuese të Komisionit Evropian (KE) për Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Ky draft-raport ndjek strukturën e Kapitullit 23 të raportit të KE-së, duke siguruar një qasje të sistemuar dhe të krahasueshme. Në fund të çdo fushe, brenda një kornize të veçantë, janë paraqitur rekomandimet përkatëse.

- 1 Neda Čalovska et al., “Gjyqësori dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë” („Правосудството и темелните права во Република Македонија”), (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2015) <https://epi.org.mk/docs/Analiza_Mreza.pdf>.
- 2 Neda Čalovska, Voislav Stojanovski dhe Aleksandar Jovanovski, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga korriku 2015 deri në prill 2016” („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот од јули 2015 до април 2016 година”), (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2016) <https://epi.org.mk/docs/Izvestaj_mk.pdf>.
- 3 Velimir Dellovski et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga maji 2016 deri në janar 2018”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот од мај 2016 до јануари 2018 година”) (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2018) <https://epi.org.mk/docs/Mreza23_izvestaj%20vo%20senka_2018.pdf>.
- 4 Iva Conevska et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën Qershor 2018 – Mars 2019” („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот јуни 2018 – март 2019 година”), 2019.
- 5 Iva Conevska dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën qershor 2019 – mars 2020”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот јуни 2019 – март 2020”), Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 2020, <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/Izvestaj_vo_senka_2020.pdf>.
- 6 Iva Conevska Vangellova dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2020- shtator 2021”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот април 2020- септември 2021”), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 16 dhjetor 2021), <https://epi.org.mk/post/20027>.
- 7 Angella Delevska dhe Beba Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022”), 29 dhjetor 2022, <https://epi.org.mk/post/23011>.
- 8 Angella Delevska dhe Beba Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот октомври 2022 – септември 2023”), 29 dhjetor 2023, <https://epi.org.mk/post/23011>.

Periudha raportuese u shënua nga përgatitja e Agjendës së Reformave të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor,⁹ që është një paketë gjithëpërfshirëse masash për arritjen e objektivave të parashikuara në fushat prioritare të dakordësuara me KE, përfshirë sundimin e ligjit. Në të njëjtën kohë, periudha u shënua nga zgjedhjet presidenciale¹⁰ dhe parlamentare¹¹, formimi i një qeverie të re,¹² si dhe zgjedhjet evropiane dhe propozimi i një ekipi të ri komisionerësh, duke përfshirë një Komisioner të ri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin.¹³ Takimet paszgjedhore të strukturave të reja qeverisëse konfirmuan qëndrimet dhe kriteret e vendosura të të dyja palëve¹⁴ me të cilat procesi i anëtarimit i Maqedonisë së Veriut mbetet i bllokuar.¹⁵

Ky raport në hije është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE”. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe synon të ndihmojë në krijimin e reformave të qëndrueshme për sundimin e ligjit në drejtim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

9 “Agjenda reformuese për Maqedoninë e Veriut 2024-2027”, (Реформска агенда на Северна Македонија 2024-2027), Ministria e Çështjeve Evropiane, 6 nëntor 2024, <https://mep.gov.mk/en/post/?id=15800>.

10 Paraqitja e Rezolutës për thirrjen e zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë së Veriut, (Извештај за состојбите и условите во казнено-поправните установи во 2023 година), 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1LgvXvn7-cx3lWbxLchlxEZY0cjyiKqYB/view>.

11 Paraqitja e Rezolutës për thirrjen e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, (Достава на Решение за распишување избори за пратеници во Собранието на Република Северна Македонија), 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1XP6jrSKDr-BVIDuMAwCJqBGAK88qbx2g/view>.

12 “Qeveria i paraqet para Kuvendit emrat e zëvendësministrave, kabineti qeveritar po kompletohet”, (Владата предложи до Собранието имиња на заменици министри, владиниот кабинет се комплетира), TV 21, 17 korrik 2024, <https://mk.tv21.tv/vladata-predlozhi-do-sobranieto-imina-na-zamenitsi-ministri-vladiniot-kabinet-se-kompletira/>.

13 “Deklarata për shtyp e Kryetares Ursulla Von Der Lejen mbi përbërjen e ardhshme të kolegjit të Komisionerëve”, (Press Statement by President von Der Leyen on the next College of Commissioners), Komisioni Evropian, 17 shtator 2024, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_24_4723.

14 “Pesë vende nga rajoni me rezultate konkrete nga Brukseli, nga delegacioni nga Maqedonia morëm mesazhe që i dimë edhe nga shtëpia”, (Пет земји од регионот со конкретни rezultati од Брисел, од делегацијата од Македонија добивме пораки што ги знаеме и од дома), RACIN.Mk, 20 shtator 2024, <https://racin.mk/vesti/pet-zemji-od-regionot-so-konkretni-rezultati-od-brisel-od-delegacijata-od-makedonija-dobivme-poraki-shto-gi-znaeme-i-od-doma/>.

15 “Shqipëria është gati të hapë kapitujt e parë negociues në tetor dhe të shkëputet nga Maqedonia e Veriut”, (Albania set to open first negotiating chapters in October and decouple from North Macedonia), European Western Balkans, 26 shtator 2024, <https://europeanwesternbalkans.com/2024/09/26/albania-set-to-open-first-negotiating-chapters-in-october-and-decouple-from-north-macedonia/>.

Metodologjia

Gjatë përgatitjes së këtij raporti është zbatuar metodologjia për monitorimin e fushave që janë në fokus të punës së “Rrjetit 23” – Gjqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore,¹⁶ e përpunuar në vitin 2015 dhe e aplikuar tashmë në raportet e mëparshme. Ajo përfshiu hulumtimin e burimeve zyrtare shtetërore dhe të institucioneve gjyqësore, analizën e raportimeve mediatike mbi zhvillime specifike në këto fusha gjatë periudhës përkatëse, si dhe shqyrtimin e analizave dhe raporteve të shumta të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile. Përveç kësaj, u shfrytëzuan të dhënat e siguruara përmes kërkesave për qasje në informacione publike, disa prej të cilave janë ende në pritje të përgjigjes.

Për përgatitjen e këtij raporti në hije janë bërë konsultime edhe me organizata të shoqërisë civile, institucione shtetërore dhe ekspertë. Fillimisht u bënë konsultime për dorëzimin e analizave, raporteve dhe hulumtimeve përkatëse në lidhje me Kapitullin 23.

Disa nga të dhënat dhe zhvillimet e mbuluara në këtë raport janë paraqitur në mënyrë më të detajuar dhe janë analizuar në raportet tremujore të sundimit të ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE, të cilat i publikojmë rregullisht në faqen tonë të internetit gjatë gjithë vitit, të disponueshme në linkun e mëposhtëm: <https://epi.org.mk/cat/mesecni-izvestai>.

16 Natalija Shikova (red.), “Metodologjia për monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike nga Kapitulli 23 - gjyqësori dhe të drejtat themelore nga legjislacioni i Bashkimit Evropian”, („Методологија за мониторинг и евалуација на јавните политики од Поглавјето 23 – правосудство и фундаментални права од законодавството на Европската унија“), (Qendra për menaxhimin me ndryshime), <https://epi.org.mk/docs/Metodologjia_mk.pdf>.

1. Gjyqësori

Në fushën e gjyqësorit, periudha raportuese ishte e rëndësishme për zbatimin e rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE mbi punën e Këshillit Gjyqësor. Këto rekomandime u integruan në Strategjinë e re Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin(2024–2028) me Plan Veprimi,¹⁷ masat e të cilit janë pjesërisht të përfshira në Agjendën e Reformave të Planit të Rritjes së BE për Ballkanin Perëndimor.¹⁸ Pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme për të çuar përpara reformat gjyqësore, periudha raportuese u shënua nga sfidat në garantimin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe në zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, si dhe në forcimin e pavarësisë financiare të gjyqësorit.

Reformat e shpallura për të ripërcaktuar rolin dhe përbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë¹⁹ kanë nxitur një diskutim më të gjerë mbi mekanizmat më të përshtatshëm për të nxitur pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor. Çdo ndryshim duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën, ligjet përkatëse dhe standardet ndërkombëtare, duke siguruar që reformat të forcojnë gjyqësorin si një autoritet i pavarur dhe autonom, pa ndikim politik në funksionimin e tij.

Edhe pse udhëzimet strategjike ofrojnë një kuadër solid për përparim, zbatimin e vazhdueshëm të tyre mbetet një prioritet kryesor për forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit.

17 “Nga seanca e qeverisë: Çmimet e produkteve ushqimore bazike, ujit, pijeve të pagazuara dhe të gazuara dhe birrës mbeten të ngrira deri më 31 janar”, (Од владината седница: Цените на основните прехранбени производи, вода, негазирани и газирани пијалаци и пиво остануваат замрзнати до 31 јануари),faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 dhjetor 2023, <https://vlada.mk/node/35627>.

18 “Agjenda reformuese për Maqedoninë e Veriut 2024–2027”, (Реформска агенда на Северна Македонија 2024–2027), Ministria e Çështjeve Evropiane, 6 nëntor 2024, <https://mep.gov.mk/en/post/?id=15800>.

19 “Mickoski kërkon dy të tretat e shumicës për të miratuar propozim-ligjin për shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë”, (Мицкоски бара двотретинско мнозинство за да донесе закон со кој ќе ги распушти Судскиот совет и Советот на јавни обвинители), Sakam da Kazam, 6 qershor 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/mitskoski-bara-dvotretinsko-mnozinstvo-za-da-donese-zakon-so-koj-ke-gi-raspushti-sudskiot-sovet-i-sovetot-na-javni-obviniteli/>.

Dokumente strategjike

Pas një periudhe të gjatë vonesash, më 26 dhjetor 2023, Qeveria shqyrtoi dhe miratoi Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024-2028) me Plan Veprimi,²⁰ e cila më pas u paraqit zyrtarisht për publikun më 28 dhjetor 2023, nga Ministri i Drejtësisë dhe kryetarja e grupit punues që përgatiti strategjinë.²¹ Strategjia bazohet në përvojën dhe vlerësimet e zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor (2017 – 2022), duke vazhduar procesin e reformës dhe duke parashikuar zbatimin e masave që ishin planifikuar por që nuk u zbatuan sipas strategjisë së mëparshme.²² Përveç kësaj, ajo trajton çështjet kryesore të identifikuar nga Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit për Grupin 1, "Vlerat Themelore", lidhur me gjyqësorin. Strategjia gjithashtu integron rekomandimet e misionit vlerësues të Bashkimit Evropian mbi punën e Këshillit Gjyqësor, së bashku me rekomandimet nga trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët publikë dhe drejtësinë administrative dhe përmbarimin.²³ Dokumenti, i prodhuar me përfshirjen e akademikëve dhe organizatave përkatëse të shoqërisë civile, me mbështetjen e Projektit të BE për Sundimin e Ligjit, identifikon pesë fusha parësore që janë të ndërlidhura: 1) gjyqësorin dhe ndjekjen penale publike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian; (2) institucionet e sistemit të drejtësisë; (3) profesionet e pavarura dhe shërbimet publike; 4) reformën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut; (5) reformat në fusha të veçanta të së drejtës—penale dhe civile.²⁴ Në planin e veprimit të Strategjisë²⁵, janë vendosur afate kohore reale, me një rend logjik të zbatimit të veprimtarive. Plani përfshin gjithashtu masa për të miratuar ligje në fushat jashtë juridiksionit të Ministrisë së Drejtësisë, si: reforma e Kodit Zgjedhor për t'u përshtatur me rekomandimet e OSBE/ODIHR; reforma e Ligjit për financimin e partive politike dhe harmonizimi i tij me reformat në Kodin Zgjedhor; miratimi i legjislacionit për të rregulluar përfaqësimin e barabartë dhe të përshtatshëm.²⁶ Megjithatë, plani i veprimit nuk parashikon buxhetim specifik për veprimtaritë e planifikuara, gjë që është një pengesë e rëndësishme.

Zbatimi i aktiviteteve do të fillojë në fillim të vitit 2024. Për të siguruar vazhdimësinë në monitorimin e reformave, Qeveria më 26 maj 2024 ngrii një Këshill për të monitoruar

20 "Nga seanca e qeverisë: Çmimet e produkteve ushqimore bazike, ujit, pijeve të pagazuara dhe të gazuara dhe birrës mbeten të ngjira deri më 31 janar", (Од владината седница: Цените на основните прехранбени производи, вода, негазирани и газирани пијалаци и пиво остануваат замрзнати до 31 јануари), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 dhjetor 2023, <https://vlada.mk/node/35627>.

21 "Strategjia për zhvillimin e sistemit gjyqësor është një udhërrëfyes për rikthimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor", (Стратегијата за развој на правосудниот систем е патоказ за враќање на довербата на граѓаните во судството), Makfax, 28 dhjetor 2023, <https://bit.ly/48JlTV>.

22 "Strategjia Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024 – 2028)", (Развојна секторска стратегија за правосудство), Ministria e Drejtësisë, 2023, <https://bit.ly/3OAObr5>.

23 Ibid.

24 Ibid.

25 "Plan veprimi për zbatimin e Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin 2024-2028", (Акциски план за спроведување на Развојната секторска стратегија за правосудство 2024-2028), Ministria e Drejtësisë, 2023, <https://bit.ly/3OC9tfy>.

26 Ibid.

zbatimin e strategjisë.²⁷ Këshilli, i kryesuar nga Ministri i Drejtësisë, përfshin Ministrat e Punëve të Brendshme, Shoqërisë të Informacionit dhe Administratës dhe të Financave, Zëvendëskryeministrat për Çështjet Evropiane dhe Qeverisjen e Mirë, Prokurorin Publik Shtetëror, Kryetarët e Gjykatës Supreme, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, si dhe përfaqësues të akademive dhe organizatave të shoqërisë civile.²⁸ Pavarësisht formimit të tij, Këshilli nuk është takuar ende, gjë e cila ka ngritur pikëpyetje dhe shqetësime serioze lidhur me efektivitetin dhe konsistencën në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë. Ministria e Drejtësisë e justifikoi vonesën me një plan ristrukturimi të Këshillit në një organ më të gjerë, gjithëpërfshirës që do të koordinonte reformat e Strategjisë dhe Agjendës së Reformës, duke pasur parasysh se shumë nga masat/hapat mbivendosen në të dy dokumentet. Qëllimi është të sigurohet një mbikëqyrje e rregulluar, një koordinim më i mirë dhe zbatimi në kohë i të gjitha veprimeve të parashikuara.²⁹

Gjatë kësaj periudhe raportuese, ende nuk janë vërejtur veprime të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së burimeve njerëzore nëpërmjet zbatimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor³⁰ dhe Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike.³¹

Qeveria duhet urgjentisht të vendosë përbërjen e zgjeruar të Këshillit për të monitoruar zbatimin e Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024-2028) dhe Agjendës së Reformave të Maqedonisë së Veriut të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojë funksionimin e rregullt të tij. Kjo përfshin përcaktimin e një dinamike të qartë të takimeve, përmirësimin e koordinimit midis institucioneve, transparencën në zbatimin e aktiviteteve dhe vendosjen e mekanizmave efektivë për ndjekjen dhe vlerësimin e progresit. Është gjithashtu e nevojshme të racionalizohen masat që mbivendosen midis Strategjisë dhe Agjendës së Reformës;

Qeveria dhe institucionet duhet të vendosin gjithashtu mekanizma më transparentë për raportimin e progresit, duke përfshirë komunikimin e qartë me publikun rreth rezultateve të arritura dhe hapave të ardhshëm.

27 "Seanca konstituive e Këshillit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024 – 2028)", (Конститутивна седница на Советот за следење на имплементацијата на Развојната секторска стратегија за правосудство (2024 – 2028)), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 23 maj 2024, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6701>.

28 Ibid.

29 "Kontribut nga Ministria e Drejtësisë në diskutimin e Raportit në hije të Kapitullit 23 për periudhën tetor 2023 – shtator 2024", (Придонес од Министерството за правда во рамки на дискусијата за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2023 – септември 2024 година), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane (EPI) – Shkup, 24 dhjetor 2024, <https://epi.org.mk/post/27153>.

30 "Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor", („Стратегија на човечки ресурси за судската мрежа“), shtator 2020, <https://bit.ly/3trhzNE>.

31 "Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike", („Стратегија на човечки ресурси за јавнообвинителската мрежа“), tetor 2020, <https://bit.ly/3GcekBs>.

Organet drejtuese

Periudha raportuese filloi me marrjen e Raportit të Misionit vlerësues të BE mbi punën e Këshillit Gjyqësor, i cili përmban dyzet rekomandime që synojnë përmirësimin e situatës, veçanërisht ato të identifikuar në periudhën e mëparshme raportuese. Më 12 dhjetor 2023, ambasadori i BE në vend paraqiti rekomandimet para mediave dhe publikut,³² ndërsa vetë raporti, i paraqitur më parë para autoriteteve dhe institucioneve kompetente, nuk u publikua i plotë për të shmangur një reduktim të mundshëm të efektivitetit të tij.³³ Rekomandimet organizohen në gjashtë segmente kryesore: struktura dhe kompetenca e Këshillit Gjyqësor, mandati i anëtarëve të tij, procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve, procedurat disiplinore, transparenca dhe komunikimi me publikun si dhe burimet dhe financimi. Nga këto, 17 janë brenda fushës së vetë Këshillit Gjyqësor³⁴, ndërsa 23 të tjerat kërkojnë ndryshime në Kushtetutë dhe në ligjet përkatëse.³⁵

Zbatimi i rekomandimeve të misionit vlerësues nga Këshilli Gjyqësor filloi pas vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative për sfidën ligjore të shkarkimit të ish-kryetares. Gjegjësisht, më 29 dhjetor 2023, pas një vonese të gjatë në procedim pas ankesës së paraqitur,³⁶ Gjykata Administrative mori një vendim të formës së prerë dhe të pakthyeshëm, duke e shpallur vendimin e shkarkimit të paligjshëm.³⁷ Me këtë vendim, kryetarja e shkarkuar u rikthye në detyrë më 3 janar 2024, ndërsa vendimi i Këshillit Gjyqësor i 5 dhjetorit 2022 për të zgjedhur kryetaren mbeti në fuqi.³⁸ Ky vendim u kritikua shumë nga sektori civil dhe komuniteti akademik për veprimet e paligjshme të Këshillit Gjyqësor,³⁹ njëkohësisht duke ngritur shqetësime për vlefshmërinë e vendimeve të marra gjatë periudhës kur posti mbahej nga kryetari me mandat jolegjitim.⁴⁰ Konkretisht, edhe pse vendimet e marra ishin kolektive dhe

32 “BE dhe 40 rekomandime: Si deri në Këshilli Gjyqësor të pavarur”, (EY и 40 препораки: Како до независен Судски совет), 360 Stepeni, 12 dhjetor 2023, <https://360stepeni.mk/eu-i-40-preporaki-kako-do-nezavisen-sudski-sovet/>.

33 Ibid.

34 Nga këto 17, pesë janë në drejtim të zgjedhjeve dhe emërimeve në Këshill, njëra i përket procedurave disiplinore, nëntë në fushën e transparenës dhe komunikimit, si dhe dy rekomandime në fushën e burimeve dhe financave. “Këshilli Gjyqësor miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të BE-së”, (Судскиот совет го усвои Акцискиот план за спроведување на препораките на ЕУ), Agjencia Informative Mediatike - AIM, 29 shkurt 2024, <https://bit.ly/4fYM3x6>.

35 Ibid.

36 “Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Vesna Dameva, paraqiti ankesë penale në Prokurorinë e Shkupit dhe ankesë në Gjykatën Administrative për shkarkimin e saj”, („Експертска комисија на Судскиот совет, Весна Дамева, поднесе кривична пријава до Скопско обвинителство и тужба до Управниот суд за нејзино разрешување“), Sakam da Kazam, 19 maj 2023, <https://bit.ly/3slsplH>.

37 “Njoftim për publikun”, (Соопштение за јавност), faqja zyrtare e Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 3 janar 2024, <https://bit.ly/3vqSCWJ>.

38 “Njoftim për seancën urgjente të 471-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 03.01.2024”, (Соопштение за 471-та итна седница на Судскиот совет на РСМ - 03.01.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/41bATAF>.

39 “Grupi Blueprint për Reforma në Gjyqësor mirëpret vendimin e Gjykatës Administrative për anulimin e vendimit për shkarkimin e kryetares të atëhershme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Блупринт групата за реформи во правосудството ја поздравува одлуката на Управниот суд за поништување на одлуката за разрешување од функција на тогашната претседателка на Судски совет на РСМ), faqja zyrtare e Grupit Blueprint për Reforma në Gjyqësor, 16 janar 2024, <https://bit.ly/49PHAsT>.

40 “Këshilli Gjyqësor: Vlejnë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli si organ kolektiv”, (Судски совет: Важат сите одлуки донесени од Советот како колективно тело), Sloboden Pecat, 5 janar 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/sudski-sovet-vazhat-site-odluki-doneseni-od-sovetot-kako-kolektivno-telo/>.

formalisht legjitime, nënshkrimi i tyre nga një kryetar jolegitim shkaktoi debate për pasojat ligjore dhe institucionale të kësaj situatë.⁴¹ Në të njëjtën kohë, vendimi i Gjykatës Administrative u mirëprit nga misionet diplomatike⁴² dhe palët e tjera të interesit, gjë që lejoi vazhdimin e projekteve të pezulluara më parë të destinuara për dhe me Këshillin Gjyqësor.⁴³

Hapi i parë drejt zbatimit të rekomandimeve ishte miratimi i Planit të Veprimit në seancën e 29 shkurtit 2024, me afate të përcaktuara qartë për zbatimin e tyre.⁴⁴ Në kuadër të planit, në mars të vitit 2024, filloi përgatitja e Strategjisë së Komunikimit të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024-2028), përmes një procesi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të gjykatave, sektorit civil, Këshillit Gjyqësor-Mediatik dhe gazetarëve.⁴⁵ Strategjia u miratua më 10 qershor 2024 me mbështetjen e Projektit të BE për Sundimin e Ligjit⁴⁶ dhe u harmonizua me të gjitha politikat kombëtare të zhvillimit, si dhe me standardet evropiane të vendosura nga Këshilli i Evropës.⁴⁷ Si pasojë, më 29 maj 2024, u miratuan ndryshimet në Rregulloren e Punës së Këshillit Gjyqësor dhe Rregulloren për renditjen e kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë.⁴⁸ Ndryshimet në Rregulloren e punës në lidhje me detyrimin për përpunimin e vendimeve, megjithëse tashmë kuptohen si përgjegjësi e natyrshme sipas natyrës së mandatit të anëtarëve të Këshillit, përfaqësojnë një forcim formal të këtyre standardeve. Me ndryshimet, anëtarët e Këshillit janë të detyruar të shpjegojnë vendimet e tyre, veçanërisht në rastet kur ata votojnë kundër zgjedhjes së një

41 "Vendimi i Këshillit Administrativ do të thotë se Këshilli Gjyqësor funksionon në mënyrë të paligjshme, anëtarët duhet të japin dorëheqjen", (Пресудата на Управен значи дека Судскиот совет работи незаконски, членовите треба да си поднесат оставка), TV Telma, 30 dhjetor 2023, <https://telma.com.mk/2023/12/30/presudata-na-upraven-znachi-deka-sudskiot-sovet-raboti-nezakonski-chlenovite-treba-da-si-podnesat-ostavka/>; "Njoftim", (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 janar 2024, <https://bit.ly/3w7E9jh>.

42 "Ambasadori Gir dhe kryetarja Dameva ranë dakord për rëndësinë e pavarësisë në punën e Këshillit Gjyqësor", (Амбасадорот Гир и претседателката Дамева се согласија за важноста на независноста во работењето на Судскиот совет), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 janar 2024, <https://bit.ly/3vUrYX7>; "Takimi i Ambasadorit të SHBA Ageler me kryetaren Dameva", (Средба на американската амбасадорка Агелер со претседателката Дамева), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 janar 2024, <https://bit.ly/4b1fTOs>; "Kryetarja Vesna Dameva kishte një vizitë pune me Shefin e Misionit të OSBE-së në Shkup, Ambasadorin Kilian Vall", (Претседателката Весна Дамева оствари работна посета со шефот на Мисијата на ОБСЕ во Скопје, амбасадорот Килијан Вал), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 shkurt 2024, <https://bit.ly/4d145h4>.

43 "Takimi i kryetares Dameva me Ambasadorin Kop për rinovimin e projektit MATRA", (Средба на претседателката Дамева со амбасадорот Коп за обновување на проектот MATRA), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 shkurt 2024, <https://bit.ly/3jxklUi>.

44 "Njoftim nga seanca e 480-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 29.02.2024", (Соопштение од 480-та седница на Судскиот совет на PCM – 29.02.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3UcMlqy>.

45 "Punëtori për përgatitjen e Strategjisë së Komunikimit të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024-2028)", (Работилница за изработка на Комуникациска стратегија на Судскиот совет и судовите на Република Северна Македонија (2024-2028), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://bit.ly/3vXJqdj>.

46 "Njoftim nga seanca e 490-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 10.06.2024", (Соопштение од 490-та седница на Судскиот совет на PCM – 10.06.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4cYKWAr>.

47 Strategjia Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024 – 2028), Plani Kombëtar i Veprimit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (2024-2026), Strategjia e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (2019-2024), Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor (2020) dhe Deklarata e Gjyqësorit të Hapur (2022).

48 "Njoftim nga seanca e 488-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 29.05.2024", (Соопштение од 488-та седница на Судскиот совет на PCM – 29.05.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4b0IHlk>.

gjyqtari, për të siguruar individualitetin e tyre, bazuar në kritere objektive dhe mundësinë e krahasueshmërisë konsekuente.⁴⁹ Për më tepër, ndryshimet paraqitën afate specifike për procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.⁵⁰ Rregullat e reja parashikojnë gjithashtu përfshirjen aktive të Shoqatës së Gjyqtarëve dhe organizatave përkatëse të shoqërisë civile në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të Raportit Vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor.⁵¹ Rregullat e përditësuara të renditjes, ndërkohë, prezantuan kritere të reja që vlerësojnë punën shtesë të gjyqtarëve, si dhe referimet e përkohshme, duke siguruar përparësi për përzgjedhjen në gjykatat më të larta bazuar në rezultate reale cilësore.⁵² Rregullat do të zbatohen për shpalljet e reja për zgjedhje të gjyqtarëve, të cilat nuk janë shpallur në periudhën raportuese, ndërsa procedurat aktuale janë zbatuar sipas Rregullores së Procedurës të shkurtit 2020.⁵³

Me këto akte nënligjore, strategji dhe plane pune, Këshilli Gjyqësor zbatoi pjesërisht 7 nga 17 rekomandime që nuk kërkojnë ndryshime kushtetuese apo ligjore. Monitorimi i mëtejshëm në zbatimin e tyre në punën praktike është i nevojshëm. Dy rekomandime u zbatuan plotësisht, duke iu referuar promovimit të informacionit mbi punën e Këshillit, i cili përpunohet më thellësisht në seksionin “Pavarësia dhe paanshmëria”.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor, pas tre përpjekjeve të pasuksesshme, më në fund zgjodhi një anëtar të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 6 qershor 2024.⁵⁴ U zgjodh gjyqtari, kandidatura e të cilit në listën e përgjithshme të kandidatëve shkaktoi debat midis anëtarëve të Këshillit për të drejtën e anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë për të qëndruar në listën e përgjithshme, duke marrë parasysh listën e veçantë për këto komunitete të përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor.⁵⁵ Disa anëtarë mendonin se kishte pengesa ligjore,⁵⁶ ndërsa të tjerë vlerësuan se të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme kishin të drejtë të barabartë për emërim.⁵⁷ Pavarësisht pikëpamjeve kontradiktore, kandidatura u konfirmua, pasi kuota për këto komunitete në Këshill ishte përmbushur tashmë në kohën e publikimit të shpalljes.⁵⁸ Kandidatja

49 Ibid.

50 Ibid.

51 Ibid.

52 Ibid.

53 Ibid.

54 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 qershor 2024, <https://bit.ly/3LqHEdu>.

55 Instituti për të Drejtat e Njeriut - Shkup, “Raport për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor për periudhën janar - korrik 2024”, (Извештај од следењето на работата на Судскиот совет за периодот јануари - јули 2024 година) 2024, <https://bit.ly/3OC5DTV>.

56 Neni 6, paragrafi 1, rreshti 2 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut parashikon që “tetë anëtarë të Këshillit do të zgjedhin gjyqtarët nga radhët e tyre, me ç’rast tre nga anëtarët e zgjedhur do të jenë anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke ruajtur kështu përfaqësimin adekuat dhe të barabartë të qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve.” Një dispozitë identike parashikohet në nenin 104 të Kushtetutës. Disa nga anëtarët e Këshillit theksuan se gjatë përgatitjes dhe përcaktimit të listave të kandidatëve, Këshilli është i detyruar të respektojë përbërjen dhe numrin e anëtarëve, siç kërkohet nga Kushtetuta dhe Ligji. Më tej, ata theksuan se rregullimi i përbërjes së Këshillit para procedurës së zgjedhjes së anëtarëve nuk është i rastësishëm, por është një respektim i detyrueshëm i dispozitave kushtetuese dhe ligjore për strukturën e duhur të Këshillit. Ibid.

57 Ibid.

58 “Shpallje për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjedhjen e 1 (një) anëtarit nga radhët e Qarkut të Apelit të Manastirit”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 28/2024.

e mbetur për të njëjtin pozicion tërhoqi kandidaturën e saj disa ditë para zgjedhjeve, duke përmendur arsye shëndetësore. Kjo ngriti dyshime për ndikime të mundshme politike, sipas gjetjeve të anëtarëve të Këshillit, se gjyqtarja vazhdoi punën e saj të rregullt në Gjykatën e Lartë pa hapur leje të sëmundjes.⁵⁹ Në të njëjtën seancë, u zgjodh një anëtar nga Qarku i Apelit të Manastirit, pozicioni i të cilit ishte i lirë që nga janari 2024.⁶⁰ Më pas, më 4 shtator 2024, u zgjodh edhe një anëtar i listës së veçantë për komunitetet që janë më pak se 20% e popullsisë,⁶¹ duke plotësuar vendin e lirë për shkak të përfundimit të mandatit të anëtarit të mëparshëm në të njëjtin muaj, i cili më parë kishte mbajtur në mënyrë të paligjshme detyrën e kryetarit.⁶² Të gjitha zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me rrethanat, me mbulim mediatik nga Agjencia Informative Mediatike (AIM) dhe raportimi publik,⁶³ dhe u publikuan rezultatet e përgjithshme të votimit.⁶⁴

Këshilli i Prokurorëve Publikë, nga ana tjetër, gjatë periudhës raportuese zgjodhi katër anëtarë të rinj të Këshillit, për shkak të përfundimit të mandateve të paraardhësve të tyre.⁶⁵ Më 15 dhjetor 2023, një anëtar i Prokurorisë së Lartë Publike Shtip (posti zgjedhor 4) u zgjodh nga tre kandidatë të regjistruar.⁶⁶ Rrjedhimisht, më 26 janar 2024, u zgjodh anëtar i Prokurorisë

59 Ivana Petkovska dhe Lejla Tutij, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година), (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2024), <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2024/12/68-AN-SJOSS-2024.pdf>.

60 "Njoftim", (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 qershor 2024, <https://bit.ly/3LqhEdu>.

61 "Njoftim", (Соопштение) faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 shtator 2024, <https://bit.ly/3BGf29A>.

62 "Njoftim nga seanca e 498-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 10.09.2024", (Соопштение од 498-та седница на Судскиот совет на PCM - 10.09.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 shtator 2024, <https://bit.ly/4eDm79A>.

63 "Këshilli Gjyqësor - seancat", (Судски совет - седници), Agjencia Informative Mediatike - AIM, <https://bit.ly/4ihytXf>.

64 "Listat e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit nga radhët e gjyqtarëve", (Кандидатски листи за избор на членови на советот од редот на судиите), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 prill 2024, [https://bit.ly/3xOQk2](https://bit.ly/3xOQk2;); "Njoftim nga seanca e 486-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 15.05.2024", (Соопштение од 486-та седница на Судскиот совет на PCM - 15.05.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3S32Sgf>; "Njoftim nga seanca urgjente e 489-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 03.06.2024", (Соопштение од 489-та itna седница на Судскиот совет на PCM - 03.06.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3W6dLij>; "Njoftim", (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 qershor 2024, <https://bit.ly/4cGm2RA>; "Lista e vetme e veçantë për kandidat nga radhët e gjyqtarëve", (Единствена посебна листа за кандидат од редот на судиите), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26

65 "Vendimi për ndërprerjen e detyrës së anëtares - Fidanka Rajevska", (Одлука за престанок на функција на член - Фиданка Рајевска), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/3xOMUiK>; "Procesverbali i seancës së 100-të të KPPRMV", (Записник од стотата седница на CJOPCM), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 mars 2024, <https://bit.ly/3QfVhKo>; "Procesverbali i seancës së 106-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë", (Записник од 106 седница на Советот на јавни обвинители), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 korrik 2024, <https://sjorm.gov.mk/zapisnik-od-106-sednica-na-sjorm/>.

66 "Lista e kandidatëve të regjistruar për anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga radhët e prokurorëve publikë nga fusha e Prokurorisë së Lartë Publike Shtip, me post zgjedhor nr. 4", (Кандидатска листа од пријавените кандидати за член на Советот на јавните обвинители на PCM, од редот на јавните обвинители од подрачјето на Вишото јавно обвинителство Штип, со изборно место бр. 4), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 4 dhjetor 2023, <https://bit.ly/3ZNzN6H>.

së Lartë Publike (postei zgjedhor 3),⁶⁷ gjithashtu nga tre kandidatë.⁶⁸ Më 22 mars 2024, Këshilli zgjodhi anëtarin e ri nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (postei zgjedhor 5),⁶⁹ përsëri nga tre kandidatë të regjistruar.⁷⁰ Së fundmi, më 29 korrik 2024, u zgjodh një anëtar i Prokurorisë së Lartë Publike Manastir (postei zgjedhor 1), duke zgjedhur kandidatin e vetëm të regjistruar.⁷¹

Më 14 gusht 2024, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKK) arriti një propozim-marrëveshje me një anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë, i cili ishte njëkohësisht nënkryetar i tij, mbi dyshimin e bazuar për veprën penale të “mar-rjes së një shpërblimi për ndikim të paligjshëm”, për të cilin parashikohet një dënim me burg nga 1 deri në 5 vjet.⁷² Marrëveshja parashikonte një dënim të kushtëzuar prej 1 viti, me kusht që të mos kryhej asnjë vepër e re penale brenda 3 viteve, si dhe një dënim dytësor – ndalimi i ush-trimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për 3 vjet.⁷³ Para kësaj, më 9 gusht 2024, anëtari paraqiti dorëheqjen e tij të parevokueshme në Kuvend,⁷⁴ si autoriteti kompetent për miratimin e tij, duke qenë se ai u zgjodh nga shtëpia legjislative.⁷⁵ Dorëheqja u pranua më 3 shtator 2024,⁷⁶ pas së cilës Këshilli i Prokurorëve Publik deklaroi zyrtarisht përfundimin e mandatit të tij.⁷⁷

67 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 janar 2024, <https://bit.ly/44d4QzK>.

68 “Lista e kandidatëve të regjistruar për anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga radhët e prokurorëve publikë nga fusha e Prokurorisë së Lartë Publike Shkup, me post zgjedhor nr.3”, (Кандидатска листа од пријавените кандидати за член на Советот на јавните обвинители на РСМ, од редот на јавните обвинители од подрачјето на Вишото јавно обвинителство Скопје, со изборно место бр.3), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 18 janar 2024, <https://sjorm.gov.mk/kandidatska-lista-od-prijavenjite-kanj-2/>.

69 “Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për anëtar të KPPrMV”, (Соопштение за конечните резултати од спроведени избори за член на CJOPCM), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 mars 2024, <https://bit.ly/3Uxgh21>.

70 “Lista e kandidatëve të regjistruar për anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga qarku i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me post zgjedhor nr.5”, (Кандидатска листа од пријавените кандидати за член на Советот на јавните обвинители на РСМ, од подрачјето на Јавното обвинителство на РСМ, со изборно место бр.5), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11 mars 2024, <https://sjorm.gov.mk/kandidatska-lista-od-prijavenjite-kanj-3/>.

71 “Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë nga qarku i Prokurorisë së Lartë Publike Manastir, e mbajtur më 29.07.2024”, (Соопштение за конечни резултати од спроведени избори за член на Советот на јавните обвинители од подрачјето на Вишото јавно обвинителство Битола, одржани на 29.07.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29 korrik 2024, <https://sjorm.gov.mk/soopshtenie-za-konechni-rezultati-od-sprovedeni-izbori-za-chlen-na-sovetot-na-javnite-obviniteli-od-podrachjeto-na-vishoto-javno-obvinitelstvo-bitola-odrzhani-na-29-07-2024-godina/>.

72 “Arrihet propozim – marrëveshja me një të dyshuar për marrjen e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm”, (Постигната предлог – спогодба со осомничен за примање награда за противзаконито влијание), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 gusht 2024, <https://jorm.gov.mk/postignata-predlog-spodogda-so-osomni-chen-za-primane-nagrada-za-protivzakonito-vlijanie/>.

73 Ibid.

74 “Dorëheqja e Ixhet Memeti si anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Оставка на Иџет Мемети од функцијата член на Совет на јавните обвинители на Република Северна Македонија), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 9 gusht 2024, <https://bit.ly/4fYNP1n>.

75 “Avokati i Popullit Ixhet Memeti zgjidhet si anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë”, (Омбудсманот Иџет Мемети избран за член на Советот на јавни обвинители), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 qershor 2024, <https://bit.ly/3LqHEdu>.

76 “I dënuari për rryshfet Ixhet Memeti do të shkarkohet zyrtarisht nga detyra të martën, thotë Gashi”, (Осудениот за мито Иџет Мемети формално ќе биде разрешен од функцијата во вторник, вели Гаши), Sakam da Kazam, 31 gusht 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/osudeniot-za-mito-idhet-memeti-formalno-ke-bide-razreshen-od-funksijata-vo-vtornik-veli-gashi/>.

77 Petkovska dhe Tutiq, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”, (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

Megjithatë, në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë, përfundimi i mandatit mund të përcaktohet menjëherë pas shqiptimit të dënimit me kusht,⁷⁸ i cili thekson nevojën e harmonizimit të procedurave për veprim në kohë.⁷⁹

Për më tepër, në periudhën tre mujore nga lëshimi i urdhrit për kryerjen e procedurës së hetimit deri në arritjen e zgjidhjes, u caktuan katër seanca të Këshillit, nga të cilat anëtari vullnetarisht nuk mori pjesë në tre.⁸⁰ Kjo nxjerr në pah hendekun ligjor në Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë, i cili, ndryshe nga Ligji për Këshillin Gjyqësor, nuk parashikon mundësinë e largimit të përkohshëm nga detyra të një anëtari të cilit i është iniciuar procedimi penal. Kjo situatë lë që vendimet për mungesën në punë të varen vetëm nga vullneti dhe ndërgjegjja e anëtarit në fjalë, duke e lejuar atë të vazhdojë të marrë pjesë në punën e Këshillit, përfshirë proceset e vendim-marrjes, ndërsa procedura është në vazhdim, gjë që kompromenton pavarësinë funksionale të Këshillit.⁸¹ Për më tepër, ndryshimet e fundit në Kodin Penal, të cilat ulën dënimin maksimal të përcaktuar me ligj për krimet korruptive,⁸² çuan në zbatimin e dispozitave përkatëse që zbatohen për procedurën e shkurtuar për këto raste, e cila nuk parashikon fazën e vlerësimit të një aktakuze.⁸³ Kjo ngre shqetësime se, nëse një zgjidhje e tillë interpretohet në mënyrë kufizuese, largimi i përkohshëm nga detyra mund të mos zbatohet për procedurat e shkurtuara, përfshirë rastet e korrupsionit.⁸⁴ Duke pasur parasysh këtë, ndryshimet në Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë janë të nevojshme. Së pari, duhet të prezantohet mundësia e largimit të përkohshëm nga detyra të një anëtari të cilit i është ngritur procedurë penale. Së dyti, një largim i tillë duhet të vendoset në kohën e ngritjes së aktakuzës, si një akt fillestar për fillimin e procedurave para një gjykate. Këto ndryshime do të sigurojnë zbatueshmërinë e masës si në procedurat e shkurtuara ashtu edhe në ato të rregullta, duke ruajtur kështu integritetin e punës së Këshillit.⁸⁵

78 Në Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë rradhiten situatat në të cilat përfundon mandati i anëtarit të këshillit, duke përfshirë dënimin me vendim të formës së prerë për një krim me dënim të pakushtëzuar me burgim të paktën gjashtë muaj ose me dënim më të butë për një krim tjetër që e bën atë të padenjë për të shërbyer si anëtar i këshillit. Ky vendim ligjor parashikon alternativitet, që do të thotë se mandati përfundon në rast të dënimit me kusht për një krim që e bën anëtarin të padenjë për pozitën. Prandaj, në rastin konkret, nuk duhet të diskutohet se përfundimi i mandatit të anëtarit duhet të ishte konstatuar menjëherë pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit më 14 gusht 2024. Në vend të kësaj, konstatimi i ndërprerjes u shty deri në pranimin e dorëheqjes nga Kuvendi më 3 shtator 2024, gjë që la një boshllëk kohor prej tre javësh. Ky proces i vonuar thekson nevojën e harmonizimit të procedurave për veprim në kohë në rrethana të tilla. "Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150/2007, 100/2011, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 42/2020.

79 Petkovska dhe Tutiq, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

80 "Procesverbal i seancës së 103-të të KPPRMV" (Записник од 103 седница на CJOPCM) faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29 maj 2024, <https://sjorm.gov.mk/zapisnjik-od-103-sednjica-nja-sjorm/>; "Procesverbal i seancës së 104-të të KPPRMV", (Записник од 104 седница на CJOPCM), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 qershor 2024, <https://sjorm.gov.mk/zapisnjik-od-104-sednjica-nja-sjorm/>; Petkovska dhe Tutiq, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година)

81 "Këshilli i Prokurorëve Publikë thotë se nuk mund të shkarkojë të dyshuarin për korrupsion Ixhet Memeti, kolegët i rekomanduan atij të mos marrë pjesë në punë gjatë hetimit", (Од Советот на јавни обвинители велат дека не можат да го разрешат осомничениот за корупција Иџет Мемети, kolegite му препорачаа да не учествува во работата додека трае истрагата), Sakam da kazam, 29 maj 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/od-sovetot-na-javni-obviniteli-velat-deka-ne-mozhat-da-go-razreshat-osomnicheniot-za-korupsija-idhet-memeti-kolegite-mu-preporachaa-da-ne-uchestvuva-vo-rabotata-dodeka-trae-istragata/>.

82 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 188/2023.


83 Petkovska dhe Tutiq, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

84 Ibid.

85 Ibid.

Nevojitet zbatimi i vazhdueshëm i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian drejtuar Këshillit Gjyqësor, si dhe krijimi i një mekanizmi nga Këshilli Gjyqësor për të monitoruar vazhdimisht efektivitetin e tyre në praktikë;

Nevojitet të rishikohet Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë për të prezantuar mundësinë e largimit të përkohshëm të një anëtari të Këshillit kundër të cilit janë filluar procedurat penale. Kjo masë duhet të zbatohet nga momenti i ngritjes së aktakuzës, si akt fillestar për fillimin e procedurave para një gjykate. Këto ndryshime do të sigurojnë zbatueshmërinë e masës si në procedurat e shkurtuara ashtu edhe në ato të rregullta, duke ruajtur kështu integritetin e punës së Këshillit;



Pavarësia dhe paanshmëria

Zbatimi praktik i kuadrit ligjor për garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, i krijuar përmes grupit të tretë të ndryshimeve legislative në përputhje me Strategjinë për Reforma në Sektorin Gjyqësor (2017–2022),⁸⁶ zbuloi mangësi në punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Këto probleme u vunë re në Raportin e misionit vlerësues të BE-së për punën e Këshillit Gjyqësor dhe raportin vjetor të Komisionit Evropian për vitin 2023.⁸⁷ Si përgjigje, filloi procesi për rishikimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor⁸⁸ dhe Ligjit për Prokurorinë Publike,⁸⁹ me theks në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe funksionalitetit të këtyre organeve. Këto ndryshime përfshihen gjithashtu në Strategjinë e re Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024–2028)⁹⁰ dhe Planin e Veprimit,⁹¹ si dhe Agjendën e Reformës së Maqedonisë së Veriut të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.⁹²

Më saktësisht, më 16 nëntor 2023, u mbajt një seancë përbërëse e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Këshillit Gjyqësor,⁹³ i cili deri në fund të periudhës raportuese mbajti gjithsej 22 seanca,⁹⁴ duke siguruar transparencë dhe gjithëpërfshirje në proces. Ndryshimet kryesore synojnë: paraqitjen e bazave të qarta për përgjegjësinë disiplinore individuale të anëtarëve të Këshillit, përcaktimin e autoriteteve kompetente për veprim dhe të drejtën e apelit; rritjen e përvojës minimale të punës si gyqtar për anëtarët nga radhët e gjyqtarëve; rritjen e përvojës së punës si kusht për anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi; dhe futjen e censusit zgjedhor.⁹⁵ Në të njëjtën kohë, Grupi i Punës për Ndryshimet dhe Plotësimet në Ligjin për Prokurorinë Publike, nga konstituimi i tij deri në fund të periudhës raportuese, zhvilloi gjithsej nëntë seanca dhe një takim koordinues.⁹⁶ Puna e tij kishte për qëllim forcimin e mekanizmave për ndarjen elektronike të lëndëve, përcaktimin e saktë të kompetencave për

86 Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat të vitit 2019, Ligji për Këshillin Gjyqësor të vitit 2019, Ligji për Prokurorinë Publike të vitit 2020 dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë të vitit 2020.

87 Komisioni Evropian, 'Dokument i punës i Komisionit – Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023', (Работен документ на комисијата – Извештај за Северна Македонија за 2023 година), 8 nëntor 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf.

88 "Ministria e Drejtësisë krijon një grup pune për reformimin e Këshillit Gjyqësor", (МП формира работна група за реформа на Судскиот совет), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 1 nëntor 2023, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6615>.

89 Ministria e Drejtësisë, "Propozim-ligji për plotësimin e ligjit për prokurorinë publike", (Предлог на Закон за дополнување на Законот за јавното обвинителство), Regjistri Kombëtar Elektronik i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut - ENER, 15 shtator 2023, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=80780.

90 "Strategjia Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024 – 2028)."

91 "Plan veprimi për zbatimin e Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin 2024–2028".

92 "Agjenda reformuese për Maqedoninë e Veriut 2024–2027", (Реформска агенда на Северна Македонија 2024–2027), Ministria e Çështjeve Evropiane, 6 nëntor 2024, <https://mep.gov.mk/en/post/?id=15800>.

93 "Seanca e Parë Kushtetuese e Grupit të Punës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor", (Прва конститутивна седница на работната група за изменување и дополнување на Законот за Судскиот совет), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 16 nëntor 2023, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6620>.

94 Informacion sipas pjesëmarrjes së përfaqësuesve të grupit Blueprint për reforma në Gjyqësor në grupin e punës.

95 "Ndryshime ligjore në vend të shpërbërjes së Këshillit Gjyqësor", (Законски измени место распуштание на Судскиот совет), Deutsche Welle, 11 qershor 2024, <https://www.dw.com/mk/krenar-loga-so-zakonski-izmeni-ke-se-bori-protiv-najavite-zaraspustane-na-sudskiot-sovet/a-69329763>.

96 Informacion sipas pjesëmarrjes së përfaqësuesve të grupit Blueprint për reforma në Gjyqësor në grupin e punës.

mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e institucioneve përkatëse dhe prokurorëve publikë, si dhe nxitjen e trajtimit të rekomandimeve për shkelje dhe sanksione disiplinore.⁹⁷

Veprimet e ndërmarra kanë kontribuar në përmirësimin e besimit në gjyqësor, sipas sondazhit të fundit të Barometrit Ballkanik, krahasuar me vitin e kaluar.⁹⁸ Megjithatë, aktivitetet e filluara nuk ishin të mjaftueshme që Qeveria e re të braktiste premtimin e saj elektoral për të shpërbërë Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë.⁹⁹ Këto plane, të përfshira më pas në Programin e Punës së Qeverisë të qershorit 2024, synojnë të parandalojnë ndikimin partiak në këto organe.¹⁰⁰ Reformat e propozuara përfshijnë ndryshime legjislative për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave nga Kuvendi dhe Presidenti i shtetit, si dhe ndryshime kushtetuese për riorganizimin e përbërjes së këshillave, të cilat do të lejonin që anëtarët të zgjidheshin drejtpërdrejt nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.¹⁰¹

Mungesa e detajeve specifike dhe afati kohor për reformat, si dhe pasiguria nëse ato do të zbatohen vetëm për përbërjet aktuale apo edhe për strukturat e ardhshme, kanë ngritur shqetësime midis përfaqësuesve diplomatikë,¹⁰² ekspertëve publikë¹⁰³ dhe ish-ministri i Drejtësisë.¹⁰⁴ Ata paralajmëruan për rrezikun e përqendrimit të pushtetit dhe ngecjen në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, gjë që mund të rrezikojë funksionalitetin e sistemit të drejtësisë. Kryeministri hodhi poshtë reagimet e misionëve diplomatike si ndërhyrje në punët e brendshme të vendit,¹⁰⁵ por në të njëjtën kohë shprehu gatishmërinë për të shqyrtuar propozimet për zgjidhje alternative.¹⁰⁶ Përkundër kësaj, nuk u ndërmor asnjë hap konkret nga miratimi i programit deri në fund të periudhës raportuese për zbatimin e reformave. Disa nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve që ishin aktivë në kohën e sjelljes së

97 Ministria e Drejtësisë, “Propozim-ligji për plotësimin e ligjit për prokurorinë publike.”

98 “Barometri publik ballkanik – gjetjet kryesore”, (Balkan Public Barometer – Key Findings) Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR), https://www.rcc.int/balkanbarometer/key_findings_2024/2/.

99 “Mickoski kërkon dy të tretat e shumicës për të miratuar propozim-ligjin për shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë”, (Мицкоски бара двотретинско мнозинство за да донесе закон со кој ќе ги распушти Судскиот совет и Советот на јавни обвинители), Sakam da Kazam, 6 qershor 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/mitskoski-bara-dvotretinsko-mnozinstvo-za-da-donese-zakon-so-koj-ke-gi-raspushti-sudskiot-sovet-i-sovetot-na-javni-obviniteli/>.

100 “Dokumente – Propozim Programi i Punës së Qeverisë”, (Документи – Предлог-програма за работа на Владата), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nsp?param=3ae13141-ac9e-486a-950e-f603c34dcea4>.

101 Ibid.

102 “BE dhe SHBA i dhanë mbështetjen e tyre Këshillit Gjyqësor”, (ЕУ и САД му дадоа поддршка на Судскиот совет), Deutsche Welle, 3 korrik 2024, <https://www.dw.com/mk/eu-i-sad-mu-dadoa-poddrska-na-sudskiot-sovet/a-69549287>.

103 “Cvetanovska: Shpërbërja e Këshillit Gjyqësor do të krijojë një precedent të rrezikshëm dhe do të cenojë më tej besimin në gjyqësor”, (Цветановска: Распуштањето на Судскиот совет ќе постави опасен прецедент и дополнително ќе ја наруши довербата во правосудството), TV Telma, 5 qershor 2024, <https://telma.com.mk/2024/06/05/czvetanovska-raspusttane-to-na-sudskiot-sovet-ke-postavi-opasen-presedan-i-dopolnitelno-ke-ja-narushi-doverbata-vo-pravosudstvoto/>.

104 “Krenar Loga ka njoftuar komunitetin ndërkombëtar me letër”, (Кренар Лога со писмо ја извести меѓународната заедница), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 4 qershor 2024, <https://pravda.gov.mk/galerija/3394>.

105 “Faktori i ditës: Kryeministri reagon se ambasadorët ndërhyjnë në punët e brendshme dhe pyet nëse kanë zgjidhje për të ofruar”, (Фактор на денот: Премиерот реагира дека амбасадорите се мешаат во внатрешните работи и бара ако имаат решенија да понудат), Faktor, 4 korrik 2024, <https://faktor.mk/faktor-na-denot-premierot-reagira-deka-ambasadorite-se-meshaat-vo-vnatreshnite-raboti-i-bara-ako-imaat-reshenija-da-ponudat>.

106 “Mickoski: Programi i VMRO-së parashikon shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor, por ne jemi të hapur për propozime”, (Мицкоски: Програмата на ВМРО предвидува распуштање на Судскиот совет, но отворени сме за предлози), Alsat M, 21 gusht 2024, <https://alsat.mk/mk/mitskoski-programata-na-vmro-predviduva-raspusttane-na-sudskiot-sovet-no-otvoreni-sme-za-predlozi/>.

tij të paligjshme tashmë kanë përfunduar mandatin e tyre¹⁰⁷ ose do ta përfundojnë atë deri në fund të dhjetorit 2024, sipas dorëheqjeve të dy anëtarëve nga qershori 2023.¹⁰⁸ Sa i përket anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, ato mund të zëvendësohen gjithmonë me interpelancë, për të siguruar një përbërje më efikase dhe më cilësore të këshillave.

Verpimet transparente të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, pavarësisht disa përmirësimeve, është ende një sfidë. Në periudhën raportuese, shumica e seancave të Këshillit Gjyqësor ishin publike, me praninë e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve.¹⁰⁹ Përpjekjet për rritjen e transparencës janë të jashtëzakonshme duke publikuar rregullisht njoftime për seancat e planifikuara dhe të zhvilluara, si dhe vendimet e marra, të cilat u plotësuan me informacione më të hollësishme dhe më të arsyetuara.¹¹⁰ Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor publikoi njoftime për aktivitetet e përditshme, duke siguruar që publiku të informohej për punën dhe proceset aktuale.¹¹¹ Përmirësim i ndjeshëm u arrit duke transmetuar seancat drejtpërdrejt përmes kanalit të internetit të AIM,¹¹² i cili mundësoi monitorim të rregullt dhe të plotë të punës së Këshillit nga qytetarët. Me qëllim rritjen e transparencës, më 29 mars 2024 u organizua një ditë e hapur për qytetarët, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me publikun.¹¹³ Gjithashtu, më 26 prill 2024, Kryetari i Këshillit Gjyqësor mbajti një konferencë me gazetarë,¹¹⁴ e cila dallohet si një praktikë pozitive që duhet të vazhdohet. Me këto aktivitete, Këshilli Gjyqësor arriti të zbatojë dy nga rekomandimet e misionit vlerësues të BE-së, duke hedhur themelet për nxitjen e mëtejshme të transparencës dhe besimit në institucion.

Megjithatë, vetëm 28% e seancave u mbajtën me përbërje të plotë.¹¹⁵ Vazhdoj dhe praktika, shpjegimet të jepen vetëm kur votimi është “për”, me argumente stereotipike dhe të paqarta, dhe procesverbalet e publikuara të seancave të zhvilluara përmbajnë vetëm rezultate të përmbledhura pa vota individuale,¹¹⁶ pavarësisht përfundimit të datës 27 korrik 2023 për

107 “Njoftim nga seanca e 498-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 10.09.2024”, (Соопштение од 498-та седница на Судскиот совет на РСМ - 10.09.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 shtator 2024, <https://bit.ly/4eDm79A>.

108 “Njoftim për seancën e 444-të urgjente të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 08.06.2023”, (Соопштение за 444. итна седница на Судскиот совет на РСМ – 08.06.2023 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3SSV3v9>.

109 Prania e qytetarëve i referohet pikave në rendin e ditës ku shqyrtohen parashtresat dhe ankesat e qytetarëve për punën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.

110 Monitorimi i faqes zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (portali gjyqësor) - <https://bit.ly/3D8QEyo>.

111 Ibid.

112 “Këshilli Gjyqësor - Seanca”.

113 “Dita e hapur e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me rastin e Ditës së Gjyqësorit 31 Mars”, (Отворен ден на Судскиот совет на Република Северна Македонија по повод одбележувањето на денот на правосудството 31 март), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 mars 2024, <https://bit.ly/3VsPzre>.

114 “Mbahet briefing me përfaqësuesit e mediave”, (Одржан брифинг со претставници на медиумите), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 prill 2024, <https://bit.ly/3Y2hikR>.

115 Arsyet më të zakonshme të dhëna për mungesën e tyre ishin arsyet shëndetësore ose përdorimi i pushimit vjetor, dhe në situata të rralla është mungesa për shkak të detyrimeve zyrtare. Petkovska dhe Tutij, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”, (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година)

116 Në çdo procesverbal të publikuar, ka vetëm: “Regjistri tonal dhe listimi i rezultateve të votimit janë pjesë përbërëse e këtyre procesverbaleve.” «Dokumente të tjera» (Во секој објавен записник, стои единствено: Тонскиот запис и листингот со резултатите од гласањето се составен дел на овој записник. Останати документи) faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/41kdKfp>.

publikimin e listave të votave.¹¹⁷ Ky aspekt kërkon azhurim, i cili mund të realizohet përmes zbatimit të planit të prokurimit publik të miratuar më 12 shkurt 2024 për sigurimin e soft-uerit të regjistrimit dhe votimit.¹¹⁸ Përveç kësaj, justifikimi i pamjaftueshëm për kalimin nga votimi elektronik në votim praktik, si dhe për ndryshimet në rezultate kur përdoren të dyja metodat,¹¹⁹ mbetet një sfidë e rëndësishme që minon besimin dhe transparencën në punën e Këshillit.

Sa i përket transparencës së punës së KPPRMV, mund të thuhet se seancat janë të hapura për publikun dhe mund të ndiqen në të gjitha pikat, përveç atyre ku publiku është i përjashtuar sipas ligjit.¹²⁰ Megjithatë, vetëm 35% e seancave janë zhvilluar me përbërje të plotë, dhe ndryshe nga Këshilli Gjyqësor, arsyet për mungesën e anëtarëve konkret nuk jepen.¹²¹ Për më tepër, mbetet praktikë që anëtarët të debatojnë dhe të vendosin vetëm për pikat e propozuara më parë nga Kryetari i Këshillit, ndërsa iniciativa e anëtarëve për të propozuar pika të reja në rendin e ditës pothuajse mungon.¹²² Për më tepër, mbetet praktikë, vendimet të shpjegohen vetëm kur jepet mbështetje për zgjedhjen e prokurorëve publikë nga radhët e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, ndërsa votimi “ABSTENOI” në zgjedhjen e prokurorëve publikë zakonisht është pa asnjë shpjegim.¹²³ Shpjegimet e dhëna janë të përgjithshme dhe abstrakte, pa argumente specifike, të cilat cenojnë më tej cilësinë e transparencës.¹²⁴ Lidhur me publikimin e faqes në internet, në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese, njoftimet për mbajtjen e seancave kryesisht nuk u publikuan brenda afatit të përcaktuar, që është një hap prapa në këtë aspekt të transparencës.¹²⁵ Megjithatë, zhvillim pozitiv është shpallja e 20 shtatorit 2024 për zhvillimin e një faqeje të re interneti.¹²⁶ Faqja e re është planifikuar të përmbajë njoftime të shkurtra mbi pikat e diskutuara në seanca, si dhe publikim të rregullt të procesverbaleve të standardizuara të seancave të zhvilluara, të cilat mund të përmirësojnë ndjeshëm nivelin e transparencës.¹²⁷

117 “Procesverbali nga seanca e 451-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Записник од 451-та седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија), (Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 korrik 2023), <https://bit.ly/3Vukyn3>.

118 “Procesverbali nga seanca e 477-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Записник од 477-та седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија), (Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 shkurt 2024), <https://bit.ly/3B8ufk7>.

119 Petkovska dhe Tutiq, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”, (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

120 KPPRMV mund t’a përjashtojë publikun vetëm me vendim, për të mbrojtur reputacionin dhe integritetin e prokurorit publik. Sipas nenit 14 të Rregullores së KPPRMV, Këshilli mund të vendosë të përjashtojë publikun nga seancat me shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Nëse Këshilli merr një vendim të tillë, ai është i detyruar të informojë publikun për arsyet e përjashtimit të publikut.

121 Petkovska dhe Tutiq, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”, (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

122 Ibid.

123 Ibid.

124 Ibid.

125 Ibid.

126 “Njoftim publik për seancë të mbajtur më 20.09.2024”, (Соопштение за јавност за одржана седница на ден 20.09.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://sjorm.gov.mk/soopshenie-za-javnost-za-odrzhana-sednica-na-den-20-09-2024-godina/>.

127 Ibid.

Hap pozitiv në këtë periudhë raportuese është miratimi i ndryshimeve në Kodin e Etikës së prokurorëve publikë, në përgjigje të kritikave dhe ankesave shumëvjeçare për ndryshime. Konkretisht, më 8 nëntor 2023,¹²⁸ Këshilli miratoi ndryshimet e propozuara nga Shoqata e Prokurorëve Publikë, me fokus të veçantë në rekomandimet e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO),¹²⁹ të cilat zgjidhën çështje të tilla si përcaktimi i "mikpritjes" dhe rishikimi i ndalimeve në nenet e kontestuara.¹³⁰

Vazhduan aktivitetet për promovimin e transparencës së gjyqësorit nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (GJSRMV) dhe Këshilli Gjyqësor-Mediatik gjatë kësaj periudhe raportuese. Në këtë drejtim, më 12 korrik 2024, GJSRMV miratoi një qëndrim parimor mbi akreditimet e mediave në lëndët civile me interes publik, në përputhje me nenet 6 dhe 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut,¹³¹ dhe më 19 shtator 2024 miratoi ndryshime në Rregulloren e Procedurës, e cila lejonte publicitetin në seancat e përgjithshme dhe praninë e medias, duke theksuar rëndësinë e çështjeve ligjore dhe interesin e publikut.¹³² Në përputhje me këto angazhime gjyqësore, Këshilli Gjyqësor-Mediatik organizoi trajnime për gazetarët për monitorimin e procedurave penale dhe civile,¹³³ duke përdorur terma ligjorë,¹³⁴ dhe nxorri "Udhëzues për gazetarët për publikun në procedurat gjyqësore",¹³⁵ si dhe "Udhëzime për incizim dhe fotografim në sallat e gjyqit".¹³⁶ Këto aktivitete kanë kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e raportimit të informuar mbi gjykimet. Përveç kësaj, përmes Këshillit të Hapur Gjyqësor dhe platformës kombëtare të ndërveprimit, janë zhvilluar shërbime të reja të shkëmbimit të të dhënave për të drejtat sociale të qytetarëve, të cilat së shpejti do të jenë funksionale, duke lejuar qasje më të lehtë në informacion dhe forcimin e transparencës.¹³⁷

128 "Njoftim", (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 nëntor 2023, <https://bit.ly/3GmL1ul>.

129 Shtojca e Raportit në hije të Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29.11.2023.

130 Me ndryshimet, neni 10 paragrafi 6 ndryshohet për të lexuar "Prokurorët publikë në paraqitjet publike duhet të jenë të kujdesshëm që të mos dëmtojnë reputacionin e tyre profesional dhe personal, si dhe reputacionin e Prokurorisë Publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë". Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kodi i Etikës për ndryshimin e Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, tetor 2023, <https://bit.ly/3TWpuB9>.

131 "Gjykata Supreme ka krijuar një qëndrim parimor për akreditimet e mediave në lëndët civile me interes publik", (Врховниот суд утврди начелен став за акредитациите за медиумите во граѓанските предмети од јавен интерес), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2024, <https://bit.ly/3BKmkcs>.

132 "Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme do të jenë publike", (Општите седници на Врховниот суд ќе бидат јавни), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 shtator 2024, <https://bit.ly/4gn8LyK>.

133 "Trajnimi ligjor dy-ditor për monitorimin e lëndëve gjyqësore në procedimet penale dhe civile", (Дводневната правна обука за следење на судските предмети во кривичната и во граѓанската постапка), faqja zyrtare në Facebook e Këshillit Gjyqësor-Mediatik në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 shkurt 2024, <https://www.facebook.com/SMSovet/posts/pfbid02PYHGCG6ULLcEzwP9PXh9GC1KAXqtxWE7KtMNXu3TMuDC2L8tvC6A5zEkUUuzP3gl>.

134 "Trajnimi i parë për terma ligjorë", (Првата обука за правни термини), faqja zyrtare në Facebook e Këshillit Gjyqësor-Mediatik në Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 4 dhjetor 2023, <https://www.facebook.com/SMSovet/posts/pfbid034Z7dQhqqzNoPDLqrTCA3TVi7FzjapVtTYs1zUanwmX1bLEDm9QiUZLnWLEqMiFkml>.

135 Sashe Dimovski dhe Aleksandar Dimitrievski, "Udhëzues për gazetarët për publikun në procedurat gjyqësore", (Водич за новинари за јавност во судските постапки), (Këshilli Gjyqësor-Mediatik, 2024), <https://bit.ly/4g4cNMK>.

136 "Rekomandime për incizim dhe fotografim në sallën e gjyqit", (Препораки за снимање и фотографирање во судница), (Këshilli Gjyqësor dhe Media, 1 qershor 2024), <https://bit.ly/3ZHWOOD>.

137 "Në Gjykatën Supreme, në bazë të përpjekjeve të Këshillit për Gjyqësorin e Hapur, janë përgatitur shërbime të reja për të drejtat sociale të qytetarëve", (Во Врховниот суд, врз основа на заложбите на Советот за отворено судство, подготвени се нови servisi за социjalните права на граѓаните), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 qershor 2024, <https://bit.ly/3ZJc4L8>.

Me qëllim përmirësimin e profesionalizimit dhe kompetencës së gjyqtarëve, si dhe në drejtim të kryerjes së duhur të detyrave gjyqësore, është e nevojshme që gjyqtarët t'i drejtohen më shpesh Trupit Këshillëdhënës të Etikës Gjyqësore. Nga periudha e mëparshme raportuese deri në shtator 2024, Organi Këshillimor nuk ka marrë asnjë kërkesë për mendime këshilluese.¹³⁸

Siç u tha në raportet e mëparshme në hije, një aspekt i rëndësishëm i pavarësisë së sistemit gjyqësor është sigurisht pavarësia financiare. Çështja e pavarësisë financiare dhe rritja e pagave në gjyqësor ka qenë temë e diskutimeve të gjata dhe theksohet si rekomandim dhe masë në Raportin e Misionit Vlerësues të BE për punën e Këshillit Gjyqësor, si dhe në Agjendën e Reformave të Maqedonisë së Veriut për Planin e Rritjes së BE për Ballkanin Perëndimor.¹³⁹ Zbatimi në kohë i këtij rekomandimi dhe mase është i nevojshëm për të përfunduar praktikën e gjatë të ndarjes së një buxheti vjetor për gjyqësorin që është 60% më i vogël se kufiri i vendosur ligjërisht,¹⁴⁰ dhe për prokurorinë publike, 50% nën kufirin ligjor.¹⁴¹

138 "Pyetje dhe përgjigje", (Поставени прашања и одговори), Faqja zyrtare e Trupit Këshillëdhënës të Etikës Gjyqësore, <https://sudiskaetika.mk/#sudija>.

139 "Agjenda e reformave të Maqedonisë së Veriut 2024-2027",

140 "Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023", (Годишен извештај за работата на Судскиот совет на Република Северна Македонија за 2023 година), (Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2024), <https://bit.ly/49uSnK8>.

141 Çdo vit, në vend të buxhetit të përcaktuar ligjërisht të parashikuar në nenin 101 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurorinë Publike, pra 0,4% të shumës së totalit të Rebalancit të Buxhetit për vitin paraardhës, gjysma e kësaj shume miratohet nga Ministria e Financave, domethënë 0,2% të shumës së totalit të Rebalancit të Buxhetit për vitin paraardhës. Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

Digjitalizimi i gjyqësorit dhe AKMIS

Procesi i digjitalizimit në gjyqësor kryhet përmes Këshillit për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Organet Gjyqësore (Këshilli i TIK) nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, përbërja e të cilit u ndryshua gjatë periudhës raportuese. Më 6 nëntor 2023, Ministri i Drejtësisë shkarkoi Kryetarin e Këshillit të TIK, i cili ishte njëkohësisht Kryetar i Gjykatës Themelore Kavadarci, për shkak të raportit të Këshillit Gjyqësor dhe materialeve shoqëruese të paraqitura nga Prokuroria e Lartë Publike Shkup, si dhe korrespondencës nga Këshilli i Prokurorëve Publikë.¹⁴² Shkarkimi ishte pasojë e shkeljeve të përcaktuara të standardeve të integritetit dhe sjelljes së keqe me një palë në një lëndë që ai e gjykonte.¹⁴³ Për më tepër, Ministri filloi një procedurë për vlerësimin e përgjegjësisë së gjyqtarit në Këshillin Gjyqësor¹⁴⁴ dhe miratoi një rregullore të re për funksionimin e Këshillit të TIK.¹⁴⁵ Duke shprehur shqetësimin për pretendimet e ministrit në lidhje me punën e Këshillit të TIK-ut dhe duke e konsideruar punën e tyre të mëtijshme në Këshill si joefektive, dy anëtarët që përfaqësojnë Këshillin Gjyqësor brenda Këshillit të TIK-ut dhanë dorëheqjen.¹⁴⁶ Më 24 janar 2024, u formua një Këshill i ri i TIK, i cili për herë të parë përfshiu një përfaqësues nga sektori civil (Grupi Blueprint për Reforma në Gjyqësor) dhe një përfaqësues nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.¹⁴⁷ Kjo është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj rekomandimeve të sektorit civil, me qëllim forcimin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës së Këshillit.¹⁴⁸ Seanca konstituive e përbërjes së re u mbajt më 6 shkurt 2024, dhe deri më 30 shtator 2024, Këshilli mbajti gjithsej 10 seanca.¹⁴⁹ Në këtë periudhë, ai vijoi me aktivitetet e nisura nga përbërja e mëparshme, duke u fokusuar në digjitalizimin e gjyqësorit dhe ndërveprimin institucional. Sa i përket digjitalizimit të gjyqësorit, Këshilli punoi për të eliminuar gabimet dhe mangësitë teknike të zbuluara në gjykata të caktuara, me qëllim sigurimin e funksionalitetit të sistemit në nivel kombëtar.¹⁵⁰ Lidhur me ndërveprimin institucional, Këshilli zhvilloi teste ndërinstitutionale mbi funksionalitetin e sistemit, me fokus integrimin midis gjykatave dhe institucioneve të tjera gjyqësore.¹⁵¹

142 “Ministri Lloga shkarkoi gjyqtarin Nanev nga kryesia e TIK-ut për gjyqësorin, kërkoi nga Këshilli Gjyqësor të fillojë një procedurë për përgjegjësinë e tij”, (Министерот Лога го разреши судијата Нанев од претседател на ИКТ за судството, побара Судскиот совет да поведе постапка за одговорност за него), Sakam da Kazam, 6 nëntor 2023, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/ministerot-loga-go-razreshi-sudijata-nanev-od-pretседател-na-ikt-za-sudstvoto-pobara-sudski-ot-sovet-da-povede-postapka-za-odgovornost-za-nego/>.

143 Prokurori i Lartë Publik i Shkupit, Mustafa Hajrullahi, bazuar në të dhënat dhe provat e marra më parë nga Prokuroria Themelore Publike Kavadarci, dorëzoi një raport të detajuar në Këshillin Gjyqësor, në të cilin renditen 74 thirrje nga gjyqtari Llazar Nanev me një palë në një lëndë që ai e gjykonte.

144 “Ministri Lloga shkarkoi gjyqtarin Nanev nga kryesia e TIK për gjyqësorin, kërkoi nga Këshilli Gjyqësor të fillojë procedurat për përgjegjësinë e tij”.

145 “Rregullore për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Organet Gjyqësore,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 265/23.

146 “Gjyqtarja Loretta Gjorgieva dhe z. Milazim Mustafa i dorëzuan dorëheqjet e tyre Ministrit të Drejtësisë, Krenar Lloga”, (Судијата Лорета Ѓорѓиева и м-р Миљазим Мустафа поднесоа оставки до министерот за правда, Кренар Лога), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 nëntor 2023, <https://bit.ly/48ul6hc>.

147 “Krijohet përbërja e re për Këshillin e TIK-ut në gjyqësor”, (Формиран новиот состав за Советот на ИКТ во правосудството),- faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 25 janar 2024, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6654>.

148 Delevska dhe Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022”.

149 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj një kërkesë për qasje të lirë në informacionin publik”, 19 dhjetor 2024.

150 Ibid.

151 Ibid.

Në kuadër të digjitalizimit të Prokurorisë Publike, në kuadër të Projektit të BE për Sundimin e Ligjit, kanë filluar aktivitetet për përgatitjen e një specifíkimi teknik për krijimin e një sistemi të ri elektronik për menaxhimin e lëndëve penale.¹⁵² Në këtë drejtim, u krye një analizë e thellë e nevojave të prokurorive, me qëllim zhvillimin e një sistemi funksional që do të lejojë hyrjen dhe përpunimin e aplikimeve të reja, ruajtjen digjitale të të gjitha dokumenteve që lidhen me lëndët dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë dhe shkëmbimin e të dhënave me institucionet e tjera gjyqësore, si Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Administrata Doganore dhe gjykatat.¹⁵³ Kjo do të lejojë transferimin e automatizuar të të dhënave në dhe nga këto institucione, duke filluar nga momenti i përgatitjes së tyre.¹⁵⁴ Në këtë kontekst, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut pritet të krijojë një grup të posaçëm pune për digjitalizimin në periudhën e ardhshme, i cili do të përqendrohet në përcaktimin e karakteristikave funksionale të sistemit. Shoqata e Prokurorëve Publikë gjithashtu do të marrë pjesë në procesin e zhvillimit dhe zbatimit.¹⁵⁵

Sipas raporteve dhe planit për mbikëqyrje mbi funksionalitetin e AKMIS, mbikëqyrja e funksionimit të AKMIS kryhet rregullisht.¹⁵⁶ Gjegjesisht, sipas të dhënave të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë, në gjykata për vitin 2023 është kryer mbikëqyrja e shtatë gjykatave dhe deri në shtator 2024 është kryer mbikëqyrja e gjashtë gjykatave.¹⁵⁷ Procesverbalet e këtyre mbikëqyrjeve, me gjetjet, publikohen rregullisht në faqen e internetit të Ministrisë. Deri në fund të vitit 2024, pritet të publikohen të gjitha mbikëqyrjet e kryera në vitin aktual, duke qenë se procesverbalet dorëzohen më parë në gjykatat ku është kryer mbikëqyrja.

152 “Përmes projektit “BE – mbështetje për sundimin e ligjit”, Prokuroria Publike do të marrë një sistem të ri elektronik të menaxhimit të lëndëve”, (Преку проектот „ЕУ – поддршка за владеење на правото“ јавното обвинителство ќе добие нов електронски систем за управување со предметите), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 maj 2024, <https://jorm.gov.mk/preku-proektot-eu-poddrshka-za-vladeene-na-pravoto-javnoto-obvinitelstvo-ke-dobie-nov-elektronski-sistem-za-upravuvane-so-predmetite/>.

153 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj një kërkesë për qasje të lirë në informacionin publik”, 19 dhjetor 2024.

154 Ibid.

155 “Nëpërmjet projektit “BE – mbështetje për sundimin e ligjit”, Prokuroria Publike do të marrë një sistem të ri elektronik të menaxhimit të lëndëve”.

156 „Procesverbale nga këqyrje në gjykata”, (Записници од увид во судови), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, <https://www.pravda.gov.mk/resursi/22>.

157 Ministria e Drejtësisë, “Procesverbal nga këqyrje në gjykata”, (Записници од увид во судови), <https://www.pravda.gov.mk/resursi/22>.

Ka nevojë për zbatim konsistent të dispozitave ligjore dhe dispozitave të Rregullores së punës së KGJRMV në lidhje me transparencën dhe publicitetin në punën e Këshillit Gjyqësor, si dhe shfuqizimin e praktikës së marrjes së vendimeve për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve pa argumentim dhe pas dyerve të mbyllura;

Publikimi i vendimeve të arsyetuara për zgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve publikë, si dhe vendimet e tjera të Këshillit të Prokurorëve Publikë, është i një rëndësie të veçantë për kthimin e besimit të qytetarëve në prokurorinë publike. Nevojitet transparencë aktive edhe në pjesën e marrëdhënieve me publikun dhe publikimin e informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme të Këshillit të Prokurorëve Publikë me qëllim afrimin e punës së Këshillit me publikun dhe afirmimin e kompetencave të Këshillit.;

Zbatimi në kohë i rekomandimit dhe masave të Raportit të misionit vlerësues të BE-së për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Agjendën e Reformës së Maqedonisë së Veriut për Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor është i nevojshëm për rritje të buxhetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike sipas kufirit të parashikuar ligjërisht;

Është e nevojshme të kryhet një analizë e plotë e përdorimit të deritanishëm të sistemit AKMIS për të përcaktuar nëse është e nevojshme të futet një sistem i ri softuerik ose të përmirësohet ai ekzistuesi. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përcaktohen burimet financiare të disponueshme nga shteti për të siguruar funksionimin e tij të qëndrueshëm dhe efikas. Ekziston gjithashtu nevojja për mbikëqyrje të zgjeruar të funksionalitetit të sistemit, sanksionim të menjëherëshëm për abuzime të mundshme, si dhe raportim të detajuar nga Ministria e Drejtësisë për masat e marra. Përveç kësaj, Ministria duhet të sigurojë transparencë më të madhe në informimin për punën e Këshillit të TIK-ut.



Përgjegjësi

Në zbatim të ndryshimeve legjislativë të vitit 2019,¹⁵⁸ në periudhën raportuese, u përcaktua përfundimi i funksionit gjyqësor të një gjyqtari, bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me një dënim të pakushtëzuar me burgim prej të paktën gjashtë muajsh.¹⁵⁹ Bëhet fjalë për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, i cili në korrik 2023 kandidoi dhe u zgjodh anëtar i Këshillit Gjyqësor pavarësisht procedurave disiplinore në vazhdim kundër tij,¹⁶⁰ dhe i cili më pas u tërhoq nga pozicioni i tij për të lejuar që djali i tij të emërohej gjyqtar.¹⁶¹ Vendimi për shkarkimin e tij, i marrë më 16 gusht 2024, doli nga një vendim përfundimtar i Gjykatës Themelore Penale Shkup,¹⁶² në bazë të një propozim-marrëveshjeje me PTHPNKOK, e cila e dënoi atë me tre vjet burg për pranimin e shpërblimit për ndikim të paligjshëm,¹⁶³ me llogaritje kohore nga fillimi i paraburgimit më 20 maj 2024.¹⁶⁴ Më parë, në një seancë urgjente dhe të planifikuar në mënyrë jotransparente të Këshillit Gjyqësor të mbajtur më 21 maj 2024,¹⁶⁵ gjyqtarit iu hoq imuniteti, iu dha paraburgimi dhe u hoq përkohësisht nga detyra.¹⁶⁶ Këto vendime janë marrë pa votim publik¹⁶⁷ dhe pa interpretimin e duhur të

158 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 96/2019; "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 102/2019.

159 "Njoftim nga seanca urgjente e 495-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 16.08.2024", (Соопштение од 495-та итна седница на Судскиот совет на РСМ - 16.08.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3YbYu0G>.

160 "Naqe Georgiev dhe Antoaneta Dimovska të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve si anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor", (HaKe Георгиев и Антоанета Димовска избрани од редот на судиите за нови членови на Судскиот совет), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 korrik 2023, <https://bit.ly/45cjt0h>.

161 "Rrugëtimi i paqartë" i gjyqtarit suprem Naqe Georgiev – Pas më pak se dy javësh, anëtari i ri i Gjykatës dha dorëheqjen, në mënyrë që djali të mund të bëhej gjyqtar", (Нејасната 'турнеја' на врховниот судија Наке Георгиев – По нецели две недели новиот член на Судски поднесе оставка, за синот да стане судија), Prisma – Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Humlumtues (BIRN) Maqedoni, 25 korrik 2023, <https://prizma.mk/nejasnata-turneja-na-vrhovniot-sudija-nake-georgiev/>.

162 "Njoftim publik", (Соопштение за јавност), faqja zyrtare e Gjykatës Themelore Penale Shkup, 15 gusht 2023, <https://bit.ly/3BoTzLU>.

163 "Gjykatësi Suprem Naqe Georgiev u arrestua, ai u kap në momentin e marrjes së ryshfetit, tha Ministria e Brendshme", (Уапсен врховниот судија Наке Георгиев, фатен е во моментот дека зема мито, кажа МВР), Sakam da Kazam, 20 maj 2024, <https://bit.ly/468ksp8>.

164 "Propozim – marrëveshje e arritur për dënim me burg dhe ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës", (Постигната предлог – спогодба за затворска казна и забрана за вршење професија, дејност или должност), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 gusht 2024, <https://jorm.gov.mk/postignata-predlog-spogodba-za-zatvorska-kazna-i-zabrana-za-vrshene-profesija-dejnost-ili-dolzhnost/>.

165 Seanca u caktua në mesnatë, e cila ndikon drejtpërdrejt në të drejtën e publikut për t'u informuar në kohë për zhvillimin e seancave të Këshillit Gjyqësor, në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. "Reagimi publik i Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë" për seancën e 487-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", (Јавна реакција на Коалицијата „Сите за правично судење“ за 487-та седница на Судскиот совет на РСМ), <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2024/05/34-JR-SS-052024.pdf>.

166 Njoftim nga seanca urgjente e 487-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 21.05.2024", (Соопштение од 487-та итна седница на Судскиот совет на РСМ – 21.05.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3zGApqq>.

167 Megjithëse fillimi i seancës ishte publik dhe një link për të u publikua në faqen zyrtare të Këshillit, votimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për vendimin nuk ishte publik. Sipas ligjit, përjashtimi i publikut mund të bëhet vetëm me qëllim mbrojtjen e reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit, duke informuar siç duhet publikun për arsyet e përjashtimit. Megjithatë, kur një vendim merret me votim në këtë lloj seance, votimi duhet të jetë publik. "Reagim publik i Koalicionit" Të gjithë për gjykim të drejtë" për seancën e 487-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

dispozitive ligjore për përcaktimin e ndalimit dhe largimit të përkohshëm nga ushtrimi i funksionit gjyqësor.¹⁶⁸

Propozim-marrëveshje me PTHPNKOK është arritur edhe me të pandehurin e dytë të rastit,¹⁶⁹ i cili ka pranuar krimin.¹⁷⁰ Ai ishte anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe ish-avokat i popullit. Detajet e rolit të tij dhe rezultatit të lëndës shpjegohen më hollësisht në seksionin “Organet drejtuese”.

Në periudhën raportuese, Këshilli Gjyqësor ka filluar tri procedura disiplinore, me ç’rast gjyqtarët ndaj të cilëve janë parashtruar kërkesat për fillimin e procedurës, në pajtim me nenin 61 paragrafi 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, kanë kërkuar që procedura të zhvillohet në publik.¹⁷¹ E para, u iniciua pas pretendimeve të bëra nga Kryetarja e Gjykatës Supreme në një intervistë për portalin maqedonas të 3 nëntorit 2023, ku ajo theksoi presionin politik mbi gjyqtarët e Gjykatës Supreme.¹⁷² Këto pretendime nxitën një anëtar të Këshillit të paraqiste një kërkesë për përgjegjësinë e saj,¹⁷³ duke përmendur mungesën e saj në seancat e Këshillit, përfshirë seancën në të cilën ajo u thirr për të sqaruar pretendimet,¹⁷⁴ e cila, sipas kërkueses, pengoi pjesëmarrjen e saj aktive dhe marrjen e masave të nevojshme.¹⁷⁵ Kërkesa tërhoqi kritika nga komuniteti akademik dhe sektori civil,¹⁷⁶ të cilat vunë në dyshim legjitimitetin e një iniciative nga një anëtar i Këshillit për të mbajtur Kryetaren e Gjykatës Supreme përgjegjëse

168 Këshilli, me kërkesë të një gjyqtari nga një procedurë paraprake, vendosi heqjen e imunitetit të tij dhe dhënien e paraburgimit përpara se të merrej një vendim gjyqësor për paraburgim ose të mbahet gjykim. Ky vendim i Këshillit Gjyqësor për të dhënë masën e paraburgimit mund të konsiderohet se paragjykon rezultatin e procedurës së paraburgimit përpara një gjykate themelore. Këshilli vendosi edhe për largimin e përkohshëm të gjyqtarit nga detyra. Sipas ligjit, një vendim i tillë merret kur gjyqtari është në paraburgim, procedimi penal zhvillohet për një vepër penale për të cilën parashikohet një dënim me burg prej të paktën pesë vjet ose kur fillon një procedurë e përgjegjësisë ndaj tij, por asnjë nga këto kushte nuk ishte përmbyshur në këtë rast. Ibid.

169 “Në një skemë me gjyqtarin suprem të arrestuar Georgiev, ishte Ixhet Memeti, anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë, i dyshuar për shitjen e informacionit për para”, (Во шема со уапсениот врховен судија Георгиев, бил Ицет Мемети, член на Советот на јавни обвинители, осомничени дека продавале информации за пари), Sakam da Kazam 21 maj 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/vo-shema-so-uapseniot-vrhoven-sudija-bil-idhet-memeti-chlen-na-sovetot-na-javni-obviniteli-osomnicheni-deka-prodavale-informatsii-za-pari/>.

170 “Arrihet propozim-marrëveshja me një të dyshuar për marrjen e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm”.

171 “Këshilli Gjyqësor pranoi kërkesën e Besa Ademiti për publicitet në seancën në të cilën do të vendoset kërkesa për shkarkimin e saj”, (Судскиот совет го прифати барањето на Беса Адеми за јавност на седницата на која ќе се одлучува по иницијативата за нејзино разрешување), 360 Stepeni, 26 dhjetor 2023, <https://360stepeni.mk/sudskiot-sovet-go-prifati-baraneto-na-besa-ademi-za-javnost-na-sednitsata-na-koja-ke-se-odluchuva-po-initsijativata-za-nejzino-razreshuvane/>; “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 shtator 2024, <https://bit.ly/4h73wV6>.

172 “Ekziston një kërcënim politik për të shkarkuar gjyqtarë suprem, por nuk ka bazë për të ringjallur shfuqizimin e Gruevskit, thotë Kryetarja e Gjykatës Supreme Besa Ademi”, (Присутна е политичката закана за разрешување на врховни судии, ама нема основа да оживее абolicijата на Груевски, вели претседателката на Врховниот суд, Беса Адеми), Sakam da Kazam, 3 nëntor 2023, <https://bit.ly/4tO7s3>.

173 “Kryetarja e Gjykatës Supreme Besa Ademi mori kërkesë për shkarkim në Këshillin Gjyqësor pas paralajmërimit të presionit dhe kërcënimeve nga zyrtarët”, (Претседателката на Врховниот суд, Беса Адеми, доби иницијатива за разрешување во Судскиот совет, откако предупреди за притисоци и закани од функционери), Sakam da Kazam, 28 nëntor 2023, <https://bit.ly/3Ua6SO6>.

174 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 3 nëntor 2023, <https://bit.ly/3vtOupb>.

175 “Stafi politik në Këshillin Gjyqësor Milazim Mustafa e kërcënoi Kryetaren e Gjykatës Supreme me burgim sepse ajo foli për presionet në një intervistë me SAKAMDAKAZAM.MK, dhe nuk u raportoi atyre”, (Политичкиот кадар во Судскиот совет Миљазим Мустафа ѝ се закани со затвор на претседателката на Врховниот Суд затоа што за притисоците зборувала во интервју за SAKAMDAKAZAM.MK, а не пријавила кај нив), Sakam da Kazam, 29 dhjetor 2023, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/politichkiot-kadar-vo-sudskiot-sovet-milazim-mustafa-se-zakani-so-zatvor-na-pretседателката-na-vrhovniot-sud-zatoa-shto-za-pritisocite-zboruvava-vo-intervju-za-sakamdakazham-mk-a-ne-prijavila-kaj-niv/>.

176 “Grupi Blueprint për Reforma në Gjyqësor bëri thirrje për veprim të kujdesshëm në procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së Kryetares të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Блупринт групата за реформи во правосудството повика на внимателно постапување во постапката за утврдување одговорност на претседателката на Врховен суд на Република Северна Македонија), faqja zyrtare e SHMJR, 29 dhjetor 2023, <https://myla.org.mk/49779/>.

në pozitën e saj si anëtare e Këshillit, pa të drejtë vote.¹⁷⁷ Me ligj, përgjegjësia e saj lidhet ekskluzivisht me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara nga Ligji për Gjykatat,¹⁷⁸ dhe jo me rolin e saj në Këshill. Për më tepër, dispozitat kushtetuese që lejojnë anëtarët në detyrë, siç janë Kryetarja e Gjykatës Supreme dhe Ministri i Drejtësisë, të mos marrin pjesë në seanca konsiderohen praktikë e mirë për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të jashtme.¹⁷⁹

Komiteti i Raportuesve, i përbërë nga tre anëtarë, zhvilloi një seancë dëgjimore publike më 29 dhjetor 2023, në të cilën të dyja palët paraqitën argumentet e tyre dhe u paraqitën provat e propozuara.¹⁸⁰ Pas debatit, komisioni përgatiti një raport mbi situatën e krijuar, i cili së bashku me të gjitha të dhënat iu dorëzua Këshillit Gjyqësor.¹⁸¹ Në seancën e mbajtur më 17 janar 2024, Këshilli Gjyqësor shqyrtoi raportin dhe me 7 vota pro vendosi ndërprerjen e procedurës disiplinore.¹⁸²

Dy procedurat e tjera disiplinore u ngritën kundër një gjyqtari të Gjykatës Themelore Kavadarci dhe ish-kryetarit të tij.¹⁸³ Procedura e dytë, e iniciuar nga një anëtar i Këshillit Gjyqësor, u bazua në raportin mbi situatën në Gjykatën Themelore Kavadarci nga viti 2023 të Këshillit Gjyqësor, të përgatitur në bazë të provave të paraqitura nga Prokurori i Lartë Publik nga Shkup-i dhe një prokuror nga Prokuroria Themelore Publike Kavadarci.¹⁸⁴ Provat tregonin kryerjen e pakujdesshme dhe joprofesionale të detyrës gjatë kryesis së gjyqtarit, me theks të veçantë në 95 telefonata me një të pandehur në një lëndë që ai drejtonte.¹⁸⁵ Procedura e tretë është iniciuar nga Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, për shkak të fyerjeve dhe akuzave që, sipas saj, cenon reputacionin e saj.¹⁸⁶ Debat i për procedurën e dytë u zhvillua më 11 shtator 2024,¹⁸⁷ pas një shtyrjeje në korrik të të njëjtit vit.¹⁸⁸ Gjyqtari, edhe pse ka kërkuar seancë publike për

177 Petkovska dhe Tutiq, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

178 "Ligji për Gjykatat", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 58/2006; 62/2006; 35/2008; 61/2008; 118/2008; 16/2009; 150/2010; 39/2012; 83/2018; 198/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/2019.

179 "Misioni Vlerësues i BE-së thotë se Besa Ademi nuk shkel ligjin duke mos shkuar në seancat e Këshillit Gjyqësor", (Оценската мисија на ЕУ вели дека Беса Адеми не го крши законот со неодоњето на седниците на Судскиот совет),³⁶⁰ Stepeni, 21 dhjetor 2023, <https://360stepeni.mk/otsenskata-misija-na-eu-veli-deka-besa-ademi-ne-go-krshi-zakonot-so-neodeneto-na-sednitsite-na-sudskiot-socket/>; Komisioni Evropian, "Dokumenti i punës i Komisionit – Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023", (Работен документ на комисијата – Извештај за Северна Македонија за 2023 година), 8 nëntor 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf.

180 "(Jo)shkarkimi i Besa Ademir – provim i ri për Këshillin Gjyqësor", ((Не)разрешувањето на Беса Адеми – нов испит за Судскиот Совет), Radio Evropa e Lirë, 29 dhjetor 2023, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/ne-razreshuvanjeto-na-besa-ademi---nov-ispit-za-sudskiot-socket/32752098.html>.

181 Petkovska dhe Tutiq, "Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024", (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

182 "Njoftim nga seanca e 473-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 17.01.2024", (Соопштение од 473-та седница на Судски совет на РСМ – 17.01.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4ban4nB>.

183 "Njoftim", (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 shtator 2024, <https://bit.ly/4h73wV6>.

184 "Gjyqtari Nanev ka kryer 95 telefonata me një të pandehur në një lëndë që ka gjykuar", (Судијата Нанев остварил 95 телефонски повици со обвинет во предмет кој го судел), TV Telma, 11 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/11/sudijata-nanev-ostvaril-95-telefonski-poviczi-so-obvinet-vo-predmet-koj-go-sudel/>.

185 "Këshilli Gjyqësor mbajti seancë publike për gjyqtarin Nanev, por ai nuk erdhi në seancë", (Судскиот совет одржа јавна расправа за судијата Нанев, но тој не дојде на седницата), Agjencia Informative Mediatike – AIM, 11 shtator 2024, <https://bit.ly/41rldZY>.

186 "Fyerje dhe akuza të ndërsjella mes Damevës dhe Nanevit në seancën e Këshillit Gjyqësor", (Кавра и меѓусебни обвинувања на Дамева и Нанев на седницата на Судски совет), TV Telma, 18 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/18/kavga-i-megusebni-obvinuvana-na-dameva-i-nanev-na-sednicata-na-sudski-socket/>.

187 "Njoftim."

188 "Këshilli Gjyqësor zhvilloi seancë dëgjimore publike për gjyqtarin Nanev, por ai nuk erdhi në seancë."

pretendimet, nuk ka marrë pjesë në seancë.¹⁸⁹ Debati i procedurës së tretë u zhvillua më 18 shtator 2024,¹⁹⁰ gjatë së cilës të dy palët (kërkuesja dhe gjyqtari) shkëmbyen fyerje dhe poshtërsime personale.¹⁹¹ Rezultati i këtyre procedurave do të dihet në periudhën e ardhshme.

Në periudhën raportuese, Këshilli Gjyqësor gjithashtu vendosi pas procedurës disiplinore të filluar në periudhën e mëparshme raportuese të përcaktojë përgjegjësinë e një gjyqtari nga Gjykata e Apelit Shkup, si rezultat i hetimit të Këshillit që gjeti një vonesë të pajustificuar në rastet “Target-Kalaja”¹⁹² dhe “Thesari”,¹⁹³ të cilat shkelën afatet e përcaktuara ligjërisht.¹⁹⁴ Megjithatë, masa disiplinore e vendosur — ulja e pagës mujore të gjyqtarit me 20% për gjashtë muaj¹⁹⁵ — shkaktoi reagime publike, duke treguar mospërputhje të perceptuara në zbatimin e dënimeve disiplinore dhe perceptimin e mosndëshkimit të sistemit.¹⁹⁶

Në zbatim të ndryshimeve ligjore të vitit 2020,¹⁹⁷ në periudhën raportuese, Këshilli i Prokurorëve Publikë shkarkoi një prokuror publik.¹⁹⁸ Bëhet fjalë për ish-kryetaren e PTHPNKOK, e cila u shkarkua në bazë të Vendimit të Komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorit publik në kryerjen e funksionit të prokurorit publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (PPRMV) të 30 marsit 2023.¹⁹⁹ Vendimi konstaton se ish-kryetarja e PTHPNKOK ka kryer një vepër të rëndë disiplinore në kryerjen e funksionit të prokurorit publik.²⁰⁰ Pas pranimit të propozimit nga Komisioni dhe miratimit të vendimit, prokurorja publike zgjodhi të tërhiqej në vend që të apelonte në Këshill.²⁰¹

189 Ibid.

190 “Njoftim.”

191 “Dameva kërkon përgjegjësi për gjyqtarin Nanev, ai u përgjigj se ajo ishte një mjeshtre e spinit që vepronte si një diktatore”, (Дамева бара одговорност за судијата Нанев, тој ѝ одговори дека е спин-мајстор кој постапува како диктатор), 360 Stepeni, 18 shtator 2024, <https://360stepeni.mk/dameva-bara-odgovornost-za-sudijata-nanev-toj-odgovori-deka-e-spin-majstor-koj-postapuva-kako-diktator/>.

192 “Njoftim për publikun”, (Соопштение за јавност), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 dhjetor 2022, <https://bit.ly/3Rg4S3H>.

193 “Njoftim për publikun”, (Соопштение за јавност), Gjykata e Apelit Shkup – Portali Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 nëntor 2022, <https://bit.ly/3R0Z2m5>.

194 “Njoftim nga seanca e 427-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 11.01.2023”, (Соопштение од 427. седница на Судскиот совет на PCM – 11.01.2023 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3oazSaw>.

195 “Njoftim nga seanca e 465-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 23.11.2023”, (Соопштение од 465-та седница на Судскиот совет на PCM – 23.11.2023 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4fel7Hc>.

196 Publiku reagoi ndaj shkarkimit të gjyqtareve Lidija Nedellkova dhe Sofija Laliq në vitin 2021 për shkak të shkeljeve më të lehta disiplinore. “Për shkarkimin e gjyqtarit duhen tetë vota dhe në rastin e Enver Bexhetit nuk ka pasur mjaftueshëm”, (Потребни се осум гласа за разрешување на судија, а во случајот со Енвер Бецети немаше толку многу), thotë kryetari i Këshillit Gjyqësor, 360 Stepeni, 27 nëntor 2023, <https://360stepeni.mk/potrebn-se-osum-glasa-za-razreshuvane-sudija-a-vo-sluchajot-so-enver-bedheti-nemashe-veli-pretседателот-na-sudskiот-совет/>.

197 “Ligji për Prokurorinë Publike”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020; “Ligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

198 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik», 18 dhjetor 2024.

199 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 mars 2023, <https://jorm.gov.mk/soopshstenie/>.

200 Ibid.

201 “Ruskovska: Pas vendimit të shkarkimit, do të dal në pension”, (Русковска: По отказното решение одам во пензија), Deutsche Welle, 23 nëntor 2023, https://www.dw.com/mk/vilma-ruskovska-odlukata-za-razresuvane-e-ocekuvana-odam-vo-penzija/a-67531011?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

Gjithashtu, brenda kompetencave të saj ligjore si autoritet dytësor në procedimet disiplinore për prokurorët publikë,²⁰² Këshilli i Prokurorëve Publikë vendosi për dy lëndë më 20 shtator 2024, duke marrë parasysh ankesat e paraqitura nga katër prokurorë publikë,²⁰³ për procedurat e filluara disiplinore në lidhje me ngjarjet e 27 prillit 2017.²⁰⁴ Gjatë seancës, Këshilli përjashtoi publikun nga referimi dhe shqyrtimi i lëndëve, por vendimet për ankimet u morën në publik, me publikun përsëri të pranishëm.²⁰⁵ Në rastin e parë, i cili kishte të bënte me tre prokurorë publikë nga Prokuroria e Lartë Publike në Shkup, Prokuroria Themelore Publike në Shkup (PTHP Shkup) dhe Prokuroria Themelore Publike në Berovë, procedurat disiplinore u pezulluan për shkak të kohëzgjatjes së propozimit për fillimin e tyre.²⁰⁶ Në rastin e dytë, lidhur me Prokurorin Publik nga Prokuroria Publike në Shkup, Këshilli refuzoi ankesën si të pabazuar dhe konfirmoi vendimin e Komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorit publik në kryerjen e funksionit të prokurorit publik në Prokurorinë Publike në Shkup.²⁰⁷ Prokurori publik është shpallur fajtor për kundërvajtje të rëndë disiplinore dhe i është caktuar masë disiplinore — ulje prej 30% të pagës mujore për gjashtë muaj.²⁰⁸

Gjatë periudhës raportuese, Komisioni për Përcaktimin e Përgjegjësisë Disiplinore të Prokurorit Publik në Kryerjen e Funksionit të Prokurorit Publik në PPRMV nuk paraqiti asnjë vendim të ri për fillimin e procedurës disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorit publik për shkelje disiplinore të kryer.²⁰⁹

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK),²¹⁰ iu dorëzua institucioneve kompetente për përcaktimin e përgjegjësisë së kryetares dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPP).²¹¹ Konkretisht, nisma kishte të bënte me shkeljet e Kodit Zgjedhor²¹² dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të

202 Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë, në nenin 51 parashikon se në procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve publikë, Këshilli vepron si autoritet dytësor me rast të ankesës së deklaruar më parë nga prokurori publik kundër të cilit zhvillohen procedurat. Prandaj, Këshilli ka në dispozicion disa opsione, përkatësisht anulimin ose konfirmimin e vendimit të komisionit që vendos në shkallë të parë, si dhe pranimin ose refuzimin e propozimit për shkarkim. “Ligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020.

203 “Njoftim publik për seancë të mbajtur më 20.09.2024”, (Соопштение за јавност за одржана седница на ден 20.09.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://sjorm.gov.mk/soopshenie-za-javnost-za-odrzhana-sednica-na-den-20-09-2024-godina/>.

204 “Procedura disiplinore për prokurorët nga data 27 prill është ndërprerë pas 7 vitesh”, (Дисциплинската постапка за обвинителите од 27 април запрена после 7 години) TV Telma, 20 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/20/disciplinskata-postapka-za-obivniteite-od-27-april-zaprena-posle-7-godini/>.

205 Petkovska dhe Tutiq, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”, (Извештај од мониторингот на Судскиот совет и Советот на јавните обвинители во 2024 година),

206 “Njoftim publik për seancë të zhvilluar më datë 20.09.2024”.

207 Ibid.

208 Ibid.

209 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik», 18 dhjetor 2024.

210 “Iniciativa për përcaktimin e përgjegjësisë për drejtoreshën dhe bordin drejtues të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, (Иницијатива за утврдување одговорност за директорката и управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 23 maj 2024, <https://bit.ly/3Lqp40o>.

211 Të parashikuara në nenet 9 dhe 14 të “Ligjit për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 129/2023.

212 “Kodi Zgjedhor”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 127/2006; 136/2008; 148/2008; 155/2008; 163/2008; 44/2011; 51/2011; 142/2012; 31/2013; 34/2013; 14/2014; 30/2014; 31/2015; 196/2015; 35/2016; 97/2016; 99/2016; 136/2016; 142/2016; 57/2017; 67/2017; 125/2017; 35/2018; 99/2018; 140/2018; 208/2018; 27/2019, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2019; 146/2019; 42/2020; 74/2021; 215/2021; 58/2024; 76/2024.

Interesit,²¹³ në lidhje me ndalimin e punësimit dhe shkarkimit nga puna në institucionet publike gjatë një periudhe zgjedhore,²¹⁴ e cila shpjegohet më hollësisht në seksionin “Cilësia e Drejtësisë”. Kërkesa, e paraqitur më 23 maj 2024, u hodh poshtë nga Këshilli Gjyqësor,²¹⁵ Këshilli i Prokurorëve Publikë²¹⁶ dhe Shoqata e Gjyqtarëve²¹⁷ në korrik 2024 si e vonuar. Sipas tyre, nisma është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej 15 ditësh, të përcaktuar në nenin 33, pika 7, të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, të llogaritur nga marrja e vendimit të fundit të Gjykatës së Lartë Administrative.²¹⁸ KSHPK e kundërshtoi këtë interpretim, duke shtuar se afati është udhëzues, jo parandalues, sepse ligji nuk parashikon pasoja për humbjen e afatit.²¹⁹ Komisioni vuri në dukje se mësoi për refuzimin përmes raporteve të medias dhe njoftoi një kundërshtim të vendimit me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion pas marrjes së njoftimit zyrtar.²²⁰

Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave të reja të Rregullores së Procedurës, veçanërisht në lidhje me procedurat e përditësuara dhe respektimin e rreptë të afateve në të gjitha fazat e procedurave për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të një gjykate. Është gjithashtu e nevojshme të sigurohet vazhdimësi dhe proporcionalitet në vendosjen e masave disiplinore në përputhje me peshën e shkeljes, në mënyrë që të rritet besimi në sistemin e drejtësisë dhe të eliminohet perceptimi i mosndëshkimit;

Kërkohet veprimi në kohë dhe efektiv mbi ankesat për shkarkimin e prokurorëve publikë nga Këshilli i Prokurorëve Publikë në mënyrë që të mundësohet përcaktimi i shpejtë i përgjegjësisë së mundshme dhe të parandalohet ndërprerja e mundshme e procedurave në vazhdim.

213 “Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 12/2019.

214 Ibid.

215 “Njoftim nga seanca e 492-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 08.07.2024”, (Соопштение од 492-та седница на Судскиот совет на РСМ - 08.07.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4f9v3Dp>.

216 “Procesverbali i seancës së 106-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë.”

217 “Shoqata e Gjyqtarëve ka vendosur që iniciativa e KSHPK-së për përgjegjësi të Bordit Drejtues të AGJPP-së është e vonuar”, (Здружението на судии одлучи дека иницијативата на ДКСК за одговорност на УО на АСЈО е ненавремена), МКД, mk, 11 korrik 2024, <https://mkd.mk/zdruzhenieto-na-sudii-odluchi-deka-inicijativata-na-dksk-za-odgovornost-na-uo-na-as-jo-e-nenavremena/>.

218 “Njoftim nga seanca e 492-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 08.07.2024.”; “Shoqata e Gjyqtarëve ka vendosur që iniciativa e KSHPK-së për përgjegjësinë e Bordit Drejtues të AGJPP-së është e vonuar”; “Procesverbali i seancës së 106-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë.”

219 “Njoftim në lidhje me vendimin e Këshillit Gjyqësor”, (Соопштение во врска со одлука на Судскиот совет), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 9 korrik 2024, <https://bit.ly/4dPBdld>.

220 Ibid.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Pjesa më e madhe e periudhës raportuese u shënua nga ndalimi i proceseve për zgjedhjen dhe vlerësimin e përgjegjësive të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve gjatë zgjedhjeve presidenciale²²¹ dhe parlamentare^{222, 223}. Ky vendim u bazua në një njoftim publik nga KSHPK,²²⁴ i cili i referohej dispozitave të Kodit Zgjedhor²²⁵ dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit,²²⁶ me përjashtim të emergjencave.²²⁷ Pezullimi i këtyre aktiviteteve ka ngritur pikëpyetje nëse gjyqësori, si degë e pavarur e qeverisjes, duhet t'i nënshtrohet këtyre kufizimeve. Ndryshe nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë nuk e ka miratuar një qasje të tillë. Megjithatë, gjatë periudhës zgjedhore, Këshilli nuk ka filluar procedurat për përzgjedhjen, shkarkimin ose vendosjen e procedurave disiplinore për prokurorët publikë si autoritet i shkallës të dytë. Procesi i rekrutimit të 130 kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë publikë në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (AGJPP) gjithashtu u ndërpre, fillimisht për shkak të një kundërshtimi të paraqitur nga kandidatja për president të vendit nga koalicioni “Maqedonia juaj”²²⁸ dhe më në fund për shkak të një vendimi të Gjykatës së Lartë Administrative.²²⁹ Ky rast trajtohet më hollësisht në seksionin “Cilësia e drejtësisë”.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor ka zgjedhur 11 gjyqtarë në gjykatat më të larta të vendit. Më 15 nëntor 2023, përfundoi zgjedhja e tetë gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Shkupit, proces që filloi më 5 korrik 2021.²³⁰ U zgjodhën katër gjyqtarë nga fusha civile dhe katër nga fusha penale.²³¹ Megjithatë, procesi u pasua nga parregullsia. Në seancat e mbajtura më 18 dhe 19 tetor 2023,²³² Këshilli Gjyqësor

221 Paraqitja e Rezolutës për thirrjen e zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1LgvXvn7-cx3IWbxLchlxEZY0cjyiKqYB/view>.

222 Paraqitja e Rezolutës për thirrjen e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1XP6jrSKDr-BVIDuMAwCJqBGAK88qbx2g/view>.

223 “Njoftim nga seanca e 481-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 13.03.2024”, („Соопштение од 481-та седница на Судски совет на РСМ - 13.03.2024 година”), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3QgOd0e>.

224 “Njoftim”, (Известување), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 16 shkurt 2024, <https://bit.ly/43RZsBO>.

225 Kodi Zgjedhor.

226 Ligji për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

227 “Njoftim nga seanca e 481-të të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 13.03.2024 dhe vazhdimi më 20.03.2024”, (Соопштение од 481-та седница на Судскиот совет на РСМ - 13.03.2024 и продолжение на 20.03.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3QgOd0e>.

228 “Siljanovska Davkova paraqiti kundërshtim për punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm”, (Сиљановска Давкова поднесе приговор за вработувањата на идните судии и обвинители), MKD.mk, 6 prill 2024, <https://mkd.mk/siljanovska-davkova-podnese-prigovor-za-vrabotuvanjata-na-idnite-sudii-i-obviniteli/>.

229 “Aktgjykim-në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Пресуда-во име на граѓаните на Република Северна Македонија), (Gjykata e Lartë Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 prill 2024), <https://bit.ly/3D-qrECw>.

230 “Njoftim nga seanca e 464-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, (Соопштение од 464. седница на Судскиот совет на РСМ), 15 nëntor 2023, faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3O30m7P>.

231 Ibid

232 “Njoftim nga seanca e 460-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 18.10.2023 dhe 19.10.2023”, (Соопштение од 460-та седница на Судскиот совет на РСМ - 18.10.2023 и 19.10.2023 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4fjfs42>.

miratoi vendime kontradiktore në lidhje me ankesat për renditjen, duke revokuar vendime pa bazën e duhur ligjore dhe procedurën e duhur.²³³ Për më tepër, në ditën e zgjedhjeve, u bë një devijim nga renditja për kandidatët pa një shpjegim të kënaqshëm.²³⁴ Konkretisht, për fushën civile, u përzgjedhën kandidati i dytë, i tretë, i katërt dhe i gjashtë, dhe për zonën penale, kandidati i dytë, i gjashtë, i njëmbëdhjetë dhe i trembëdhjetë.²³⁵ Devijime nga Ligji për Këshillin Gjyqësor u vunë re edhe në mospërputhjen e votave “për” nga disa anëtarë të Këshillit,²³⁶ gjë që cenoj më tej integritetin e procesit.

Mosrespektimi i renditjes u vu re edhe në përzgjedhjen e gjyqtarit të fushës penale në Gjykatën e Apelit Shtip më 13 shkurt 2024,²³⁷ ku u zgjodh kandidati i renditur në vënd të dytë.²³⁸ Këto zgjedhje u mbajtën në një seancë urgjente, e cila u kritikua si e thirrur padrejtësisht.²³⁹ Megjithatë, në të njëjtën seancë u respektua renditja në përzgjedhjen e gjyqtarit për fushën civile në Gjykatën e Apelit Shtip, si dhe më 12 shkurt 2024,²⁴⁰ në përzgjedhjen e gjyqtarit për fushën penale në Gjykatën e Apelit Gostivar.²⁴¹ Këto zgjedhje i dhanë fund procesit disa mujor të plotësimit të këtyre pozicioneve gjyqësore, i cili filloi më 24 prill 2023.²⁴²

233 Në seancën e 460-të, të mbajtur më 18 dhe 19 tetor 2023, Këshilli Gjyqësor diskutoi nëse certifikata nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë duhet të konsiderohet provë e mjaftueshme që kandidatët kanë përgatitur materiale arsimore dhe i janë nënshtruar trajnimit ose nëse të njëjtët kandidatë duhet të paraqesin edhe prova të tjera. Para se të votonin dhe të vendosnin, tre anëtarë të Këshillit u larguan nga seanca, pas së cilës në seancë mbetën gjithsej nëntë anëtarë me të drejtë vote, pra Këshilli kishte kuorum për të vendosur. Në këtë situatë, Këshilli, me pesë vota «PËR» dhe katër «KUNDËR», vendosi të respektojë kundërshtimin e kandidatit dhe të pranojë si provë certifikatën nga Akademia. Pas kësaj, disa anëtarë të Këshillit reagues se Këshilli më parë kishte marrë një vendim të kundërt për të njëjtën çështje, sipas të cilit certifikatat e tilla nuk u pranuan si dëshmi e materialeve të përgatitura arsimore dhe pjesëmarrjen në trajnim. Duke pezulluar seancën dhe duke vazhduar seancën më 19.10.2023, Këshilli përsëri votoi për të njëjtën çështje dhe mori një vendim të ndryshëm, domethënë, me pesë vota «PËR» dhe shtatë «KUNDËR», domethënë, certifikata nga Akademia nuk është e pranueshme si dëshmi e ndjekjes së trajnimeve dhe përgatitjes së materialeve arsimore. «Njoftim për shtyp», (Соопштение за јавност), Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta”, 19 tetor 2023, <https://drive.google.com/file/d/17SIA7t6nuXXSgdDhwWaABcz3W1N3phrN/view>.

234 Në vend të kësaj, anëtarët e Këshillit treguan se për shkak të boshllëqeve në metodologjinë e renditjes së kandidatëve, «parametrat dhe kriteret e tjera do të jenë vendimtare», pa specifikuar se për cilat kriteret dhe rregullore bëhet fjalë. «Njoftim për shtyp», (Соопштение за јавност), faqja zyrtare në Facebook e Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta”, 15 nëntor 2023, <https://bit.ly/3tTVLy3>.

235 Petkovska dhe Tutij, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”.

236 Ibid.

237 “Njoftim nga seanca urgjente e 478-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut 13.02.2024”, (Соопштение од 478-та итна седница на Судскиот совет на РСМ 13.02.2024 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3QnKXF5>.

238 Petkovska dhe Tutij, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”.

239 Këshilli Gjyqësor caktoi një seancë urgjente më 13 shkurt 2024 për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shtip, me arsyetimin se proceset zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare fillojnë të nesërmen. Megjithatë, shpallja e përzgjedhjes u publikua më 24 prill 2023, e cila lejoi që procesi të përfundonte në kohën e duhur, duke qenë se zgjedhjet ishin shpallur paraprakisht. Seancat emergjente të Këshillit janë të rezervuara për çështje urgjente, gjë që nuk ndodh në këtë situatë.

240 “Njoftim nga seanca e 477-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 12.02.2024”, („Соопштение од 477-та седница на Судскиот совет на РСМ - 12.02.2024 година”), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3BwFdZV>.

241 Petkovska dhe Tutij, “Raport për monitorimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2024”.

242 “Njoftim për zgjedhjen e 1 (një) gjyqtari të Gjykatës së Apelit Gostivar për fushën penale, për zgjedhjen e 1 (një) gjyqtari të Gjykatës së Apelit Shtip për fushën civile,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 86/2023.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor, përveç zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta në vend, në disa raste ka kryer edhe zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave në gjykatat themelore dhe më të larta, si dhe zgjedhjen e gjyqtarëve porotë. Ndër vendimet e marra ishte zgjedhja e kryetarit të Gjykatës Themelore në Kumanovë, i cili më parë mbante postin e ushtruesit të detyrës së gjyqtarit.²⁴³ Kjo zgjedhje tërhoqi vëmendje të konsiderueshme, duke qenë se më herët, gjatë periudhës së kaluar raportuese,²⁴⁴ janë bërë pretendime në domenin publik për abuzim me sistemin AKMIS, shkelje të reputacionit të funksionit gjyqësor, përfshirje në konflikte ndërpersonale, si dhe shkelje të parimit të mosdiskriminimit.²⁴⁵ Zgjedhja e kryetarit të ri të Gjykatës Themelore Civile në Shkup²⁴⁶ u shoqërua gjithashtu me polemika, pasi ai e gjeti veten në fokusin e mediave për përfshirje të dyshuar në një skandal seksual, për të cilin u paraqitën dy parashtresa në Këshill.²⁴⁷

Këshilli i Prokurorëve Publikë, nga ana tjetër, gjatë periudhës raportuese ka zgjedhur 10 prokurorë publikë.²⁴⁸ Më 27 tetor 2023, 4 prokurorët e mbetur publikë u zgjedhën nga kandidatët nga gjenerata e shtatë e pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në AGJPP²⁴⁹, përkatësisht dy prokurorë publikë për Prokurorinë Themelore Publike Gostivar, një për Prokurorinë Themelore Publike Shkup dhe një për Prokurorinë Themelore Publike Strugë.²⁵⁰ Gjithashtu, Këshilli zgjodhi prokurorë publikë në prokuroritë e larta publike. Konkretisht, më 20 dhjetor 2023, Këshilli zgjodhi dy prokurorë publikë për Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dy prokurorë publikë për Prokurorinë e Lartë Publike të Gostivarit.²⁵¹ Përveç kësaj, më 13 shkurt 2024, dy prokurorë publikë u zgjedhën për Prokurorinë e Lartë Publike Shkup.²⁵²

243 “Njoftim nga seanca e 461-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 30.10.2023”, („Соопштение од 461-та седница на Судскиот совет на РСМ - 30.10.2023 година”), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4gy7O6T>.

244 Delevska dhe Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”.

245 Marrëdhëniet ndërpersonale të përqesura në gjykatën e Kumanovës”, („Разгорени” меѓучовечките односи во кумановскиот суд), Radio Slobodna Evropa, 12 korrik 2023, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/razgoreni-megjuchovech-kite-odnosi-vo-kumanovskiot-sud-/32498983.html>.

246 “Deklaratë solemne e kryetarëve të sapozgjedhur të shtatë gjykatave”, (Свечена изјава на новоизбраните претседатели на седум судови), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 nëntor 2023, <https://bit.ly/3TT3GX0>.

247 “Ka pasur parashtresë që gjyqtari Avdiја ka përdorur ambientet e gjykatës civile me dashnoren e tij katër vjet më parë”, (Претставка дека судијата Авдија користел простории на граѓанскиот суд со љубовницата имало и пред четири години), A1 on, 7 November 2024, <https://a1on.mk/macedonia/prestavka-deka-sudijata-avdiја-koristel-prostorii-na-gragjanskiot-sud-so-ljubovnicata-imalo-i-pred-chetiri-godini/>.

248 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik”, 18 dhjetor 2024.

249 Delevska dhe Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”.

250 “Vendim për zgjedhjen e dy prokurorëve publik në Prokurorinë Themelore Publike Gostivar, një prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike Shkup dhe një prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike Strugë”, (Одлука за избор на двајца јавни обвинители во Основното јавно обвинителство Гостивар, еден јавен обвинител во Основното јавно обвинителство Скопје и еден јавен обвинител во Основното јавно обвинителство Струга), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 tetor 2023, <https://bit.ly/41WsTsA>.

251 “Vendimi për zgjedhjen e dy prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dy prokurorëve publikë në Prokurorinë e Lartë Publike në Gostivar”, (Одлука за избор на двајца јавни обвинители во Јавното обвинителство на Република Северна Македонија и двајца јавни обвинители во Вишото јавно обвинителство во Гостивар), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 20 dhjetor 2023, <https://bit.ly/3tTz6lq>.

252 “Vendimi për zgjedhjen e prokurorëve publikë në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup”, (Одлука за избор на јавни обвинители во Вишото јавно обвинителство Скопје), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/3waFtlw>.

Me skadimin e mandatit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 25 dhjetor 2023, filloi procedura për zgjedhjen e një prokurori të ri publik. Për shkak të zgjatjes së procesit dhe afateve ligjore, në përgjigje të publikimit të vonuar të shpalljes nga Kuvendi,²⁵³ u emërua prokuror publik ushtrues i detyrës, deri në përfundimin e procedurës zgjedhore.²⁵⁴ Në shpalljen, të publikuar nga Kuvendi më 29 nëntor 2023,²⁵⁵ aplikuan tre kandidatë.²⁵⁶ Prej tyre, vetëm një kandidat morri mendim pozitiv nga Këshilli i Prokurorëve Publikë.²⁵⁷ Njëri nga kandidatët e tjerë ka marrë mendim negativ nga Këshilli, ndërsa kandidatura e kandidatës të tretë është refuzuar për shkak të dokumentacionit jo të plotë.²⁵⁸ Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit për refuzimin e dokumentacionit të kandidatit të tretë,²⁵⁹ Këshilli i Prokurorëve Publikë informoi Kuvendin, i cili më 13 shkurt 2024 iu drejtua përzgjedhjes së të nominuarit të vetëm.²⁶⁰

Në periudhën raportuese, problemi i sigurimit të një institucioni të akredituar në mënyrë të përshtatshme për kryerjen e testeve psikologjike dhe të integritetit të kandidatëve për gjyqtarë mbeti i pazgjidhur. Prandaj, Këshilli Gjyqësor vendosi në shtator 2024 të vazhdojë bashkëpunimin me Grupin Vista dhe Institutin për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Ligjore, duke lidhur një marrëveshje të re për këtë qëllim.²⁶¹

253 “Ushtruesi i detyrës së Prokurorit të Shtetit në vend të Joveskit – palët nuk nguten para zgjedhjeve për të emëruar një drejtues të ri të Prokurorisë Publike”, (На повидок в.д. државен обвинител на местото на Јовески – на партиите не им се брза пред избори да назначат нов шеф на ЈО), Prisma/BIRN, 11 dhjetor 2023, <https://prizma.mk/na-povidok-vd-drzhaven-obvinitel-na-mesto-to-na-joveski/>.

254 “Vendimi për thirrjen e seancës së nëntëdhjetë e tretë të Këshillit të Prokurorëve Publikë”, (Одлука за свикување на деведесет и третата седница на Советот на јавни обвинители), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 dhjetor 2023, <https://bit.ly/41YiLZi>.

255 “Vendim për shpalljen e emërimit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 251/2023.

256 “Procesverbal i seancës së 94-të të KPPRMV”, (Записник од 94 седница на CJOPCM), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 dhjetor 2023, <https://sjorm.gov.mk/zapisnjik-od-94-sednjica-nja-sjorm/>.

257 Ibid.

258 Ibid.

259 “Këshilli i Prokurorëve Publikë refuzoi njëzëri kërkesën e Fatime Fetait për rishqyrtimin e vendimit për refuzimin e kandidaturës së saj për prokurorë publike shtetërore”, (Советот на јавни обвинители едногласно го отфрли барањето на Фатиме Фетай за преиспитување на одлуката за отфрлање на нејзината кандидатура за државен јавен обвинител), A1 ON, 11 janar 2024, <https://a1on.mk/macedonia/sovetot-na-jo-ednoglasno-go-otfrli-baranjeto-na-fatime-fetai-za-preispituvanje-na-odlukata-za-otfrlanje-na-nejzinata-kandidatura-za-drzhaven-javen-obvinitel/>.

260 “Detajet në seancën 140”, (Детали на седница 140), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 shkurt 2024, <https://www.sobranie.mk/detali-na-sednica.nsp?sessionId=eaafa2c9-070b-4269-9261-33cfaaff2fa5>.

261 “Njoftim nga seanca e 498-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 10.09.2024”, („Соопштение од 498-та седница на Судскиот совет на PCM - 10.09.2024 година”), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3ZDagSF>.

Një konstatim i përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët publikë të zgjedhur është se praktika e zgjedhjes së tyre pa shpjegime për arsyet e zgjedhjes dhe mungesës së diskutimit ka vazhduar. Në raste të rralla kur ka një diskutim rreth përzgjedhjes, nga ana e anëtarëve të Këshillave më së shpeshti përdoren konkluzione të përgjithshme me shpjegime abstrakte. Mbetet e paqartë pse anëtarët e Këshillit të Prokurorëve Publikë votojnë me ABSTENIM gjatë zgjedhjes së prokurorëve publikë;

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet t'i përmbahen rreptësisht renditjes së përcaktuar dhe të japin vendime të hollësishme dhe të arsyetuara për të gjitha devijimet, me qëllim forcimin e besimit në proces dhe integritetin e institucioneve;

Qeveria duhet të fillojë urgjentisht një proces transparent për akreditimin e institucioneve për kryerjen e testeve psikologjike dhe të integritetit të kandidatëve për gjyqtarë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Ky proces duhet të përfshijë krijimin e një organi të pavarur të akreditimit me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse, një thirrje të hapur publike për akreditim, mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve potenciale dhe një zgjidhje afatgjatë përmes zhvillimit të një institucioni shtetëror për këto vlerësime. Kjo do të sigurojë një proces cilësor, transparent dhe të vazhdueshëm që do të forcojë besueshmërinë e zgjedhjes së gjyqtarëve.



Cilësia e drejtësisë

AGJPP mbetet pika e vetme e hyrjes në gjyqësor dhe prokurori publike. Gjatë periudhës raportuese, gjenerata VIII e pjesëmarrësve në trajnimin fillestar kaloi në fazën praktike të trajnimit, sipas së cilës më 29 shkurt 2024, u miratua Rregullorja për dhënien e provimit përfundimtar.²⁶²

Sa i përket gjeneratës IX të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar, pas dy vonesave, testi psikologjik²⁶³ u krye me sukses më 21 dhe 22 tetor 2023,²⁶⁴ dhe testi i integritetit më 6 dhe 7 nëntor 2023.²⁶⁵ Megjithatë, për shkak të skadimit të kontratës për prokurimin publik në grup të programeve kompjuterike për kryerjen e provimeve në institucionet shtetërore dhe procedurës së gjatë për lidhjen e një kontrate të re nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, kalimi i testit të kualifikimit u zgjat.²⁶⁶ Si përgjigje, Qeveria kërkoi që provimet elektronike të kryheshin përkohësisht në formë letre me një lexues elektronik.²⁶⁷ Në këtë drejtim, në mars 2024, AGJPP mori masa për të lehtësuar tranzicionin dhe për të siguruar vazhdimësinë e procesit të pranimit.²⁶⁸ Këto masa përfshinin propozimin e ndryshimeve në Ligjin për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, i cili hyri në fuqi më 12 mars 2024,²⁶⁹ për ndryshimin e Statutit të Akademisë²⁷⁰ dhe miratimin e një Rregulloreje të re për rishikimin e rregullave për provimin pranues²⁷¹ dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin e ndryshuar. Në përputhje me këto ndryshime, u hartua një orar i ri për fazat e ardhshme të procesit të pranimit,²⁷² dhe testi kualifikues u caktua për javën e parë të prillit 2024.²⁷³

262 Rregullore për marrjen e provimit përfundimtar të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, (Правилник за полагање на завршниот испит на слушателите на почетната обука во Академијата за судии и јавни обвинители „Павел Шатев“), (Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 29 shkurt 2024), <https://bit.ly/4fpzmKt>.

263 Fillimisht ishte planifikuar për 5 dhe 6 shtator 2023, por datat u zhvendosën në 23 dhe 24 shtator 2023. Delevska dhe Zhagar, “Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2022 – shtator 2023”.

264 “Njoftim për datat e kryerjes së testit psikologjik”, (Известување за датуми за полагање на психолошкиот тест), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 9 tetor 2023, <https://bit.ly/4gvPmLW>.

265 “Njoftim për orarin e kryerjes së testit të integritetit”, (Известување за распоред за полагање на тестот за интегритет), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 3 nëntor 2023, <https://bit.ly/3VzZQ4T>.

266 “Njoftim nga komisioni i pranimeve”, (Известување од приемната комисија), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 25 dhjetor 2023, <https://bit.ly/3HhkDD1>.

267 “Njoftim për dinamikë të re kohore për kryerjen e pjesës së mëtejshme të provimit pranues”, (Известување за нова временска динамика за спроведување на понатамошниот дел од приемниот испит), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 28 dhjetor 2023, <https://bit.ly/48p5Kud>.

268 “Njoftim nga komisioni i pranimeve për rrjedhën e Provimit të Pranimit dhe dinamikën e re kohore për pjesën e mëtejshme të Provimit të Pranimit”, (Известување од Приемната комисија за текот на Приемниот испит и за утврдена нова временска динамика за понатамошниот дел од Приемниот испит), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 18 mars 2024, <https://bit.ly/3UdGkd3>.

269 “Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 53/2024.

270 “Vendim statutor për plotësimin e Statutit të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev””, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 62/2024.

271 “Rregullore për plotësimin e rregullores për marrjen e provimit pranues në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë” Pavel Shatev”, (Правилник за дополнување на Правилникот за полагање Приемниот испит во Академијата за судии и јавни обвинители „Павел Шатев“), (Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë” Pavel Shatev “, 15 mars 2024), <https://bit.ly/4iEX9ji>.

272 “Njoftim nga komisioni i pranimeve për rrjedhën e Provimit të Pranimit dhe dinamikën e re kohore për pjesën e mëtejshme të Provimit të Pranimit”.

273 “Orari i testit të kualifikimit”, (Распоред за полагање на квалификацискиот тест), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 29 mars 2024, <https://bit.ly/4d8cjUR>.

Miratimi i orarit të ri nxiti parqitjen e parashtresave në KSHPK nga një anëtar i Komitetit Ligjor të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)²⁷⁴ dhe kandidatja për president të vendit nga koalicioni “Maqedonia juaj”, i udhëhequr nga VMRO-DPMNE.²⁷⁵ Parashtresat, të paraqitura më 21 mars²⁷⁶ dhe 5 prill 2024,²⁷⁷ kishin të bënin me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor²⁷⁸ dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit,²⁷⁹ të cilat ndalojnë procedurat e reja të punësimit dhe shkarkimit në institucionet publike pas shpalljes së zgjedhjeve dhe kërkojnë pezullimin e procedurave tashmë të filluara.

Në përgjigje të parashtresave, AGJPP vuri në dukje se vepron në përputhje me praktikën e përcaktuar më parë të KSHPK-së, sepse në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit të vitit 2019,²⁸⁰ KSHPK nuk jep më mendime për veprimet gjatë periudhës zgjedhore.²⁸¹ Akademia përmendi shembullin e pranimit të gjeneratës VI të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në vitin 2017,²⁸² i cili u vlerësua nga struktura e atëhershme e KSHPK-së si ligjërish në përputhje dhe u konfirmua nga Inspektorati Shtetëror i Punës pas mbikëqyrjes së jashtëzakonshme.²⁸³ AGJPP shtoi se, sipas grafikut të ri, kontratat e punës do të lidhen më së shpejti në shtator 2024, duke garantuar pajtueshmërinë me standardet ligjore.²⁸⁴

Megjithatë, më 10 prill 2024, KSHPK miratoi kundërshtimin nga kandidatja presidenciale, pas së cilës AGJPP paraqiti ankesë në Gjykatën Administrative. Më 13 prill 2024, Gjykata Administrative pranoi ankesën e AGJPP,²⁸⁵ rrëzoi vendimin e KSHPK dhe e ktheu lëndën për rishqyrtim, duke e detyruar KSHPK të marrë parasysh indikacionet e gjykatës.²⁸⁶ Këto përfshinin

274 “VMRO-DPMNE paraqiti ankesë në KSHPK kundër Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për shkelje të Kodit Zgjedhor”, (ВМРО-ДПМНЕ поднесе пријава до ДКСК против Академијата за судии и јавни обвинители за прекршување на Изборниот законик), Agjencia Informative Mediatike - AIM, 21 mars 2024, <https://bit.ly/4gC4oQA>.

275 “Siljanovska-Davkova paraqiti ankesën e parë për shkelje të rregullave zgjedhore - në lëvizje antikorrupsionistët”, (Сиљановска-Давкова го поднесе првиот приговор за кршење на изборните правила - на потег антикорупционерите), Faktor, 6 prill 2024, <https://faktor.mk/siljanovska-davkova-go-podnese-prvot-prigovor-za-krshenje-na-izbornite-pravila---na-poteg-antikorpucionerite>.

276 “VMRO-DPMNE paraqiti ankesë në KSHPK kundër Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për shkelje të Kodit Zgjedhor”

277 “Siljanovska-Davkova paraqiti ankesën e parë për shkelje të rregullave zgjedhore - në lëvizje antikorrupsionistët”

278 Kodi Zgjedhor, 2, pika 1, pika 29; 8-a, pika 1, pika 3.

279 Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, 34, paragrafi 1, rreshti 3.

280 Ligji për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

281 “Njoftim lidhur me ankesën e parashtruar kundër Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik “Pavell Shatev” në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për Shkelje të Kodit Zgjedhor”, (Соопштение во врска со поднесена пријава против Академијата за судии и јавни обвинители „Павел Шатеv” до Државната комисија за спречување на корупцијата за прекршување на Изборниот законик), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik “Pavell Shatev”, 21 mars 2024, <https://bit.ly/3w7SPIY>.

282 Numri i mendimeve nga KSHPK: 12-467/2 datë 23.01.2017 dhe numri 12-1637/2 datë 24.02.2017.

283 “Njoftim në lidhje me ankesën e paraqitur kundër Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për shkelje të Kodit Zgjedhor”.

284 Ibid.

285 “KSHPK do të veprojë përsëri mbi ankesën e Siljanovska-Davkova për shkelje të rregullave zgjedhore”, (ДКСК повторно ќе постапува по приговорот на Сиљановска-Давкова за кршење на изборните правила), TV Telma, 19 prill 2024, <https://telma.com.mk/2024/04/19/dksk-povtorno-ke-postapuva-po-prigovorot-na-siljanovska-davkova-za-krshene-na-izbornite-pravila/>.

286 “Vendimi 12-1330/56” (Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 20 prill 2024), <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2024/04/12-1330-56.pdf>.

përfshirjen e disa anëtarëve të KSHPK nga vendimmarrja dhe bërjen e një analize krahasuese me situatën e vitit 2017.²⁸⁷ Më 19 prill 2024, KSHPK la në fuqi vendimin e saj fillestar,²⁸⁸ i cili më vonë u la në fuqi nga Gjykata Administrative (pavarësisht vendimit fillestar në favor të Akademisë)²⁸⁹ dhe nga Gjykata e Lartë Administrative, duke rrëzuar kështu ankesën e AGJPP.²⁹⁰ Si rezultat, KSHPK nisi nismën për përcaktimin e përgjegjësish së drejtores, kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Akademisë për shkelje të rregulloreve ligjore,²⁹¹ shpjeguar më sipër në seksionin “Përgjegjësia”. Paralelisht me procedurën, Qeveria e re propozoi në programin e saj ndarjen e Akademisë në dy institucione të veçanta (një për gjyqtarët dhe një për prokurorët publikë), si dhe rishikimin e plotë të procesit të pranimit të kandidatëve.²⁹²

Pas vendimit të Gjykatës së Lartë Administrative, drejtoresha e AGJPP dha dorëheqjen në mënyrë të parevokueshme më 12 korrik 2024, duke përmendur ndikimin politik mbi institucionet kompetente si arsye kryesore.²⁹³ Zëvendës drejtori mori pozicionin e ushtruesit të detyrës për një periudhë tre mujore dhe më 16 korrik 2024 thirri një takim për të siguruar vazhdimësi në punën e Akademisë.²⁹⁴ Në të njëjtën ditë, Këshilli Drejtues i AGJPPi kërkoi Qeverisë dhe Ministrisë së Financave mendimin e tyre për rrjedhën e ardhshme të procesit, duke përfshirë zgjatjen e provimit pranues për gjeneratën e 9-të të pjesëmarrësve, pezullimin e procedurës së punësimit ose përfundimin e plotë të procesit.²⁹⁵ Megjithatë, një përgjigje për kërkesën nuk është dërguar ende. Më 26 gusht 2024, u botua një shpallje për zgjedhjen e një drejtori të ri,²⁹⁶ i cili u mbyll më 10 shtator 2024, duke tërhequr shtatë kandidatë, përfshirë zëvendës drejtorin e përkohshëm, katër gjyqtarë shtesë dhe dy prokurorë publikë.²⁹⁷

287 Ibid.

288 Ibid.

289 “Gjykata Administrative: Padia e AGJPP kundër vendimit të KSHPK është e pabazuar”, (Управен суд: Неоснована е тужбата на АСЈО за одлуката на ДКСК), Agjencia Informativ Mediatike - AIM, 22 prill 2024, <https://bit.ly/3xXaxGm>.

290 “Njoftim – Gjykata e Lartë Administrative la në fuqi vendimin e KSHPK lidhur me kundërshtimin e një organizatori të fushatës zgjedhore për punësim në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, (Соопштение – Вишиот управен суд ја потврди одлуката на ДКСК во врска со приговорот од организатор на изборна кампања за вработувањата во Академијата за судии и јавни обвинители), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 30 prill 2024, <https://bit.ly/3WpALV5>.

291 “Iniciativa për përcaktimin e përgjegjësish së drejtorin dhe bordin drejtues të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, (Иницијатива за утврдување одговорност за директорката и управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 23 maj 2024, <https://bit.ly/3Lqp40o>.

292 “Dokumente – Propozim Programi i Punës së Qeverisë”, (Документи – Предлог-програма за работа на Владата), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=3ae13141-ac9e-486a-950e-f603c34dcea4>.

293 “Drejtoresha e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik, Natasha Gaber-Damjanovska, dha dorëheqje të parevokueshme”, (Директорката на Академијата за судии и јавни обвинители, Наташа Габер-Дамјановска поднесе неотповиклива оставка), Sakam da Kazam, 12 korrik 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/direktorkata-na-akademijata-za-sudii-natasha-gaber-damjanovska-podnese-neotpovikлива-ostavka/>.

294 “Takim pune informues i zëvendës drejtorit të AGJPP, gjyqtarit Ilir Iseni me nëpunësit”, (Информативен работен состанок на заменикот на директорот на АСЈО, судија м-р Илир Исени со вработените), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, 16 korrik 2024, <https://bit.ly/48padxO>.

295 “Njoftim nga seanca e 215-të të Bordit Drejtues të Akademisë”, (Соопштение од 215та седница на Управниот одбор на Академијата), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, 17 korrik 2024, <https://bit.ly/3UsqnK7>.

296 “Shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, “Pavel Shatev”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 177/2024.

297 “Përpjekje e re për emërimin e drejtorit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, (Нов обид да се именува директор за Академијата на судии и јавни обвинители), TV Telma, 14 tetor 2024, <https://telma.com.mk/2024/10/14/nov-obid-da-se-imenuva-direktor-za-akademijata-na-sudii-i-javni-obviniteli/>.

Ndërkohë, me qëllim forcimin e integritetit institucional, zëvendësudrejtori filloi një takim më 27 gusht 2024 për krijimin e një Shoqate Alumni, në përputhje me Statutin e Akademisë, e cila do të përfshinte të gjithë kandidatët që deri më tani kanë përfunduar me sukses trajnimin fillestar në Akademi.²⁹⁸ Qëllimi i shoqatës është të inkurajojë bashkëpunimin e vazhdueshëm midis akademikëve përmes takimeve të rregullta, shkëmbimit të përvojave, diskutimeve ligjore, monitorimit të karrierës së anëtarëve dhe lidhjes me shoqatat ndërkombëtare.²⁹⁹

Nevoja për të përmirësuar kushtet hapësinore të AGJPP, mbi të gjitha dhomat e trajnimit, por edhe rritjen e stafi dhe i buxhetit sipas nevojave reale të Akademisë mbeten ende një sfidë dhe si një masë e paplotësuar e strategjisë së mëparshme,³⁰⁰ pasqyrohet në Strategjinë e re Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin (2024-2028) me Plan Veprimi.³⁰¹

Lidhur me përafrimin e praktikës gjyqësore, Departamenti i Praktikës Gjyqësore i GJSRMV zhvilloi tre seanca në periudhën raportuese (një në shkurt dhe dy në prill 2024).³⁰² Ashtu si në raportin e mëparshëm, GJSRMV zhvilloi një takim midis gjyqtarëve dhe përfaqësuesve nga katër qarqet e apelit për të harmonizuar praktikën gjyqësore,³⁰³ e cila është më pak në krahësim me tre mbledhjet e periudhës raportuese shtator 2021 – tetor 2022.³⁰⁴ Mbështetja financiare për organizimin e këtyre takimeve mbetet me ndihmën e jashtme dhe realizimin e projekteve përmes të cilave në takime përfshihet edhe sektori civil. Për të arritur një barazi më të madhe të praktikës gjyqësore, nevojitet një numër më i madh i takimeve të GJSRMV me gjykatat e apelit, si dhe një rritje e aktivitetit të departamenteve të praktikës gjyqësore. Për të ndjekur drejtimit dhe qëndrimet e gjykatave të apelit në mbledhjet e tyre, konkluzionet e këtyre mbledhjeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.³⁰⁵ Gjithashtu, procesi i publikimit të vendimeve gjyqësore vazhdon pa probleme dhe të gjitha vendimet gjyqësore publikohen në ueb portalin e gjykatave sud.mk, por procesi nuk është i strukturuar në mënyrë që vendimet të përdoren në mënyrë të lehtë dhe

298 “Njoftimi i mbledhjes fillestare të mbajtur për krijimin e shoqatës së ish-studentëve në kuadër të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, (Соопштение за одржаниот иницијален состанок за создавање на алумни асоцијација во рамки на Академијата за судии и јавни обвинители), faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, 2 shtator 2024, <https://bit.ly/4fnx7rQ>.

299 Ibid.

300 “Strategjia për reforma në sektorin e Gjyqësorit për periudhën 2017-2022 me Plan Veprimi” (Стратегија за реформа на правосудниот сектор за периодот 2017-2022 година со Акциски план), (Ministria e Drejtësisë, 2017), https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf, drejtimi strategjik 2.2.8.

301 “Plan veprimi për zbatimin e Strategjisë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin 2024-2028”, masa 1.2.3.

302 “Njoftim nga seanca e departamentit të praktikës gjyqësore”, (Соопштение од одржана седница на одделот за судска практика), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 15 prill 2024, <https://bit.ly/3VFZgmV>; “Njoftim nga seanca e departamentit të praktikës gjyqësore”, (Соопштение од одржана седница на одделот за судска практика), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 prill 2024, <https://bit.ly/3DismSw>.

303 “Mbahet takim pune i Gjykatës Supreme me katër gjykatat e apelit”, (Соопштение од одржана седница на одделот за судска практика), faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 qershor 2024, <https://bit.ly/4gyEeOz>.

304 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike”, 7 nëntor 2022.

305 Dushko Georgievski, “Analiza e cilësisë dhe barazisë së vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës civile”, (Анализа на квалитетот и изедначеноста на судските одлуки во граѓанско-правната област), (Institutit për Politikë Evropiane dhe Shoqata “Zenit”, gusht 2021) <<https://bit.ly/3UfOKPz>> .

të qasshme. Kjo për faktin se nuk ekziston mundësia e gjetjes së saktë dhe të shpejtë të njëpraktike gjyqësore specifike dhe as metodologjia për nxjerrjen e vendimeve kyçe në lidhje me krijimin e praktikës gjyqësore.³⁰⁶

Në fushën e ndërmjetësimit, si një mjet kryesor alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, autoritetet përgjegjëse për funksionimin dhe promovimin e tij janë bërë jofunksionale. Në shkurt 2024, u miratuan disa akte nënligjore për të kapërcyer problemet me lëshimin dhe zgjatjen e licencave të ndërmjetësit, të cilat lindën nga vakumi gjashtëmuor në përmbushjen e afateve ligjore për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit³⁰⁷ dhe, kështu, mungesën e një institucioni kompetent të licencimit deri në shtator 2022.³⁰⁸ Konkreisht u miratuan: Rregullore për mënyrën e lëshimit dhe revokimit të licencave në ndërmjetësim,³⁰⁹ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e licencës së ndërmjetësit,³¹⁰ Rregullore për metodologjinë dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së punës së ndërmjetësve³¹¹ dhe Tarifa për shumën e kostove aktuale të bëra për lëshimin e licencave për ndërmjetësuesit, licencat për ndërmjetësuesit në fusha specifike, licencat për trajnerët e ndërmjetësve dhe akreditimin e programeve të trajnimit për ndërmjetësuesit.³¹² Pas miratimit të tyre, Koordinatori Kombëtar për Ndërmjetësim dha dorëheqjen në mars 2024, dhe në prill 2024 u emërua një ushtrues i detyrës Koordinator Kombëtar për Ndërmjetësim.³¹³ Kjo mundësoi zgjidhjen e çështjes së licencimit të 25 ndërmjetësve.³¹⁴ Megjithatë, pas shkarkimit të ushtruesit të detyrës më 5 korrik 2024,³¹⁵ nuk u emërua një koordinator i ri, duke çuar në ngecjen e procesit përsëri. Për më tepër, mandati i udhëheqjes së Odës së Ndërmjetësve skadoi më 26 shkurt 2024, dhe asnjë asamble për zgjedhjen e organeve të reja nuk u mblodh deri në fund të periudhës raportuese.³¹⁶ Si rezultat, Oda u bë jofunksionale, duke penguar më tej zhvillimin e ndërmjetësimit.³¹⁷

306 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022”, (Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2noxB>.

307 “Vendim për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të Këshillit Kombëtar për Ndërmjetësim,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 201/2022.

308 Borçe Mirqeski, “Këshilli Kombëtar i Ndërmjetësimit do të ndryshohet në përbërjen e tij”, (Националниот совет за медијација треба да биде изменет во неговиот состав), Sloboden Peçat, 24 qershor 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/videointervju-mircheski-nacionalniot-sovet-za-medijacija-treba-da-bide-izmenet-vo-negoviot-sostav/>.

309 “Rregullore për mënyrën e lëshimit dhe revokimit të licencave në ndërmjetësim,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 40/2024.

310 “Rregullore për formën dhe përmbajtjen e licencës së ndërmjetësit,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 41/2024.

311 “Rregullore për metodologjinë dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së punës së ndërmjetësve,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 40/2024.

312 “Tarifa për shumën e kostove aktuale të bëra për lëshimin e licencave për ndërmjetësuesit, licencat për ndërmjetësuesit në fusha specifike, licencat për trajnerët e ndërmjetësve dhe akreditimin e programeve për trajnimin e ndërmjetësve,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 40/2024.

313 “Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës së Koordinatorit Kombëtar për Ndërmjetësim,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2024.

314 Borçe Mirqeski, Këshilli Kombëtar i Ndërmjetësimit duhet të ndryshohet në përbërjen e tij.

315 “Koordinatorët kombëtarë të shkarkuar”, (Разрешени национални координатори), eMagazine, 5 korrik 2024, <https://bit.ly/3BGgklh>.

316 Kontributi nga Ndërmjetësit e Licencuar në Raportin Hije në Kapitullin 23 për periudhën tetor 2023-shtator 2024.

317 Ibid.

Propozim-ligji për Procedurën Civile, me ndryshime dhe plotësime shtesë me futjen e procedurës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive,³¹⁸ hyri përsëri në procedurën parlamentare në gusht 2024.³¹⁹ Më 2, 4 dhe 6 shtator, Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndër-Komunitare, Komiteti Legjislativ dhe Komiteti për Çështjet Evropiane mbështetën propozim-ligjin, duke dhënë një mendim pozitiv për leximin e tij të mëtejshëm.³²⁰ Megjithatë, më 10 shtator 2024, propozim-ligji u tërhoq përsëri nga procedura parlamentare nga Ministria e Drejtësisë,³²¹ për shkak të nevojës për harmonizimin e tij me ndryshimet në Direktivën (BE) 2020/1828 për paditë përfaqësuese për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve dhe shfuqizimin e Direktivës 2009/22/E3.³²² Ky harmonizim është i nevojshëm pas ndryshimeve të bëra në dhjetor 2023 dhe qershor 2024, të cilat shtrijnë zbatimin e Direktivës në fusha të reja, duke përfshirë Rregulloren (BE) 2023/2854 (Akti i të Dhënave) dhe Rregulloren (BE) 2024/1689 (Akti i Inteligjencës Artificiale). Këto ndryshime parashikojnë mundësinë e ngritjes së padive përfaqësuese në fushat që lidhen me mbrojtjen e të dhënave dhe inteligjencën artificiale, gjë që kërkon pajtueshmëri shtesë me legjislacionin kombëtar.³²³

318 Kjo risi lejon shoqatat, fondacionet, institucionet ose organizatat e tjera, të cilat janë të regjistruara ose të autorizuar me ligj, të ngrenë padi kundër një personi fizik ose juridik, i cili, me anë të një veprimtarie të caktuar, duke vepruar ose me lëshim, kërcënon ose cenon seriozisht interesat dhe të drejtat kolektive të përcaktuara me ligj. Ligji harmonizohet me tej me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas, duke specifikuar se shpenzimet e procedurës së palës përfituese të ndihmës juridike dytësore, e cila ka pasur sukses në mosmarrëveshjen, paguhen në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, propozim-ligji parashikon mundësinë e mbajtjes së seancave dëgjimore publike në mënyrë elektronike. Kjo zbatohet nëse ekziston rreziku i shtyrjes së procedurës ose nëse ekzistojnë pengesa ligjore ose faktike për praninë fizike. Gjykata mund të vendosë mbajtjen e seancës në distancë, duke përdorur komunikimin elektronik të dyanshëm që siguron një ekran të dëgjueshëm dhe vizual në kohë reale. “Propozim-ligji për Procedurën Civile në Agjendën e Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndër-Komunitare”, (Предлог Законот за парничната постапка денеска на дневен ред на Комисијата за политички систем и односи меѓу заедниците), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 2 shtator 2024, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6733>.

319 “Njoftim për material të ri për deputetët - propozim i Ligjit për Procedurën Civile”, (Известување за нов материјал до пратеници - предлог на Закон за парничната постапка), (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 gusht 2024), <https://www.sobranie.mk/78900468-d05a-4c9a-9e89-e67a2c9a9e3c>.

320 “Detaje në material, propozim i Ligjit për Procedurën Civile”, (Детали на материјал-предлог на Закон за парничната постапка), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=07aeb891-c5f7-49a4-b2f2-560f31d33fcb>.

321 “Njoftim për tërheqjen e materialit nga propozuesi - propozim i Ligjit për Procedurën Civile”, (Известување за povлекување на материјал од предлагачot - предлог на Закон за парничната постапка), (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 shtator 2024), <https://www.sobranie.mk/15caa6ea-da13-439e-a567-44b2b81132e8>.

322 “Kontribut nga Ministria e Drejtësisë në diskutimin e Raportit hije të Kapitullit 23 për periudhën tetor 2023 – shtator 2024”, (Придонес од Министерството за правда во рамки на дискусијата за Извештајot во senka за Поглавје 23 за периодот okтомври 2023 – септември 2024 година), faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane (EPI) - Shkup, 24 dhjetor 2024, <https://epi.org.mk/post/27153>.

323 Ibid.

Ekipimi teknik, infrastrukturor dhe i personeli mbeten ende një sfidë dhe janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve të kryera nga AGJPP. Sigurimi i hapësirave të reja të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është i nevojshëm për të qenë në gjendje të kryejë plotësisht kompetencat e saj parësore, më saktësisht për të organizuar trajnime në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm, si dhe për të pasur mundësi të mjaftueshme për të marrë kandidatë të rinj për trajnim fillestar; është gjithashtu e nevojshme të rritet realisht buxheti në dispozicionin e AGJPP-së, në përputhje me nevojat për funksionimin e pandërprerë dhe mirëmbajtjen e një niveli cilësor të punës;

Është e nevojshme që Qeveria dhe Ministria e Financave të paraqesin në kohën e duhur një mendim të qartë dhe ligjërish të shëndoshë për vazhdimin e provimit pranues për gjeneratën e 9-të të pjesëmarrësve të AGJPP, për të siguruar vazhdimësinë në procesin e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj;

Roli proaktiv i GJSRMV-së në miratimin e qëndrimeve dhe mendimeve ligjore parimore vazhdoi. Për të arritur një harmonizim më të madh të praktikës gjyqësore, nevojitet një numër më i madh i takimeve të GJSRMV me gjykatat e apelit, si dhe një rritje e aktivitetit të departamenteve të praktikës gjyqësore. Për të ndjekur drejtimet dhe qëndrimet e gjykatave të apelit në mbledhjet e tyre, konkluzionet e këtyre mbledhjeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.

Këshilli Kombëtar i Ndërmjetësimit dhe Oda e Ndërmjetësve duhet të aftësohen urgjentisht për të funksionuar duke zgjedhur udhëheqjen e re të Odës dhe duke emëruar një koordinator të ri kombëtar të ndërmjetësimit. Qeveria duhet, në të njëjtën kohë, të sigurojë mbështetje sistematike për zhvillimin e ndërmjetësimit si një mjet alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;



Efikasiteti

Sipas të dhënave nga Raporti Vjetor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2023, gjykatat në vitin 2023 kanë dështuar në tejkalimin e fluksit të lëndëve dhe kanë rritur numrin e lëndëve të prapambetura me 22,164 lëndë.³²⁴ Nga raportet statistikore për punën e gjykatave, Këshilli Gjyqësor konstaton se në vitin 2023 nga 34 gjykata, 13 gjykata kanë qenë të përditësuara, ndërsa 21 gjykata kanë qenë të papërditësuara, përkatësisht 3 gjykata të apelit dhe 18 gjykata themelore.³²⁵ Këto të dhëna tregojnë një përkeqësim të ndjeshëm të situatës në raport me prapambetjen e lëndëve dhe pasivitetin e gjykatave në krahasim me vitin 2022.

Rritja e këtyre parametrave negativë vjen ndër të tjera edhe për shkak të uljes së vazhdueshme të numrit të gjyqtarëve aktivë. Në një periudhë prej vetëm 5 vitesh, numri i gjyqtarëve ka rrënë për 125 gjyqtarë. Ulja më e theksuar ishte në Qarkun e Apelit të Manastirit, ku numri i gjyqtarëve u ul me 38.75%, gjë që çoi në pasivitetin e plotë të gjykatave që i përkasin kësaj zone për vitin 2023.³²⁶ Në vendin e dytë është Rrethi i Apelit Shtip, ku numri i gjyqtarëve është ulur me 30.50%.³²⁷ Për më tepër, gjykatat në Rrethin e Apelit të Gostivarit u ulën me 25.75%.³²⁸ Megjithëse Qarku i Apelit të Shkupit regjistroi daljen më të madhe të gjyqtarëve në numër absolut, për shkak të madhësisë së tij dhe numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, kjo zonë ishte më pak e prekura, me një rënie prej 17.70%.³²⁹

Rritja e parametrave negativë vjen edhe për shkak të rritjes së ndjeshme të numrit të lëndëve të shpërndara për gjyqtar. Ndërsa në vitin 2020 një gjyqtar ka pasur mesatarisht 239 lëndë, në vitin 2024 ky numër është rritur në 437 lëndë, një rritje prej 83.26%.³³⁰ Sfidë shtesë është mungesa e planifikimit adekuat dhe analizës së nevojave gjatë publikimit të shpalljeve për pranim në AGJPP. Në vend të profilizimit dhe planifikimit të pozicioneve të lira gjyqësore dhe prokuroriale sipas qyteteve dhe rretheve të apelit, publikohet një shpallje e vetme e përgjithshme për të gjithë vendin. Si rezultat, pas përfundimit të trajnimit, kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë në çdo gjykatë dhe prokurori publike, me kandidatët që preferojnë më shpesh pozicione në kryeqytet ose qytete të mëdha, duke lënë të paplotësuara postet gjyqësore dhe prokuroriale në qytete dhe qarqe më të vogla.³³¹ Në përputhje me rrethanat, Këshilli Gjyqësor në periudhën e kaluar raportuese i është drejtuar referimeve të përkohshme të gjyqtarëve të

324 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023», shkurt 2023, <https://bit.ly/3RbFZGq>.

325 Ibid.

326 Lejla Tutij, «Analiza e situatës së burimeve njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut», (Анализа на состојбата со човечките ресурси во судовите и јавните обвинителства во Република Северна Македонија), (Koalicioni "Të gjithë për gjykyrime të drejta", 2024), <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2024/11/66-AN-CRS-2024.pdf>.

327 Ibid.

328 Ibid.

329 Ibid.

330 Ibid.

331 Ibid.

gjeneratës së 7-të të AGJPP³³² të cilët përfunduan trajnimin në mars 2023.³³³ Megjithatë, për shkak të përvojës së pamjaftueshme gjyqësore, këta gjyqtarë kanë kompetenca të kufizuara dhe mund të veprojnë vetëm në lëndë me kufizime të caktuara (sipas vlerës së mosmarrëveshjes në lëndët civile dhe masës së dënimit në lëndët penale).³³⁴ Kështu, për lëndët e tjera, ato janë përjashtuar nga veprimi në periudhën raportuese, gjë që tregon se kjo zgjidhje nuk është plotësisht efektive në tejkalimin e problemit të prapambetjes së lëndëve.³³⁵

Sipas Raportit Vjetor për punën e Prokurorive Publike për vitin 2023,³³⁶ gjatë punës së Prokurorisë Publike, Prokurorisë së Lartë Publike, Prokurorisë Themelore Publike dhe Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në vitin 2023, është vepruar në kohë dhe në mënyrë profesionale. Prokuroritë Publike, në përgjithësi, arritën të kapërcejnë fluksin e kallëzimeve të reja penale dhe të zvogëlojnë numrin e lëndëve të pazgjydhura. Domethënë, 62,1% e kallëzimeve penale janë zgjidhur gjatë vitit 2023, që është një përmirësim i lehtë krahasuar me vitin 2022, kur janë zgjidhur 61,6% e kallëzimeve penale. Më pas, pati një rritje të lehtë të kallëzimeve penale të pazgjydhura deri në fund të vitit 2023, ku mbetën 37,9% e kallëzimeve penale, krahasuar me vitin 2022, kur mbetën 38,4% e kallëzimeve penale të pazgjydhura. Megjithatë, është e nevojshme që Prokuroria Publike të miratojë një metodologji për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për punën e prokurorive publike, në mënyrë që të tregojë një analizë më gjithëpërfshirëse, cilësore të punës së përgjithshme, individuale për të gjitha prokuroritë publike, të shprehura në nivelin e lëndëve, dhe jo të autorëve të veprave penale.

Rezultatet e përmirësuar në Prokurorinë Publike mund t'i atribuohen numrit relativisht të qëndrueshëm të prokurorëve publikë në periudhën e kaluar pesëvjeçare, ndryshe nga situata në gjykata. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe numri i prokurorëve publikë është zvogëluar me vetëm 8% ose gjithsej 16 prokurorë. Dalje e konsiderueshme është regjistruar në 10 prokurori, ndërsa në 9 prokurori numri i prokurorëve mbetet i njëjtë dhe në 9 prokurori të tjera është regjistrua rritje.³³⁷ Përjashtim janë prokuroritë me uljen më drastike prej 50%, siç janë Prokuroria e Lartë Publike në Manastir, Prokuroria Themelore Publike në Prilep, Prokuroria Themelore Publike në Gjevgjeli dhe Prokuroria Themelore Publike në Resnjë, gjë që ndikon dukshëm në efektivitetin e tyre dhe rritjen e numrit të lëndëve.³³⁸

332 "Njoftim nga seanca urgjente e 453-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 06.09.2023", (Соопштение од 453. итна седница на Судскиот совет на РСМ – 06.09.2023 година), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3NeWRuD>.

333 Renditja përfundimtare e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të gjeneratës së shtatë të AGJPP u publikua më 20 shkurt 2023 (me publikimin e renditjes shtesë më 1 mars për shkak të së drejtës së kandidatëve për të ri-marrë provimin përfundimtar), pas së cilës renditja iu dërgua KGJRMV dhe KPPRMV për ndarjen e tyre të duhur. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 48/2023, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 69/2023.

334 Tutiq, "Analiza e situatës së burimeve njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

335 Ibid.

336 Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raport mbi punën e Prokurorive Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023", (Извештај за работата на јавните обвинителства на Република Северна Македонија во 2023 година) korrik 2024, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2024/07/godishen-izveshta-%D1%98-2023-finalna-verzi-%D1%98a-2.pdf>.

337 Tutiq, "Analiza e situatës së burimeve njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

338 "Procesverballi i seancës së 103-të të KPPRMV", (Записник од 103 седница на СЈОПМ) faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 29 maj 2024, <https://sjorm.gov.mk/zapisnjik-od-103-sednjica-nja-sjorm/>.

Rezultatet më të mira në prokurorinë publike, në krahasim me gjyqësorin, janë gjithashtu për shkak të një përqindjeje më të vogël të rritjes së numrit të lëndëve në punën e një prokurori publik nga viti 2020 në 2024. Domethënë, nga 64 lëndë në vitin 2020, numri i lëndëve në punën e prokurorit publik në vitin 2024 është rritur në 73 lëndë ose vetëm 14,28%.³³⁹

Sfidë për efektivitetin e të gjitha prokurorive publike është menaxhimi nënoptimal i numrit në dispozicion të prokurorëve publikë, i cili është pjesërisht i përcaktuar për mos profilizimin dhe planifikimin e vendeve të lira sipas qyteteve dhe qarqeve të apelit dhe publikimin e një shpallje të vetme të përgjithshme për pranim në AGJPP, siç është shpjeguar më sipër. Si shembull, në Prokurorinë Themelore Publike në Kërçovë, rritja e numrit të lëndëve në punë shoqërohet me rritje të numrit të prokurorëve publikë nga 100%. Kjo për faktin se prokurorët publikë të sapozgjedhur nuk mund të veprojnë në lëndë në procedura të rregullta, kështu që megjithëse janë zgjedhur prokurorë publikë shtesë në këtë prokurori, ata nuk mund të kontribuojnë në zvogëlimin e numrit të lëndëve të prapambetura që duhet të trajtohen në procedurë të rregullt në vend të shkurtuar.³⁴⁰

Vazhdon shpërndarja e pabarabartë e shërbimit të prokurorisë gjyqësore dhe publike në gjykatat dhe prokuroritë publike, duke marrë parasysh shtrirjen e gjykatës dhe prokurorisë, juridiksionin e tyre, numrin e popullsisë rezidente dhe numrin e përgjithshëm të lëndëve në punë.³⁴¹

Sa i përket gjykatave, sipas mesatares evropiane, nga gjithsej 34 gjykata, 7 gjykata janë të pajisura me shërbim gjyqësor ekspert mbi mesataren e përcaktuar evropiane, 4 gjykata janë brenda mesatares, ndërsa 23 gjykata janë nën mesataren evropiane. Situata është paksa e ndryshme nëse merret parasysh mesatarja vendase. Sipas standardit vendas prej 1.44 nëpunës profesional për gjyqtar, 15 gjykata kanë një shërbim gjyqësor ekspert mbi mesataren, ndërsa në 19 gjykata është nën këtë mesatare.³⁴²

Në prokuroritë publike situata është edhe më shqetësuese. Dy të tretat e prokurorive publike nuk janë të ekipuar me shërbim ekspert të prokurorisë publike në përputhje me mesataren e parashikuar evropiane. Megjithatë, duhet të merret parasysh se mesatarja evropiane nuk është më e përshtatshme për krahasim, pasi shumica e vendeve evropiane zbatojnë një model inkuizitor të procedurës, ndryshe nga Maqedonia e Veriut, e cila ka kaluar në një model akuzator. Sipas mesatares vendore prej 0.96 ekspertësh për prokuror publike, 46% e prokurorive kanë më pak se 1 ekspert të prokurorisë publike. Kjo do të thotë se këto prokurori nuk plotësojnë standardin minimal sipas të cilit çdo prokuror publik duhet të ketë në dispozicion të paktën 1 ekspert të prokurorisë publike, ndërsa në realitet këta ekspertë punojnë me më shumë se një prokuror publik. Nga ana tjetër, 40% e prokurorive kanë në dispozicion 1 ose më shumë nëpunës profesional për prokuror publik, ndërsa vetëm 14% e prokurorive kanë në dispozicion 2 ose më shumë nëpunës profesional për prokuror publik.³⁴³

339 Tutiq, "Analiza e situatës së burimeve njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

340 Ibid.

341 Ibid.

342 Ibid.

343 Ibid.

Këto të dhëna nxjerrin në pah nevojën për sistematizim më të mirë për një shpërndarje më të barabartë të shërbimit profesional në gjykata dhe prokurori publike, me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre dhe sigurimin e standardeve minimale të punës.

Gjatë periudhës raportuese është kompletuar përbërja e Gjykatës Kushtetuese. Një gjyqtar i ri kushtetues u emërua më 12 dhjetor 2023, duke plotësuar vendin e liruar në janar 2022.³⁴⁴ Për më tepër, më 8 shkurt 2024, pas tërheqjes së nominimit të ish-Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për gjyqtar të ri kushtetues,³⁴⁵ partia në pushtet propozoi një kandidat të ri, i cili më pas u zgjodh me sukses.³⁴⁶ Pas nëntë raundeve të votimit të pasuksesshëm, me katër gjyqtarë kandidatë në lojë dhe një kandidat të dorëhequr,³⁴⁷ gjyqtarë kushtetues zgjodhën një kryetar të ri të Gjykatës Kushtetuese më 9 qershor 2024,³⁴⁸ duke pasuar kryetaren e mëparshme, mandati i të cilës përfundoi më 2 qershor 2024.³⁴⁹ Kryetari i ri do të shërbejë për tre vjet pa të drejtë rizgjedhjeje.

Në 28 shkurt 2024, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë kërkesën ligjore për të treguar kombësinë në certifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes, duke fshirë praktikisht kolonën “kombësia” nga Ligji për Gjendjen Civile. Gjykata konstatoi se tregimi i detyrueshëm i këtij informacioni është në kundërshtim me parimin kushtetues të deklarimit të lirë të përkatësisë kombëtare. Neni përkatës në Kushtetutë jo vetëm që u lejon individëve të deklarojnë lirisht kombësinë e tyre, por gjithashtu u jep atyre të drejtën të mos deklarojnë ose ndryshojnë deklaratën e tyre – një fleksibilitet që nuk parashikohet nga dispozitat e shfuqizuara.³⁵⁰

Më 29 shkurt 2024, Kuvendi miratoi ndryshime në gjashtë ligje, të cilat përcaktojnë raportet e pagave për rreth 1,060 zyrtarë të zgjedhur dhe të emëruar, përfshirë presidentin, deputetët, ministrat, gjyqtarët dhe prokurorët publikë.³⁵¹ Këto ndryshime ndalojnë çdo rritje të mëtejshme të pagave, duke ruajtur rritjen prej 78% nga viti paraardhës.³⁵² Ndryshimet u kundërshtuan

344 “Jadranka Daboviq-Anastasovska zgjidhet për gjyqtare kushtetuese”, (Јадранка Дабовиќ-Анастасовска избрана за уставна судија), 360 Stepeni, 12 dhjetor 2023, <https://360stepeni.mk/jadranka-dabovik-anastasovska-izbrana-za-ustavna-sudija/>.

345 “Propozimi për zgjedhjen e Ljubomir Joveskit si gjyqtar kushtetues u tërhoq”, (Повлечен предлогот Љубомир Јовески да биде избран за уставен судија), 360 Stepeni, 24 janar 2024, <https://360stepeni.mk/joveski-iznenaduvachki-i-vulgarno-e-toa-shto-predlogot-za-ustaven-sudija-e-povlechen-bez-da-se-navedat-osnovnite-prichini/>.

346 “Ana Pavlovska-Daneva zgjidhet për gjyqtare kushtetuese – përbërja e Gjykatës Kushtetuese është e plotë”, (Ана Павловска-Данева избрана за уставен судија – комплетиран е составот на Уставниот суд), TV Telma, 8 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/08/ana-pavlovska-daneva-izbrana-za-ustaven-sudija-kompletiran-e-sostavot-na-ustavniot-sud/>.

347 “Lajm i jashtëzakonshëm: Ana Pavlovska Daneva tërhiqet, a do të ketë Kryetar të Gjykatës Kushtetuese?”, (Вонредна вест: Ана Павловска Данева се повлекува, ќе добие ли Уставен претседател?), TV Telma, 3 qershor 2024, <https://telma.com.mk/2024/06/03/vonredna-vest-ana-pavlovska-daneva-se-povlekuva-ke-dobie-li-ustaven-pretседател/>.

348 “Darko Kostadinovski është Kryetari i ri i Gjykatës Kushtetuese”, (Дарко Костадиновски е нов претседател на Уставен суд), Kanal 5, 4 qershor 2024, <https://kanal5.com.mk/darko-kostadinovski-e-nov-pretседател-na-ustaven-sud/a643416>.

349 “Përfundon mandati i kryetares Kacarska”, (Заврши мандатот на претседателката Кацарска), Radio-Televizioni i Maqedonisë (RTM), 29 maj 2024, <https://mrt.com.mk/node/110303>.

350 “Heqja e seksionit “kombësia” në tre nene të Ligjit për Gjendjen Civile”, (Укинат делот „националност“ во три члена од Законот за матична евиденција), faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://ustavensud.mk/?p=25759>.

351 “Miratohet paketa e ligjeve për pagat e personave të zgjedhur dhe të emëruar”, (Изгласани пакетот закони за платите на избраните и именуваните лица), Biznisvesti.mk, 29 shkurt 2024, <https://biznisvesti.mk/izglasani-paketot-zakoni-za-platite-na-izbranite-i-imenuvanite-litsa/>.

352 Ibid.

nga Këshilli Gjyqësor,³⁵³ Këshilli i Prokurorëve Publikë,³⁵⁴ Shoqata e Gjyqtarëve³⁵⁵ dhe Shoqata e Prokurorëve Publikë,³⁵⁶ të cilat argumentojnë se ndryshimet komprometojnë pavarësinë financiare të gjyqësorit, ndikojnë negativisht në vendimmarrje, praktikat e punësimit dhe pagesën e shtesave të pagave. Rrjedhimisht, ata paraqitën mocione në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e këtyre ndryshimeve, veçanërisht ato që prekin ligjet e pagave të gjyqtarëve, anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe prokurorëve publikë.³⁵⁷ Pastaj, më 19 mars 2024, Qeveria miratoi edhe uljen e koeficientëve të pagave për zyrtarët që emëron, gjë që siguroi respektimin e Ligjit për pagën dhe shpërblimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar në republikë.³⁵⁸

Pas paraqitjes së mocioneve në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë, Gjykata më 15 maj³⁵⁹ dhe 20 qershor 2024³⁶⁰ refuzoi mocionet, duke konstatuar se ndryshimet janë bërë në interes të publikut me qëllim të kufizimit të shpenzimeve buxhetore dhe ruajtjes së stabilitetit financiar përballë krizës ekonomike. Gjykata vlerësoi se masa është proporcionale sepse diferenca kompensohet përmes përafrimit vjetor me rritjen e pagës mesatare, kështu që pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë mbeten të përshtatshme për statusin dhe funksionin e tyre, dhe masa është e përkohshme, nuk ka pasoja negative të qëndrueshme dhe është në përputhje me parimin e sundimit të ligjit.

353 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://bit.ly/49UBjvX>.

354 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://bit.ly/3UxdpCg>.

355 “Njoftim publik në lidhje me propozimin e Ligjit për ndryshimin e Ligjit për pagat e gjyqtarëve në procedurë të shkurtuar”, (Соопштение на јавноста во врска со предлог на Законот за изменување на Законот за платите на судиите по скратена постапка), faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://bit.ly/49WdCU2>.

356 “Shoqata e Prokurorëve Publikë reagon pas shpalljeve për ndryshimet ligjore për pagat”, (Здружението на јавни обвинители реагира по најавените законски измени за платите), A1 ON, 28 shkurt 2024, <https://a1on.mk/macedonia/zdruzhenieto-na-javni-obviniteli-reagira-po-na-javenite-zakonski-izmeni-za-platite/>.

357 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 mars 2024, <https://bit.ly/4bcPltE>; “Iniciativa për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë”, (Иницијатива за оценување на уставноста и законитоста), faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 mars 2024, <https://bit.ly/4d8Ghbn>.

358 “Nga seanca e 11-të qeveritare: Vendimi për zvogëlimin e koeficientëve të pagave të zyrtarëve të emëruar nga Qeveria; Konkluzioni për realizimin e së drejtës së votës së qytetarëve me dokumente personale të skaduara”, (Од 11-тата владина седница: Одлука за намалување на коефициентите на платите на функционерите кои ги именува Владата; Заклучок во насока на реализација на правото на глас на граѓани со истечени лични документи), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://vlada.mk/node/36224>.

359 “Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut U.Nr122/2024 u.nr. 123/2024,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 141/2024.

360 “Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut U.NR?? 131/2024 dhe U.NR143/2024,” Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 148/2024.

Është e nevojshme që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë në analizat e tyre për shpalljen e numrit të vendeve vakante të përcaktojnë se sa pozicione gjyqësore dhe prokuroriale do të jenë vakante deri në përfundimin e trajnimit, duke përshtatur shpalljet për pranimin e pjesëmarrësve me nevojat reale të gjykatave, prokurorive ose qarqeve të apelit. Përveç kësaj, ndryshimet në Ligjin për Akademinë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë janë të nevojshme për të publikuar shpallje posaçërisht sipas qytetit dhe për pozicione specifike të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë;

Delegimi i përkohshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë duhet të përdoret ekskluzivisht si një masë ad-hoc për të trajtuar një fluks të shtuar të lëndëve, duke marrë parasysh profilin e personave të deleguar për t'iu përshtatur nevojave të gjykatës ose prokurorisë publike. Para se të merret një vendim për delegimin, është e nevojshme të kryhet një analizë e hollësishme e situatës, duke përfshirë afatet kohore dhe cilësinë e operacioneve, për të siguruar një trajtim të ekuilibruar dhe të përgjegjshëm pa kompromentuar cilësinë e vendimeve;

Është e nevojshme të rishikohen aktet për sistematizimin e vendeve të punës në gjykata dhe prokurori publike, për të cilat Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të përgatisin një metodologji si bazë për hartimin e akteve të reja. Zhvillimi i metodologjisë duhet të marrë parasysh treguesit kryesorë, siç janë të dhënat zyrtare nga regjistrimi i vitit 2021, fluksi dhe kompleksiteti i artikujve, koha e nevojshme për zgjidhjen e tyre, cilësia e punës, si dhe mundësitë e punësimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për pozicione të caktuara. Për të siguruar gjithëpërfshirje, këshillat duhet të mbledhin të dhëna nga burime të shumta dhe të përfshijnë aktorë të ndryshëm, duke organizuar takime pune me gjyqtarë dhe prokurorë publikë, si dhe duke u konsultuar me ekspertë dhe institucione përkatëse.



2. Lufta kundër korrupsionit



Në periudhën raportuese, vazhduan efektet negative të ndryshimeve të fundit në Kodin Penal për rastet e korrupsionit të profilit të lartë, të cilat kontribuan, ndër të tjera, që Republika e Maqedonisë së Veriut të mos bënte përparim të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Raportet nga burime të ndryshme, përfshirë Transparency International,³⁶¹ Departamenti Amerikan i Shtetit³⁶² dhe Freedom House,³⁶³ tregojnë një përparim minimal, por gjithashtu tregojnë nevojën për përmirësim në luftën kundër korrupsionit, me fokus në rritjen e buri-meve dhe mbështetjen për institucionet që zbatojnë masat antikorruption.

Raporti i vitit të kaluar i KE-së për Republikën e Maqedonisë së Veriut theksoi shqetësimet në lidhje me nivelin e gatishmërisë së vendit, i cili u vlerësua si “i caktuar dhe i moderuar” për sa i përket luftës kundër korrupsionit, pikërisht për shkak të vonesave dhe shqyrtimeve të shumë vendimeve në lëndët e korrupsionit të profilit të lartë.³⁶⁴

Vlerësimi i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) zbuloi se Maqedonia e Veriut zbatoi në mënyrë të kënaqshme vetëm 13 nga 23 rekomandimet për parandalimin e korrupsionit nga raporti i harmonizimit të raundit të pestë të vlerësimit.³⁶⁵ Në shtesën e dytë të Raportit të Dytë për Republikën e Maqedonisë së Veriut, GRECO vlerësoi se nga 19 rekomandime në lidhje me parandalimin e korrupsionit midis deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve, 14 u zbatuan në një shkallë të kënaqshme, katër rekomandime u zbatuan pjesërisht dhe vetëm një rekomandim nuk u zbatua nga vendi.³⁶⁶

Sipas Vlerësimit Kombëtar të Sistemit të Integritetit për vitin 2023 të përgatitur nga Transparency International – Maqedoni, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) së bashku me Entin Shtetëror të Revizionit dhe Avokatin e Popullit kanë rezultatet më të mira për integritetin, llogaridhënien, përgjegjësinë dhe gatishmërinë për të luftuar korrupsionin.³⁶⁷

361 “IPK 2023 për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore: Autokracia dhe sistemet e dobëta të drejtësisë mundësojnë korrupsion të përhapur”, (ИПК 2023 за источна Европа и централна Азија: Автократијата и слабите правосудни системи овозможуваат широкораспространета корупција), faqja zyrtare e Transparency International – Maqedoni, 30 janar 2024, <https://transparency.mk/2024/01/30/ipk-2023-za-istochna-evropa-i-cztralna-azi-%d1%98a-avtokrati-%d1%98ata-i-slabite-pravosudni-sistemi-ovozmozhuvaat-shiroko-rasprostraneta-korupczj%d1%98a/>.

362 Departamenti Amerikan i Shtetit “Raporti vjetor mbi situatën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023”, (2023 Country Reports on Human Rights Practices: North Macedonia), 23 prill 2024, <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>.

363 Freedom House, “Shtetet në Tranzicion 2024: Republika e Maqedonisë së Veriut”, (Nations in Transit 2024: Republic of North Macedonia), 11 prill 2024, <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2024>.

364 Komisioni Evropian, “Dokumenti i punës i Komisionit – Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023”.

365 GRECO: Maqedonia nuk është në përputhje të mjaftueshme me rekomandimet e Raportit të Vlerësimit të Antikorruptionit, (ГРЕКО: Македонија е недоволно усогласена со препораките од Извештајот за евалуација во борбата против корупција), TV Sitel, 18 tetor 2023, <https://sitel.com.mk/greko-makedonija-e-nedovolno-usoglasena-so-preporakite-od-iz-veshtajot-za-evaluacija-vo-borbata>.

366 “GRECO është ende duke pritur që autoritetet maqedonase të shfuqizojnë funksionin e Ministrit të Drejtësisë në Këshillin Gjyqësor”, (ГРЕКО сè уште чека македонските власти да ја укинат функцијата на министерот за правда во Судскиот совет), 360 Stepeni, 12 mars 2024, <https://360stepeni.mk/greko-se-ushte-checka-makedonskite-vlasti-da-ja-ukinat-funktsijata-na-ministerot-za-pravda-vo-sudskiot-sovet/>.

367 Slagjana Taseva dhe të tjerë., Sistemi Kombëtar i Vlerësimit të Integritetit 2023, (Национален систем за интегритет-оценка 2023), Transparency International – Maqedoni, 17 nëntor 2023, <https://transparency.mk/wp-content/uploads/2024/01/national.integrity.system.assessment.2023-4.pdf>.

KSHPK është një nga shtyllat që përbëjnë këtë sistem integriteti dhe shënohet e dyta në listën e 15 shtyllave. Në të njëjtën kohë, PP është shtylla me vlerësim më të ulët.³⁶⁸

Renditja e institucioneve sipas performancës anti-korrupsion në prokurimet publike të përgatitura nga Qendra për Komunikime Civile vuri në dukje implikimet e mundshme të korrupsionit në prokurimet publike, duke pasur parasysh se vlera e prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në Buxhetin e vendit me 24%, pra në baza vjetore tejkalon 1 miliard euro. Sipas kësaj analize, me renditjen më të ulët në performancën anti-korrupsion në prokurimin publik janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve me Komunitetet, ndërsa më të mirët janë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Njësitë e vetëqeverisjes lokale tregojnë rezultate më të dobëta në aspektin e ministrive, ku komuna e Kratovës, komuna e Gostivarit dhe Qyteti i Shkupit tregojnë nivelin më të ulët të arritjeve të performancës anti-korrupsion në prokurimin publik, ndërsa më mirë të renditura janë komuna e Kavadarit, komuna e Velesit dhe komuna e Probishtipit.³⁶⁹

Gjatë Këshillit Ministror të OSBE-së në Shkup, ministrat e jashtëm nga rajoni nënshkruan një deklaratë për luftën kundër korrupsionit, duke u përqëndruar në hetimet financiare dhe digjitalizimin, si dhe rikuperimin e pasurisë së fituar përmes aktiviteteve kriminale.³⁷⁰

368 "Revizioni, Antikorrupsioni dhe Avokati i Popullit me rezultatet më të mira për integritetin, më të dobët prokuroria, gjykatat dhe shërbimet e zbatimit të ligjit", (Ревизија, Антикорупциска и Омбудсман со најдобри резултати за интегритет, најслаби обвинителството, судовите и службите за спроведување на законите), Nova TV, 12 janar 2024, <https://novatv.mk/revizija-antikoruptsiska-i-ombudsman-so-najdobri-rezultati-za-integritet-najslabi-obvinitelstvoto-sudovite-i-sluzh-bite-za-sproveduvane-na-zaknite/>.

369 Qendra e Komunikimeve Civile, "Renditja e Institucioneve sipas Performancës Antikorrupsion në Prokurimin Publik", (Рангирање на институциите според антикорупциските перформанси во јавните набавки), 2024, <https://bit.ly/3CluVTB>.

370 Ministrat e jashtëm të rajonit nënshkruan një deklaratë për luftën kundër korrupsionit, (Министрите за надворешни работи од регионот потпишаа декларација за борба против корупцијата), 360 Stepni, 30 nëntor 2023, <https://360stepni.mk/ministrite-za-nadvoreshni-raboti-od-regionot-potpishaa-deklaratsija-za-borba-protiv-korupsiata/>.

Kuadri institucional

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

Më 7 nëntor 2023, u publikua njoftimi publik për zgjedhjen e përbërjes së ardhshme të KSH-PK.³⁷¹ Pas përzgjedhjes fillestare administrative, në të cilën u refuzuan 15 kandidatë, u zhvilluan intervista me 41 kandidatë nga data 23 deri më 25 nëntor.³⁷² Lista e kandidatëve të publikuar në fund të nëntorit³⁷³ përfshinte katër auditues, dy punonjës të KSHPK dhe një gjyqtar.³⁷⁴ Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit dënoi partishmërinë e perceptuar të procesit zgjedhor, duke shprehur shqetësimin për objektivitetin dhe paanshmërinë e përbërjes së ardhshme të KSHPK.³⁷⁵ Në fund të dhjetorit, Kuvendi miratoi listën e kandidatëve, dhe mandati i tyre filloi më 8 shkurt 2024.³⁷⁶

Nga fundi i mandatit të përbërjes së mëparshme të KSHPK, ata raportuan se kishin hapur 5,283 lëndë gjatë mandatit të tyre, nga të cilat 2,872 për korrupsion, 888 për konflikt interesi, 144 për ndalime në lidhje me procesin zgjedhor dhe 1,379 për kontrole të pronës. Janë lëshuar 898 urdhërpagesa për shkelje të ligjit, duke mbledhur gjoba me vlerë rreth tetë milionë euro që kanë hyrë në buxhetin e shtetit.³⁷⁷ Por pavarësisht fillimit të 56 procedimeve penale, asnjë kallëzim nuk është ngritur për shkak të mosveprimit të institucioneve të tjera.³⁷⁸

371 Vendimi për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 234/2023.

372 "Procesverballi i intervistave të zhvilluara me kandidatët pas vendimit për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit", (Записник од спроведените интервјуа со кандидатите по Одлука за објавување јавен оглас за избор на претседател и членови на Државната комисија за спречување на корупцијата), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 nëntor 2023, <https://www.sobranie.mk/content/ОГЛАС%20КОРУПЦИЈА%202023/zapisnikDKSK23.pdf>.

373 "Renditja e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit", (Ранг-листа на кандидати за Претседател и членови на Државната комисија за спречување на корупцијата), faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 nëntor 2023, <https://www.sobranie.mk/content/ОГЛАС%20КОРУПЦИЈА%202023/rang-listaDKSK23.pdf>.

374 "Revizorë, nëpunës dhe gjyqtarë – përcaktohen anëtarët e përbërjes së re të Komisionit Kundër Korrupsionit", (Ревизори, службеници и судијка – утврдени членовите на новиот состав на Антикорупциска комисија), Radio MOF, 29 nëntor 2023, <https://www.radiomof.mk/revizori-sluzhbenici-i-sudijka-utvrdeni-chlenovite-na-noviot-sostav-na-antikorupciska-komisija/?fbclid=IwAR2dKaTrpoBFuaXyE6OtzQCF2pbQTsUyXOVOGd7aE4Ent5LfnFpSI-qY0ZI>.

375 "Platforma e organizatave të shoqërisë civile për të luftuar korrupsionin dënon fuqishëm partishmërinë në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KSHPK", (Платформата на граѓански организации за борба против корупција остро ја осудува партизацијата при изборот на нови членови на ДКСК), faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 nëntor 2023, <https://mhc.org.mk/news/platformata-na-graganski-organizacii-za-borba-protiv-korupcija-ostro-ja-osuduva-partizacijata-pri-izborot-na-novi-chlenovi-na-dksk/>.

376 "Kuvendi votoi Komisionin Kundër Korrupsionit të kryesuar nga revizorja Tatjana Dimitrovska", (Собранието ја изгласа Антикорупциската комисија на чело со ревизорката Татјана Димитровска), Sakam da Kazam, 22 dhjetor 2023, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/sobranieto-ja-izglasa-novata-antikoruptsiska-komisija-na-chelo-so-revizorkata-tatjana-dimitrovska/>.

377 "Pesë vjet KSHPK: Shkarkimet gjyqësore kundër zyrtarëve amanet për antikorrupsionistët e ardhshëm", Sloboden Pecat, (Пет години мандат на ДКСК: Судските разрешници против функционерите amanet за идните антикорупционери), 31 janar 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/https-www-slobodenpecat-mk-pet-godini-mandat-na-dksk-sudskite-razreshnici-protiv-funkcionerite-amanet-na-antikorupcionerite/>.

378 "Në pesë vjet nuk ka pasur epilog nga asnjë iniciativë e Komisionit Antikorrupsion", (За пет години нема епилог од ниту една иницијатива на Антикорупциската), Radio MOF, 1 shkurt 2024, <https://www.radiomof.mk/za-pet-godini-nema-epilog-od-nitu-edna-inicijativa-na-antikorupciskata/>.

KSHPK ka marrë 549 raporte nga qytetarët gjatë vitit 2023 për rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës publike. Ai formoi 13 lëndë me iniciativën e tij dhe lëshoi 160 urdhërpagesa për kundërvajtje. Në fushën e korrupsionit ka marrë vendime për 1,074 lëndë, në fushën e konfliktit të interesit ka marrë vendime për 146 lëndë, në fushën e financimit të fushatave zgjedhore ka vendosur për 2 lëndë dhe në aspektin e pasurisë ka vendosur për 235 lëndë (gjithsej 1,455 vendime).³⁷⁹ Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2023 tregoi se vetëm 13% e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023 janë zbatuar plotësisht, 33% janë në proces të zbatimit, dhe 54% nuk janë zbatuar fare, me përparimin më të madh në shëndetësi dhe drejtësi.³⁸⁰

Në pjesën e dytë të nëntorit 2023, në KSHPK u zhvillua një mision ekspertësh i TAIEX për ndihmë teknike dhe shkëmbim informacioni mbi konfliktet e interesit, me fokus në parandalimin e konflikteve të interesit dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis personave të emëruar dhe të zgjedhur.³⁸¹

Që nga fillimi i vitit 2024, sistemi i ri elektronik për paraqitjen e deklaratës së pasurisë dhe intereseve nëpërmjet <https://imotnasostojba.dksk.mk/>,³⁸² ka qenë në veprim, dhe në fillim të qershorit të dhënat nga deklaratat e pasurisë dhe interesit u publikuan në faqen e internetit të KSHPK.³⁸³

Në periudhën parazgjedhore, si dhe pas zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale, përbërja e re e KSHPK realizoi aktivitete të shumta për të luftuar korrupsionin në procesin zgjedhor. Në muajin prill u publikua lista me mbi 1,000 institucione publike: ministri, komuna, gjykata, spitale, shkolla dhe ndërmarrje publike, të cilat nuk përmbushën detyrimin ligjor për dorëzimin e të dhënave për mjetet motorike në dispozicion të tyre.³⁸⁴ Sipas KSHPK, këto të dhëna, të cilat duhej të dorëzoheshin dhjetë ditë pas shpalljes së zgjedhjeve për të parandaluar abuzimin politik, nuk u siguruan nga 75% e këtyre institucioneve, gjë që është shkak për shqetësim për shkak të korrupsionit të mundshëm.³⁸⁵ Pas zgjedhjeve, u botua një raport i veçantë për

379 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, “Raporti vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023”, (Годишен извештај за работата на Државната комисија за спречување на корупција за 2023 година), shkurt 2024, <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2024/03/1-ГИ-2023-конечен.pdf>.

380 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, “Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025 për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023”, (Годишен извештај за спроведување на Националната стратегија за спречување на корупцијата и судирот на интереси 2021-2025 за период 01.01.2023 година до 31.12.2023 година), shkurt 2024, <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2024/02/Годишен-извештај-НС-2023-Usvoen-na-sednica.pdf>.

381 “Misioni i ekspertit TAIEX me temën e konfliktit të interesit: Analiza e mekanizmave për parandalimin e konflikteve të interesit dhe rritjen e ndërgjegjësimit drejt personave të emëruar dhe të zgjedhur”, (ТАИЕКС експертска мисија на тема судир на интереси: Анализа на механизми за спречување на судир на интереси и подигање на свеста насочена кон именувани и избрани лица), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 24 nëntor 2023, <https://bit.ly/48ZM3cn>.

382 “Nga data 01.01.2024 do të vihet në funksion sistemi i ri elektronik për depozitimin e deklaratës së pasurisë dhe intereseve”, (Од 01.01.2024 ќе биде во функција новиот електронски систем за поднесување на изјава за имотна состојба и интереси), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 28 dhjetor 2023, <https://bit.ly/3O727RL>.

383 “Njoftim”, (Соопштение), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 3 qershor 2024, <https://bit.ly/4c1AzWU>.

384 “Mbi 1,000 institucione nuk kanë paraqitur të dhëna se sa automjete kanë, thotë Komisioni Kundër Korrupsionit”, (Над 1.000 институции не доставиле податоци со колку возила располагаат, велат од Антикорупциската комисија), 360 Stepeni, 1 prill 2024, <https://360stepeni.mk/nad-1-000-institutsii-ne-dostavile-podatotsi-so-kolku-vozila-raspologa-at-velat-od-antikorrupsiskata-komisija/>.

385 “KSHPK: Ekziston dyshimi për keqpërdorim të automjeteve zyrtare në zgjedhje”, (ДКСК: Постои сомнеж за злоупотреба на службени возила на изборите), Prizma, 4 prill 2024, https://prizma.mk/dsk-postoi-somnezh-za-zloupotreba-na-sluzhbeni-vozila-na-izborite/?fbclid=IwAR1S5yZvp2pFccoR4KiN4g0LbCg7e-RRppcw2XbXfKq0aE8solYf5_2l.

financimin e zgjedhjeve presidenciale³⁸⁶ dhe një raport i veçantë për financimin e zgjedhjeve parlamentare.³⁸⁷ Këto raporte zbuluan dobësi të shumta, rrezeqe korrupsioni dhe sfida që lidhen me aspektet financiare të fushatës zgjedhore: 77% e financimit për fushatën zgjedhore sigurohet nga buxheti i shtetit i cili hap mundësinë e një ndikimi të mundshëm të partive politike në politikën editoriale të mediave, ekziston gjithashtu një shkallë e ulët e zbatimit të detyrimit ligjor për të dhënë informacion mbi automjetet në pronësi të institucioneve publike që çon në një rrezik të konsiderueshëm të keqpërdorimit të atyre automjeteve për qëllime zgjedhore dhe katër parti që morën pjesë në zgjedhje nuk paraqitën raporte financiare për donacionet. Janë hapur gjithsej 65 hetime për shkelje të dyshuara të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për shkak të shkeljeve të ndalimit të punësimeve të reja, si dhe shkarkimeve në institucionet publike gjatë zgjedhjeve.

Në periudhën raportuese, KSHPK tërhoqi vëmendje të konsiderueshme për shkak të një sërë hetimesh të kryera kundër funksionerve aktualë dhe ish-funksionerve. Pas konstituimit të Kuvendit të ri, pati njoftime nga të gjitha ministratë, ministrat e të cilave u bënë deputetë, se funksionet e tyre u kalonin zëvendësve. Por kjo nuk vlente për ish-kryeministrin dhe ministrin e mëparshëm të shëndetësisë, të cilët gjithashtu u bënë deputetë. Mbajtja e të dy posteve publike çoi në një reagim nga KSHPK, duke kujtuar parimin kushtetues të papajtueshmërisë së posteve publike dhe detyrimin për respektimin e parimit të integritetit.³⁸⁸ Gjithashtu, është marrë vendim për shkarkimin e paligjshëm të drejtorit mjekësor të Klinikës së Toksikologjisë dhe drejtorit të Kirurgjisë Kardiake Shtetërore nga Ministri i Shëndetësisë për shkelje të ligjeve për parandalimin e korrupsionit dhe ligjeve zgjedhore dhe kujdesit shëndetësor.³⁸⁹ Kishte gjithashtu një rast të konfliktit të interesit dhe nepotizmit kur një kryetar komune promovoi gruan e tij nga bashkëpunëtore në këshilltare³⁹⁰ dhe filloi një hetim mbi pronën e drejtorit organizativ të Klinikës Universitare të Toksikologjisë – Shkup për shkak të mospërputhjes së dy pyetësorëve të paraqitur.³⁹¹

386 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, “Raport i veçantë mbi gjendjet e përcaktuara në financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024”, (Poseben izveštaj za utvrdenite sostojbi vo finansiranjeto na izbornata kampanja za izbor na pretседател na Република Северна Македонија 2024 година), 13 gusht 2024, <https://bit.ly/4eTmc47>.

387 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, “Raport i veçantë për gjendjet e përcaktuara në financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjen e përfaqësuesve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024”, (Poseben izveštaj za utvrdenite sostojbi vo finansiranjeto na izbornata kampanja za izbor na пратеници во Собранието на Република Северна Македонија 2024), 30 gusht 2024, <https://dsk.mk/wp-content/uploads/2024/08/DKSK-Izveštaj.pdf>.

388 “Antikorrupsioni u bën thirrje zyrtarëve të zgjedhur të respektojnë detyrimet kushtetuese dhe ligjore”, (Антикорупциска ги повикува избраните функционери да ги почитуваат уставните и законските обврски), Civil Media, 31 maj 2024, <https://civilmedia.mk/antikoruptiska-gi-povikuva-izbranite-funkcioneri-da-gi-pochituvaat-ustavnite-i-zakonskite-obvrski/>.

389 “KSHPK: Është e paligjshme të shkarkohen drejtorët e Toksikologjisë dhe Kirurgjisë Kardiake”, (ДКСК: Незаконски се разрешувањата на директорите на Токсикологија и Кардиохирургија) Sloboden Pecat, 10 qershor 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/dsk-nezakonski-se-razreshuvanjata-na-direktorite-na-toksikologija-i-kardiohirurgija/>.

390 “KSHPK: Kryetari promovoi bashkëshorten e tij në këshilltar në komunën e tij”, (ДКСК: Градоначалник си ја унапредил сопругата во советник во неговата општина), TV Telma, 12 qershor 2024, <https://telma.com.mk/2024/06/12/dsk-gradonachalnik-si-ja-unapredil-soprugata-vo-sovetnik-vo-negovata-opshtina/>.

391 “KSHPK do të inspektojë pasurinë e drejtoreshës së Toksikologjisë, Besia Ilazi, e cila ka dorëzuar dy deklarata të ndryshme”, (ДКСК ќе го проверува имотот на директорката на Токсикологија, Бесија Илази, доставила два различни анкетни листови), MakPress, 23 maj 2024, <https://m.makpress.mk/Home/PostDetails?PostId=588697>.

Hetime ndaj zyrtarëve aktual u hapën për udhëtimin e djalit të Kryeministrit me të në një udhëtim pune,³⁹² emërimin e motivuar politikisht të ushtruesit të detyrës Revizor i Përgjithshëm për Fondet IPA,³⁹³ emërimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë³⁹⁴ dhe emërimin e një Zëvendës Drejtori të Agjencisë së Zbulimit³⁹⁵ të cilë mund të mos plotësojnë kushtet e nevojshme për këto pozita, pasuritë e dhuruara Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë³⁹⁶ dhe vërtetësia e Deklarimit të pronës të ish-kryeministrit që aktualisht është deputet.³⁹⁷

Gjithashtu, KSHPK nisi hetime ndaj ish-zyrtarëve për 189 vendime për shpërndarjen e punonjësve të marra nga ish-zëvendësministri i Punëve të Brendshme në qeverinë teknike në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Kodit Zgjedhor³⁹⁸ dhe natyrën e kostove të shkaktuara nga ish-ministria i Kulturës gjatë një udhëtimi pune.³⁹⁹ Paraqiti iniciativa për procedim penal në Prokurorinë Publike Shkup kundër ish-drejtorit organizativ të Klinikës së Toksikologjisë për shpërdorim detyre gjatë lidhjes së kontratave me punonjësit shëndetësorë në kundërshtim me Ligjin e Kujdesit Shëndetësor⁴⁰⁰ dhe kundër ish-drejtorit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike për vendosjen e punonjësve dhe lidhjen e kontratave të reja të punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.⁴⁰¹

392 “Dimitrovska: KSHPK do të kontrollojë udhëtimin e djalit të Mickoskit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, (Димитровска: ДКСК ќе го проверува патувањето на синот на Мицкоски во САД), Sloboden Pecat, 15 korrik 2024, <https://www.sloboden-pecat.mk/dimitrovska-dksk-kje-go-proveruva-patuvanjeto-na-sinot-na-mickoski-vo-sad/>.

393 “Revizori i Përgjithshëm për fondet IPA nuk mund të jetë ushtrues i detyrës – ligji më i fortë se dëshira për zgjidhje të përkohshme në Verzivoli dhe Ramadani”, (Главен ревизор за ИПА фондови не може да биде в.д. – законот посилен од желбата за привремено решение во Верзивиоли и Рамадани), TV Telma, 12 gusht 2024, <https://telma.com.mk/2024/08/12/glaven-revizor-za-ipa-fondovi-ne-mozhe-da-bide-v-d-zakonot-posilen-od-zhelbata-za-privremeno-reshenie-vo-verzivoli-i-ramadani/>.

394 “KSHPK hapi një çështje për Shefin e sapoemëruar të Shtabit të Përgjithshëm të ARM-së”, (ДКСК отвори предмет за новоназначениот началник на Генералштабот на АРМ), 360 Stepeni, 21 gusht 2024, <https://360stepeni.mk/dksk-otvori-predmet-za-povonaznacheni-ot-nachalnik-na-generalshabot-na-arm/>.

395 “KSHPK formoi lëndë për Zëvendës Drejtorin e Agjencisë të Inteligjencës dhe ish Zëvendës Ministrin në Ministrinë e Brendshme”, (ДКСК оформи предмети за заменик-директорката во Агенцијата за разузнавање и за поранешниот заменик-министер во МВР), 360 Stepeni, 10 korrik 2024, <https://360stepeni.mk/dksk-oformi-predmeti-za-zamenik-direktor-kata-vo-agentsijata-za-razuznavane-i-za-poraneshniot-zamenik-minister-vo-mvr/>.

396 “Komisioni Antikorrupsion hapi një lëndë për pronën me vlerë 325,000 euro që iu dha Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë Janushev vitin e kaluar”, (Антикорупциската комисија отвори предмет за имотот вреден 325.000 евра што лани му бил подарен на генералниот секретар на Владата Јанусhev), Sakam da Kazam, 23 korrik 2024, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/antikorruptsiskata-komisija-otvori-predmet-za-imotot-vreden-325-000-evra-shto-lani-mu-bil-podaren-na-generalniot-sekretar-na-vladata-janushev/>.

397 “KSHPK hap lëndë për verifikimin e deklaratave të pasurisë së Kovačevskit”, (ДКСК отвори предмет за проверка на анкетниот лист на Ковачевски), Radio Evropa e Lirë, 26 korrik 2024, https://www.slobodnaevropa.mk/a/33052145.html?fbclid=IwY2xjawEQjepleHRuA2FlbQlXMQABvHeYni6-fhcFHY3Bb2FBorD-F_UwhcoFAEdSh7YRTcfuwZRF6jOmwoe2A_aem_zd1GAh6pCg9FzWw5e4YBvWw.

398 “KSHPK: Zëvendësministër në qeverinë teknike, edhe pse nuk i është lejuar, shpërndau 189 punonjës”, (ДКСК: Заменик-министер во техничката влада, иако не смеел, распоредил 189 вработени), Radio Evropa e Lirë 24 korrik 2024, <https://bit.ly/3BwuUeV>.

399 “Komisioni Antikorrupsion hap lëndë për shpenzimet e Kostadinovska-Stojčevska”, (Антикорупциската комисија отвора предмет за трошоците на Костадиновска-Стојчевска), TV Telma, 26 gusht 2024, <https://telma.com.mk/2024/08/26/antikorruptsiskata-komisija-otvara-predmet-za-troshocite-na-kostadinovska-stojchevska/>.

400 “KSHPK: Prokuroria Publike Shkup filloi procedurat kundër ish-drejtorit organizativ të Klinikës së Toksikologjisë”, (ДКСК: ОЈО Скопје отпочна постапка против поранешниот организациски директор на Клиниката за токсикологија), Radio MOF, 25 shtator 2024, <https://www.radiomof.mk/dksk-ojo-skopje-otpochna-postapka-protiv-poraneshniot-organizaciski-direktor-na-klunikata-za-toksikologija/>.

401 “KSHPK ka paraqitur kërkesë për ndjekje penale të Sanja Llukarevskës për kryerjen e punës në mënyrë të paligjshme”, (ДКСК поднесе иницијатива за кривично гонење на Сања Лукаревска поради незаконско работење), Skorje Info, 4 shtator 2024, <https://bit.ly/4elctCs>.

Me urdhër të KSHPK-së, Inspektorati Shtetëror i Arsimit shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët e mëparshëm të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Gjatë shqyrtimit, u zbulua se një gjyqtar nga Gjykata Themelore e Tetovës aplikoi për punën me notë më të lartë se ajo e shënuar në një diplomë nga Universiteti i Tetovës. Inspektorati Shtetëror i Arsimit e raportoi menjëherë këtë në Prokurorinë Publike kompetente.⁴⁰²

KSHPK nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë Financiare për të nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë përmes komunikimit në kohë, të menjëhershëm dhe të ndërsjellë.⁴⁰³

Prokuroria Publike

Raporti i fundit për prokuroritë publike vë në dukje sfidën e vazhdueshme me të cilën përbalen në rritjen e numrit të lëndëve në raport me numrin e reduktuar të prokurorëve publikë, ku çdo prokuror trajton rreth 180 lëndë të reja në vit, një rritje prej 10 lëndësh krahasuar me një vit më parë. Pajisjet teknike të vjetëruara dhe burimet e pamjaftueshme financiare, së bashku me stafin e kufizuar të prokurorive publike mbeten sfidat më të mëdha për këto institucione.⁴⁰⁴

Megjithëse deri më tani janë krijuar katër qendra hetimore në Prokurorinë Publike, përfshirë Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, asnjë qendër e re nuk është hapur që nga viti 2018.⁴⁰⁵ Kjo e ndërlikon më tej punën e hetuesve duke pasur parasysh se numri i lëndëve të trajtuara nga hetuesit nga qendra hetimore e Prokurorisë Themelore Publike Shkup pothuajse është dyfishuar – nga 150 lëndë në vitin 2022 në 287 lëndë gjatë vitit 2023.⁴⁰⁶

Ndryshimet në Kodin Penal, të cilat parashikojnë uljen e dënimeve për veprat penale “shpërdorim detyre dhe autoriteti” dhe “shoqërim kriminal”⁴⁰⁷ prekën ndjeshëm disa lëndë të korrupsionit të profilit të lartë në Maqedoninë e Veriut. Në lëndën “Target-Kalaja”, procedurat kundër ish-drejtorit të Administratës së Sigurisë dhe Kundërbulimit u ndërprejnë për

402 “Gjyqtari Elvedin Ferati i Gjykatës Themelore Tetovë i korrigjoi notat e tij në Universitetin e Tetovës duke shkaravitur, konstaton Antikorrupsioni”, (Судијата Елведин Ферати од Основен суд Тетово си ги поправал оценките на Тетовскиот универзитет со пречкртување, утврди Антикоруписка), Sakam da Kazam, 27 dhjetor 2023, <https://bit.ly/42goWbh>.

403 “Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi midis Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Administratës së Policisë Financiare”, (Потпишан меморандум за соработка помеѓу Државната комисија за спречување на корупцијата и Управата за финансиска полиција), faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 26 mars 2024, <https://bit.ly/3VZBH8S>.

404 Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raport mbi punën e Prokurorive Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023”, (Извештај за работата на јавните обвинителства на Република Северна Македонија во 2023 година) 26 korrik 2024, <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2024/07/godishen-izveshtaj-2023-finalna-verzija-2.pdf>.

405 Ibid.

406 “BE – Sundimi i Ligjit” – takim pune i hetuesve nga të gjitha qendrat hetimore në prokuroritë publike”, (ЕУ – Владеење на правото – работен состанок на истражителите од сите истражни центри во јавните обвинителства), faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 prill 2024, <https://jorm.gov.mk/eu-vladeene-na-pravoto-raboten-sostanok-na-istrazhitelite-od-site-istrazhni-centri-vo-javnite-obvinitelstva/>.

407 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 188/2023.

shkak të parashkrimit.⁴⁰⁸ Në rastin "Thesari", në të cilin është akuzuar edhe ish-drejtori i Administratës së Sigurisë dhe Kundërzbulimit, gjykata ka vendosur lirim të pandehurve për shkak se prokurori publik nuk ka arritur të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se ai dhe të pandehurit e tjerë kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.⁴⁰⁹ Në lëndën "Titanik 2", Gjykata e Apelit Shkup hodhi poshtë aktakuzën kundër ish-drejtorit të Administratës për Siguri dhe Kundërzbulim, ndërsa të pandehurit e tjerë morën dënime të pezulluara.⁴¹⁰ Në lëndën "Toplik", në të cilin ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve ishte i pandehuri i parë, Gjykata e Apelit Shkup rrëzoi vendimin e shkallës së parë dhe e ktheu lëndën për rigjykim, pas së cilës, për shkak të parashkrimit të akteve, prokurori publik u tërhoq nga ndjekja e mëtejshme.⁴¹¹ Ngjashëm, në lëndën "Trajektorja" me propozim të Prokurorit Publik, gjykata refuzoi aktakuzën kundër ish-kryeministrit për shkak të parashkrimit, dhe gjykimi i tre të pandehurve të tjerë u pezullua për shkak të ndryshimeve të mësipërme.⁴¹² Në lëndën "Softueri", Gjykata e Apelit Shkup hoqi arrestin shtëpiak⁴¹³ të ish-Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë, i cili më parë ishte dënuar me tetë vjet burg,⁴¹⁴ ndërsa një tjetër ish-Sekretar i Përgjithshëm i Qeverisë u dënua me dy vjet e gjysmë burg për shpërdorim të detyrës dhe autorizimit.⁴¹⁵ Në lëndën "Titanik", Gjykata e Apelit Shkup i dha shkarkim me kusht ish-ministrit të Transportit dhe Lidhjeve⁴¹⁶ Lënda "Imperia" u kthye për rigjykim në gjykatën themelore kompetente, e cila nga ana e saj vendosi për lirim të kusht të ish-drejtorit të Administratës për Siguri dhe Kundërzbulim në fund të këtij viti,⁴¹⁷ ndërsa për të pandehurit e mbetur në këtë lëndë,

408 "Mijalkov nuk do të mbajë përgjegjësi për përgjimin e paligjshëm, lënda e "Target-Kalaja" është parashkruar, (Мижалков нема да одговара за нелегалното прислушување, застаре делото за „Таргет-Тврдина“), A1 ON, 17 tetor 2023, <https://a1on.mk/macedonia/mijalkov-nema-da-odgovara-za-nelegalното-prislushuvanje-zastare-deloto-za-target-tvrdina/>.

409 "Mijalkov, Grujovski dhe Jakimovski u liruan me vendim gjykate në rastin "Thesari", (Мижалков, Грујовски и Јакимовски добија ослободителна пресуда во случајот „Трезор“), 360 stepeni, 22 shkurt 2024, <https://360stepeni.mk/mijalkov-grujovski-i-jakimovski-dobija-osloboditelna-presuda-vo-sluchajot-trezor/>.

410 "Apeli heq aktakuzën e Mijalkovit në "Titanik 2" për shkak të parashkrimit, për Menduh Thačin dhe të akuzuarit e tjerë dënime me kusht", (Апелација го укина обвинението за Мијалков во „Титаник 2“ поради застареност, за Мендух Тачи и другите обвинети условни казни), 360 stepeni, 14 nëntor 2023, <https://360stepeni.mk/apelatsija-go-ukina-obvinenieto-za-mijalkov-vo-titanik-2-poradi-zastarenost-za-menduh-tachi-i-ostanatite-obvineti-uslovni-kazni/>.

411 "Ndryshimet në Kodin Penal e shpëtuan Janakieskin në "Toplik", Prokuroria hoqi dorë nga ndjekja penale për shkak të parashkrimit", (Измените на КЗ го спасија Јанакиески во „Топлик“, Обвинителството се откажа од гонење поради застареност), 360 Stepeni, 13 nëntor 2023, <https://360stepeni.mk/izmenite-na-kz-gos-pasija-janakieski-vo-toplik-obvinitelstvoto-se-otkazha-od-gonene-poradi-zastarenost/>.

412 "Ndaloni procedimi penal për lëndën "Trajektorja", (Запре кривичната постапка за случајот „Траекторија“), Kanal 5, 3 nëntor 2023, <https://kanal5.com.mk/zapre-krivichnata-postapka-za-sluchajot-traektorija/a609296>.

413 "Apeli shfuqizoi arrestin shtëpiak të Dragi Rashkovskit", (Апелација му го укина куќниот притвор на Драги Рашковски), 360 Stepeni, 14 nëntor 2023, <https://360stepeni.mk/apelatsija-mu-go-ukina-kukniot-pritvor-na-dragi-rashkovski/>.

414 "Rashkovski i dënuar me tetë vjet burg", (Рашковски осуден на осум години казна затвор), Makfaks, 6 korrik 2023, <https://bit.ly/3FKYi6C>.

415 "Muhamed Zeqiri i denuar me 2.5 vjet burg", (Мухамед Зекири осуден на 2,5 години затвор), Deutsche Welle, 1 dhjetor 2023, https://www.dw.com/mk/muhamed-zekiri-osuden-na-25-godini-zatvor-za-dogovorite-za-posta/a-67606420?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

416 "Apeli: Janakieski lirohet në qershor, ndërsa për lirim me kusht të Mijalkov do të vendosë Gjykata Penale", (Апелација: Јанакиески во јуни излегува на слобода, а за условен отпуст на Мијалков ќе одлучува Кривичен суд), 360 Stepeni, 12 mars 2024, <https://360stepeni.mk/apelatsija-janakieski-vo-juni-izleguva-na-sloboda-a-za-usloven-otпуст-na-mijalkov-ke-odluchuva-krivichen/>.

417 "Mijalkov mori një lirim me kusht nga burgu i Strugës, në dhjetor ai del në liri", (Мијалков доби условен отпуст од струшкиот затвор, во декември излегува на слобода), 360 Stepeni, 1 prill 2024, <https://360stepeni.mk/mijalkov-dobi-usloven-ot-pust-od-strushkiot-zatvor-vo-dekemvri-izleguva-na-sloboda/>.

Prokuroria Publike Shkup vendosi të tërheqë pjesërisht ose plotësisht akuzat kundër tyre.⁴¹⁸ Dhe në rastin “Tenk”, ku një ish-kryeministër u akuzua për përfitim shpërblimi dhe ndikim të paligjshëm në blerjen e një automjeti luksoz, ka pasur parashkrim të zbatimit të dënimit me burg.⁴¹⁹

Në fillim të vitit 2024, M-NAV – Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Maqedonisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit u përball me trazira. Punësime pa asnjë konkurs, duke favorizuar lidhjet politike, dhe më pas një grevë e udhëhequr nga kontrollorët e trafikut ajror. Ndërhyrja politike është përshkallëzuar dhe ka pasur një incident të shkeljes së barrierave të sigurisë dhe sulmit të kontrollorëve,⁴²⁰ i cili ka shkaktuar kërcënimin e një greve me ndalimin e fluturimeve.⁴²¹ Qeveria ka marrë masa urgjente, përfshirë shkarkimin e drejtorëve të M-NAV.⁴²² Kryeministri deklaroi se M-NAV ishte bërë një kompani familjare, duke përmendur shembuj të nepotizmit dhe kronizmit⁴²³ dhe kështu deklaroi se Eurocontrol dhe institucionet shtetërore vendase duhet të merren më seriozisht me këto çështje,⁴²⁴ dhe në të njëjtën kohë njoftoi një inspektim nga Inspektorati i Punës.⁴²⁵ Delegacioni i BE-së kërkoi hetime mbi pretendimet për nepotizëm dhe dhunë ndaj stafit që punon në M-NAV.⁴²⁶ Pastaj u emëruan drejtorë të rinj të M-NAV,⁴²⁷ dhe Agjencia e Aviacionit Civil kreu mbikëqyrje të jashtëzakonshme të M-NAV, e

418 “Ndryshimet në Kodin Penal me pasoja për lëndën “Imperia”, (Измените на Кривичниот законик со последици и врз предметот „Империа), TV Telma, 7 qershor 2024, <https://telma.com.mk/2024/06/07/izmenite-na-krivichniot-zakonik-so-poslediczi-i-vrz-predmetot-imperija/>.

419 “Gruevski shpëtoi nga burgju në lëndën Tank për blerjen e Mercedesit”, (Груевски се спаси од затворската казна за случајот „Тенк“ со набавката на Мерцедес), TV Telma, 30 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/30/gruevski-se-spasi-od-zatvorskata-kazna-za-sluchajot-tenk-so-nabavkata-na-mercedes/>.

420 “Ne navigojmë, ndërsa në korridor bërtitet dhe përleshet – si nuk qenka kërcënuar trafiku ajror?!“ Kontrollorët e trafikut ajror dëshmojnë për ndërhyrjen e bandës të Nezirit”, (Ние навигираме, а во ходникот викотници и тепачки – и како не бил загрозен авиосообраќајот?!“ Контролори на летање сведочат за упадот на бандата на Незири), Plus Info, 9 janar 2024, <https://plusinfo.mk/nie-navigirame-a-vo-hodnikot-vikotnici-i-tepachki-i-kako-ne-bil-zagrozen-aviosoobra-a-ot-kontrolori-na-leta-e-svedochat-za-upadot-na-bandata-na-neziri/>.

421 “Dikush nuk do të fluturojë – drejtorët ose aeroplanët”, (Некој нема да лета – директорите или авионите), Radio Evropa e Lirë, 9 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/nejkoj-nema-da-leta---direktorite-ili-avionite-/32767014.html>.

422 “Njëzëri shkarkohen drejtorët e M-NAV, drejtori i ri ekzekutiv Ilir Memedi”, (Едногласно разрешени директорите во М-НАВ, нов извршен Илир Мемеди), Kanal 5, 9 janar 2024, <https://kanal5.com.mk/kanal-5-doznava-ednoglasno-razresheni-direktori-vo-m-nav-nov-izvrshen-ilir-memedi/a620178>.

423 “Ministrat mohojnë të kenë ndikuar në punësimet e M-NAV”, (Министрите негираат дека влијаеле при вработувањата во М-НАВ), Deutsche Welle, 17 janar 2024, https://www.dw.com/mk/ministrite-negiraat-nepotizam-damkata-za-vrabotuvana-ta-vo-mnav-ostanuva/a-68007644?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

424 „Kovačevski: M-NAV është bërë kompani familjare, duhet ta marrim më seriozisht“, (Ковачевски: М-НАВ станала семејна фирма, треба посериозно да се позанимаваме со неа), Nezavisen.mk, 9 janar 2024, <https://nezavisen.mk/kovachevski-m-nav-esthte-bere-kompani-familjare-duhet-ta-marrim-me-seriozisht/>.

425 “Inspektorati shtetëror i punës do të kontrollonë sindikatat në M-NAV: “Ajo kompani është familjare, vëllai i Tasevskit punon atje, babai i tij ka punuar atje”, (Трудова ќе ги проверува синдикатите во М-НАВ: Таа фирма е семејна, брат му на Тасевски работи таму, татко му работел таму), A1 on, 10 janar 2024, <https://a1on.mk/macedonia/trudova-kje-gi-proveruva-sindikati-vo-m-nav-taa-firma-e-semejna-brat-mu-na-tasevski-raboti-tamu-tatko-mu-rabotel-tamu/>.

426 “Delegacioni i BE-së: Presim që autoritetet shtetërore të hetojnë pretendimet për nepotizëm në punësim në M-NAV”, (Делегација на ЕУ: Очекуваме државните власти да ги истражат наводите за кронизам во вработувањата во М-НАВ), 360 Stepeni, 9 janar 2024, <https://360stepeni.mk/delegatsija-na-eu-ochekuvame-drzhavnite-vlasti-da-gi-istrzhat-navodite-za-kronizam-vo-vrabotuvana-vo-m-nav/>.

427 “M-NAV ka udhëheqje të re – Milan Koraq kryetari i Bordit Drejtues”, (М-НАВ има ново раководство – Милан Кораќ претседател на Управниот одбор), Mkd.mk, 26 janar 2024, <https://mkd.mk/m-nav-ima-novo-rakovodstvo-milan-korak-pretседател-na-upravniot-odbor/>.

cila zbuloi një sërë shkeljesh të rënda dhe mosrespektim të dispozitave ligjore në fushën e sigurisë dhe vendosi 11 masa të detyrueshme për M-NAV, si dhe akuza për kundërvajtje dhe sanksione ndaj personit juridik dhe individëve.⁴²⁸ Sipas hetimit të Prokurorisë Publike, gjykata urdhëroi që autorët e sulmit të dhunshëm në M-NAV të vendoseshin nën arrest shtëpiak ose burg dhe të gjithë u arrestuan.⁴²⁹

Lidhur me hetimin lidhur me kontratën për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d lidhur me “Behtel dhe Enka”,⁴³⁰ Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK) tha se gjatë vitit të kaluar është administruar dokumentacion i gjerë, janë thirrur për t’u marrë në pyetje disa persona dhe ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Entin Shtetëror për Revizion. Megjithatë, hetimi ende nuk ka dhënë një rezultat përfundimtar sepse lënda është e gjerë, dhe vetëm një hetues është zgjedhur nga 20 në institucion.⁴³¹ Ndërkohë, është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore para Gjykatës Themelore në Prilep për të përcaktuar dëmet e mundshme që mund të shkaktohen nga ndërtimi i korridoreve, për njerëzit, për mjedisin dhe për objektet në afërsi, dhe është paraqitur një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese për të kundërshtuar kushtetutshmërinë e neneve të ligjeve të miratuara në mënyrë që të lejohet ndërtimi i korridoreve.⁴³²

Pas një hetimi të gjatë, PTHPNKOK ngriti aktakuzë kundër Kryetarit të Komunës së Strugës për blerjen e një makine luksoze në kurriz të Komunës së Strugës. Ai akuzohet për shpërdorim detyre dhe kompetencash sipas nenit 353 paragrafi 4 të Kodit Penal, i cili parashikon dënimin me burgim nga një deri në pesë vjet, nëse shpallet fajtor.⁴³³ Gjykata Themelore Penale Shkup deklaroi se gjykata ku është kryer krimi është kompetente. Prandaj, lënda u transferua në Gjykatën Themelore të Strugës.⁴³⁴

428 “Mbikëqyrja: 11 rekomandime të detyrueshme të sigurisë në M-NAV”, (Надзор: 11 задолжителни препораки за безбедноста во М-НАВ), Deutsche Welle, 25 janar 2024, https://www.dw.com/mk/vonreden-nadzor-seriozni-propusti-i-prekrsuvana-na-procedurite-za-bezbednost-vo-mnav/a-68069754?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

429 “Arrestohen të gjithë të dyshuarit për ndërhyrjen në M-NAV, një person u dënua me burg”, (Уапсени сите осомничени за упадот во М-НАВ, едно лице доби затворски притвор), Radio Evropa e Lirë, 18 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32782370.html>.

430 “Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e Korridorit 8 dhe 10 d, fillon realizimi i një prej projekteve më të mëdha infrastrukture”, (Потпишан договорот за изградба на Коридорот 8 и 10 д, започнува реализацијата на еден од најголемите инфраструктурни проекти), faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 mars 2023, <https://vlada.mk/node/32389>.

431 “Punohet në lëndën e mbikëqyrjes së “Behtel dhe Enka” – me një hetues, dhe një tufë dokumentesh”, (Се работи на предметот за надзорот над „Бехтел и Енка” – Со еден истражител, а куп документи), 360 Stepeni, 1 mars 2024, <https://360stepeni.mk/se-raboti-na-predmetot-za-nadzorot-nad-behtel-i-enka-so-eden-istrashitel-a-kup-dokumenti/>.

432 “Autostradat e “Behtel dhe Enka” ngecin edhe në gjykata”, (Автопатите на „Бехтел и Енка“ заглуваат и во судови), Evropa e Lirë, 3 qershor 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/avtopat-behtel-enka-ustaven-sud/32970462.html>.

433 “PTHPNKOK, pas një hetimi të gjatë, ngriti aktakuzë kundër Ramiz Merkos për blerjen e automjetit luksoz “Audi”, (ОЈО ГОКК по долга истрага поднесе обвинение против Рамиз Мерко за набавката на луксузното „ауди“), 360 Stepeni, 1 mars 2024, <https://360stepeni.mk/ojo-gokk-po-dolga-istraga-podnese-obvinenie-protiv-ramiz-merko-za-nabavkata-na-luksu-znoto-audi/>.

434 “Gjykata e Shkupit është deklaruar e papërshtatshme për aktakuzën kundër Ramiz Merkos, lënda i është përcjellë gjykatës në Strugë”, (Скопскиот суд се прогласи за ненадлежен за обвинението против Рамиз Мерко, предметот е препратен до судот во Струга), 360 Stepeni, 6 mars 2024, <https://360stepeni.mk/skopskiot-sud-se-proglasi-za-nenadlezhen-za-obvinenie-protiv-ramiz-merko-predmetot-e-prepraten-do-sudot-vo-struga/>.

Me iniciativë të KSHPK,⁴³⁵ u ngrit aktakuzë kundër Drejtorit aktual të Agjencisë për Rini dhe Sport, paraardhësit të tij, kreut të Komitetit Olimpik të Maqedonisë dhe nëntë personave të tjerë për kryerjen e krimeve të shpërdorimit të detyrës dhe neglizhencës në shërbim.⁴³⁶ Këta njerëz akuzohen se kanë injoruar kriteret për dhënien e fondeve sipas sistemit të kuponëve dhe u kanë dhënë në mënyrë të përsëritur kuponë sportivë në mënyrë të paligjshme që nga viti 2020 përdoruesve, federatave dhe klubeve të favorizuara në lidhje me individë, grupe dhe madje edhe parti politike.⁴³⁷ Procedura gjyqësore në këtë rast ka filluar dhe ndaj të pandehurve janë vendosur masa paraprake të pjesshme.⁴³⁸

435 “Paraqitet akuzë për ndarjen e kuponëve sportivë, për 12 persona kërkohen masa paraprake”, (Поднесено обвинение за распределбата на спортските ваучери, за 12 лица се бараат мерки на претпазливост), 360 Stepni, 30 prill 2024, <https://360stepni.mk/podneseno-obvinenie-za-raspredelbata-na-sportskite-vaucheri-za-12-litsa-se-baraat-merki-na-pretpazlivost/>.

436 “Mojsoski, Kaevski dhe Dimevski të akuzuar për shpërdorim të kuponëve sportivë”, (Мојсоски, Каевски и Димевски обвинети за злоупотреби со спортските ваучери), TV Telma, 30 prill 2024, <https://telma.com.mk/2024/04/30/mojsoski-kaevski-i-dimevski-obvineti-za-dodeluvaneto-na-sportski-vaucheri/>.

437 “Lidija Račević: Rasti i kuponëve ARS është specifik në shumë mënyra, ka një dëm prej mbi 5 milionë euro”, (Лидија Раичевиќ: Случајот со ваучерите на АМС е специфичен по многу нешта, има штета од над 5 милиони евра), Nezavisen.mk, 27 qershor 2024, <https://nezavisen.mk/lidija-raicevikj-sluchajot-so-vaucherite-na-ams-e-specifichen-po-mnogu-neshta-ima-shteta-od-nad-5-milioni-evra/>.

438 (Çështja “Kuponë Sportivë” – Mojsoski, Kaevski dhe Dimevski do të paraqiten në gjykatë, por do të mbajnë pasaportat e tyre», (Случај „Спортски ваучери” – Мојсоски, Каевски и Димевски ќе се јавуваат во суд, но ќе ги задржат пасошите), TV Telma, 10 maj 2024, <https://telma.com.mk/2024/05/10/sluchaj-sportski-vaucheri-mojsoski-kaevski-i-dimevski-ke-se-javuvaat-vo-sudot-no-ke-gi-zadrzhat-pasoshite/>.

Kuadri ligjor

Pas ndryshimit të Kodit Penal vitin e kaluar, i cili uli dënimet për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës dhe autoritetit” dhe “shoqërimit kriminal”,⁴³⁹ të cilat ndikuan në parashkrimin e lëndëve të shumta të korrupsionit të proflit të lartë, Grupi Blueprint për Reforma në Gjqësor vendosi të tërhiqet nga angazhimi i mëtejshëm në procesin e hartimit të Kodit të ri Penal. Arsyeya kryesore e tërheqjes është miratimi i këtyre ndryshimeve pa konsultim me grupin e punës që përgatit kodin e ri dhe pa konsultim të duhur me ekspertë, duke përdorur flamurin evropian. Masa pason tërheqjen e mëparshme të grupit Blueprint nga hartimi i Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë në Procedurën Civile, një masë që ata e konsiderojnë pjesë integrale të luftës kundër krimit dhe korrupsionit, por pretendojnë që po keqpërdoren për të krijuar një perceptim të rremë se pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme do të konfiskohet.⁴⁴⁰ Ministria e Drejtësisë i është përgjigjur këtij akti, duke pretenduar se procesi i hartimit të Kodit të ri Penal është plotësisht gjithëpërfshirës dhe transparent.⁴⁴¹ Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, ky Kod nuk është finalizuar apo miratuar.

Në gjysmën e dytë të shtatorit 2024, Ministria e Drejtësisë organizoi seancën e parë publike për fushat e Gjykatave të Apelit Shkup dhe Shtip për propozim-ligjin për Procedurën Penale.⁴⁴² Qëllimi i këtyre seancave dëgjimore publike është që gjyqtarët, prokurorët, avokatët, punonjësit e policisë dhe përfaqësuesit e sektorit civil nga të gjitha fushat e apelit të kontribuojnë në zgjidhjen e re ligjore që parashikon zbatimin e direktivave përkatëse të BE-së, si dhe eliminimin e mangësive të identifikuar në Ligjin në fuqi për Procedurën Penale.

Në mars 2024, u miratua Ligji për Zyrën e Rikuperimit të Pronave.⁴⁴³ Me të, rregullohet krijimi, kompetencat, struktura organizative dhe financimi i Zyrës së Rikuperimit të Pronave, bashkëpunimi me autoritetet dhe institucionet vendase, bashkëpunimi me vendet e huaja dhe baza elektronike të të dhënave të integruara. Parashikohet që zyra për rikuperimin e pronës të ndërmarë veprimtari të rëndësishme për marrjen e informacionit dhe të dhënave për gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave dhe përfitimeve të tjera pronësore ose pasurore nga veprat penale që lidhen me pastrimin e parave, terrorizmin, shoqërimin kriminal, shpërdorim e pozitës dhe autorizimit zyrtar, përvetësimin, marrjen dhe dhënien e rryshfetit, etj.

439 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 188/2023.

440 “Grupi Blueprint tërhiqet nga pjesëmarrja në përgatitjen e Kodit të ri Penal”, (Блупринт групата се повлекува од учеството во изработката на новиот Кривичен законик), faqja zyrtare në internet e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 9 tetor 2023, <https://mhc.org.mk/news/bluprint-grupata-se-povlekuva-od-uchestvoto-vo-izrabotkata-na-noviot-krivichen-zakonik/>.

441 “Grupi i Punës për përgatitjen e Kodit të ri Penal është i pavarur në punën e tij dhe deri më tani asnjë dispozitë nuk është ndikuar nga kryetari ose anëtarët”, (Работната група за изготвување на новиот Кривичен законик е самостојна во своето работење и до сега за ниту една одредба не е вршено влијание кај претседателот или членовите), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 9 tetor 2023, <https://pravda.gov.mk/vest/6604>.

442 “Debati i parë publik mbi propozim-ligjin për Procedurën Penale”, (Прва јавна расправа за предлог-Законот за кривична постапка), faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 19 shtator 2024, <https://pravda.gov.mk/vest/6742>.

443 Ligji për Zyrën për Rikuperimin e Pronës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 66/2024.

Në fillim të dhjetorit 2023, propozim-ligji për raportimin e mbrojtur dhe mbrojtjen e denoncuesve u botua në ENER.⁴⁴⁴ Me të parashikohet zgjerimi i fushës së raportimit të mbrojtur dhe i rrethit të personave që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje nga hakmarrja, si dhe racionalizohet fusha e subjekteve në sektorin publik dhe privat që kanë detyrimin të krijojnë një kanal për raportim të brendshëm të mbrojtur. Ky propozim-ligj u përgatit me qëllim tejkalimin e mangësive të Ligjit në fuqi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe pajtueshmërinë me Direktivën e BE-së 2019/1937.

Ministria e Punëve të Jashtme propozoi ndryshime në Ligjin për Masat Kufizuese që do të përfshijnë akte ligjore nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar si bazë për vendosjen e masave të tilla në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo iniciativë synon të zgjerojë gamën e masave dhe mjeteve kufizuese në dispozicion, duke shtuar korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës së bashku me terrorizmin dhe përhapjen e armëve.⁴⁴⁵ Propozimi pason një numër në rritje të zyrtarëve publikë të mëparshëm ose aktualë, përfshirë ish-prokurorin e posaçëm publik dhe kryetarin në detyrë të Komunës së Karposhit dhe familjet e tyre që u vendosën në “listën e zezë” të SHBA.⁴⁴⁶

Për të luftuar korrupsionin në vendkalimet kufitare, Këshilli Kombëtar për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit propozoi një ndryshim në Ligjin për Policinë Kufitare. Këto ndryshime do të përfshijnë testimin poligrafik për oficerët e kontrollit kufitar si një masë anti-korrupsion. Testimi do të kryhej nga një institucion i pavarur, dhe nëse testi nuk kalon, do të rezultojë në shkarkim të menjëhershëm, pasuar nga një hetim shtesë nga Prokuroria Publike.⁴⁴⁷

⁴⁴⁴ Ministria e Drejtësisë, “Propozim-ligji për raportimin e mbrojtur dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, (Нацрт-Закон за заштитено пријавување и заштита на укажувачи), ENER, 1 dhjetor 2023, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&sub-item=view_reg_detail&itemid=74474.

⁴⁴⁵ “Lista e zezë amerikane “ do të bëhet baza e sanksioneve në vend”, (Американската „црна листа“ ќе стане основ за санкции и во земјава), 360 Stepeni, 11 janar 2024, <https://360stepeni.mk/amerikanskata-tsarna-lista-ke-stane-osnov-ov-za-sanksii-i-vo-zemjava/>.

⁴⁴⁶ “Katica Janeva dhe Stevço Jakimovski të vendosur në “ listën e zezë “ të Shteteve të Bashkuara”, (Катица Јанева и Стевчо Јакимовски ставени на „црната листа“ на САД), 360 Stepeni, 18 mars 2024, <https://360stepeni.mk/katitsa-janeva-i-stevcho-jakimovski-staveni-na-tsarnata-lista-na-sad/>.

⁴⁴⁷ “Testimi poligrafik i rojeve kufitare propozohet si masë në luftën kundër korrupsionit”, (Се предлага полиграфско тестирање на граничните службеници како мерка во борбата против корупцијата), 360 Stepeni, 6 mars 2024, <https://360stepeni.mk/se-predlaga-poligrafsko-testirane-na-granichnite-sluzhbenitsite-kako-merka-vo-borbata-protiv-korupsijata/>.

Lufta e suksesshme kundër korrupsionit dhe progresit kërkon ndjekjen e rekomandimeve të KE-së;

Ekziston nevoja për të përmirësuar dinamikën e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Luftimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit;

Zbatimi i rekomandimeve të GRECO-s është thelbësor, siç është sigurimi i burimeve të mjaftueshme për KSHPK dhe PTHPNKOK, duke përfshirë pavarësinë financiare, për të siguruar llogaridhënie efektive për rastet e korrupsionit të lartë;

Është e nevojshme të forcohen përpjekjet e institucioneve kompetente për parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit në prokurimin publik, si dhe të theksohet përgjegjësia e të gjitha institucioneve publike për zbatimin e ligjshëm të tenderëve dhe për shpenzimin efektiv dhe efikas të parave publike përmes procedurave të prokurimit publik.

Kërkohej miratimi i Kodit të ri Penal, i cili duhet të përmbajë dispozita të përshtatshme për angazhimin për të luftuar korrupsionin, përfshirë korrupsionin e profilit të lartë;

Është e nevojshme të përmirësohet kuadri ligjor për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe zbatimi i qëndrueshëm i tij.



3. Të drejtat themelore



Në përgjithësi, në fushën e të drejtave themelore, nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën raportuese.

Raporti i vitit të kaluar i KE për vendin vuri në dukje se korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore në Maqedoninë e Veriut është pjesërisht në përputhje me ligjin e BE dhe standardet e të drejtave themelore. Ndërsa vendi në përgjithësi përmbush angazhimet e tij të përgjithshme në këtë fushë, ka nevojë për zbatim më sistematik të ligjit. Sipas rekomandimeve të vitit të kaluar, ekziston nevoja për të korigjuar kushtet nën standarde të burgut, për të intensifikuar përpjekjet për të inkurajuar masa alternative ndaj dënimeve me burg dhe për të zbatuar rekomandimet përkatëse për kushtet e paraburgimit. Për më tepër, ekziston një nevojë urgjente për të alokuar burime bazë për Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) dhe për të siguruar zbatimin e duhur të Ligjit për Gjendjen Civile për të eliminuar pashtetësinë.⁴⁴⁸

Përveç kësaj, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2023 gjithashtu zbuloi se nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në këtë fushë gjatë vitit të kaluar. Në të theksohen problemet në fusha të ndryshme, të tilla si kufizimet në lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke përfshirë dhunën dhe kërcënimet për dhunë ndaj gazetarëve, si dhe dhunën dhe kërcënimet për dhunë të drejtuar ndaj personave lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë ose interseksualë (LGBTI). Megjithatë, thuhet se qeveria ka ndërmarrë vetëm hapa të kufizuar për të identifikuar dhe ndëshkuar personat që kanë shkelur të drejtat e tyre njerëzore.⁴⁴⁹

⁴⁴⁸ Komisioni Evropian, “Dokumenti i punës i Komisionit – Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2023”.

⁴⁴⁹ Departamenti Amerikan i Shtetit “Raporti vjetor mbi situatën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023”.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut

Gjatë vitit 2023, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) vendosi për 393 kërkesa kundër Maqedonisë së Veriut, prej të cilave 368 u refuzuan ose u shpallën si të papranueshme. Gjykata dha 11 aktgjykime në 25 lëndë, duke konstatuar shkelje të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁴⁵⁰ Në shtatë muajt e parë të vitit 2024, GJEDNJ vendosi për 92 kërkesa kundër Maqedonisë së Veriut.⁴⁵¹

Në gjysmën e parë të vitit 2024, Byroja për Përfaqësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së publikoi Raportin vjetor për punën e saj në vitin 2023,⁴⁵² në të cilën u deklarua se këtë vit numri i kërkesave të paraqitura në GJEDNJ kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut shënon trend realitivisht stabil, ndërsa numri i kërkesave kundër shtetit pas të cilit është marrë një vendim është rritur për 26 aplikime. Raporti tregon se, si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2023 ky numër është mbi mesataren evropiane sipas indeksit të aplikimeve të paraqitura për 10 mijë banorë, që është 2.00 në vend dhe 0.54 në nivel evropian.⁴⁵³ Njëkohësisht është publikuar edhe Raporti Vjetor për punën e Komisionit Ndërinstitucional për Zbatimin e Vendimeve të GJEDNJ për vitin 2023.⁴⁵⁴

Në rastin e Memedovës dhe të tjerëve kundër Maqedonisë së Veriut, u konsoliduan tre ankesa të ndryshme në lidhje me incidentet në kufirin shtetëror, kur aplikantëve të etnisë rome iu ndalua të largoheshin nga vendi. Ato akuza për diskriminim nga rojet kufitare dhe shkelje të lirisë së tyre të lëvizjes për shkak të përkatësisë së tyre etnike⁴⁵⁵, pas së cilës GJEDNJ konfirmoi shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të GJEDNJ, ashtu dhe individualisht në lidhje me nenin 14.⁴⁵⁶

Më 14 nëntor 2023, GJEDNJ vendosi për rastin e Janakieski kundër Maqedonisë së Veriut, në të cilin iu referua paligjshmërisë dhe arbitraritetit të pretenduar në ndalimin e ish-ministrit të Transportit. Ai deklaroi se nuk kishte arsye relevante dhe të mjaftueshme për privimin e tij nga liria dhe se ndalimi i tij nuk ishte rishqyrtuar menjëherë, në kundërshtim me nenin 5 të KEDNJ. GJEDNJ konstatoi shkelje për arsye të pamjaftueshme për ndalimin e ish-ministrit dhe për shkak të shqyrtimit me vonesë të masës së paraburgimit.⁴⁵⁷

450 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut – Përmbledhje e shkurtër e Shtetit (2024), https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/CP_Republic_of_North_Macedonia_ENG#:~:text=The%20Court%20dealt%20with%20314,European%20Convention%20on%20Human%20Rights e hapur në 15 tetor 2024.

451 Ibid.

452 Ministria e Drejtësisë, “Raporti vjetor për punën e Byrosë së Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së për vitin 2023”, 2024, <https://bit.ly/48SsGTF>.

453 Ibid.

454 Ministria e Drejtësisë, “Raporti vjetor për punën e Komisionit ndërmintor për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së për vitin 2023”, 2024, <https://bit.ly/4erSwPJ>

455 “Romët marrin vendim historik evropian që dënon profilizimin racor në kufijtë e Maqedonisë së Veriut”, (Roma win landmark European judgement condemning racial profiling at the border in North Macedonia), faqja zyrtare e Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR), 30 tetor 2023, <http://www.errc.org/press-releases/roma-win-landmark-european-judgment-condemning-racial-profiling-at-the-border-in-north-macedonia>.

456 GJEDNJ, “Çështja e Memedovës dhe të tjerëve kundër Maqedonisë së Veriut”, (Случај Мемедова и други против Северна Македонија), Kërkesa nr. 42429/16 dhe dy të tjera, 18 tetor 2023, <https://bit.ly/3vDZYGJ>.

457 GJEDNJ, “Çështja Janakieski kundër Maqedonisë së Veriut”, (Случај Јанакиески против Северна Македонија), Kërkesa nr. 57325/19 dhe 16291/20, 14 nëntor 2023, <https://bit.ly/48ZNUOp>.

Në fillim të vitit 2024, GJEDNJ vendosi për rastin e Peshovit dhe Ristovskit kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me shpjegimet joadekuat në vendimet e gjykatave vendase që përcaktojnë paraburgimin e kërkuarve dhe disa mangësi procedurale në procedimin e çështjes. Këto veprime rrjedhin nga dy procedime penale në lidhje me incidentin e 27 prillit 2017, kur një grup protestuesish hynë në ndërtesën e Kuvendit.⁴⁵⁸ GJEDNJ vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5 (3) dhe (4) të GJEDNJ në lidhje me dy kërkuarët.⁴⁵⁹ Për më tepër, GJEDNJ dha një aktgjykim të ngjashëm në rastin e Vasilevskit kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me mungesën e procedurave kontradiktore në një pjesë të procedurave penale për të njëjtin incident më 27 prill 2017.⁴⁶⁰

Në shkurt të vitit 2024, GJEDNJ dha një vendim në çështjen Zhezhovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me arbitraritetin në vendimmarrjen e gjykatave vendase në procedurat për kundërzbatim, gjë që është në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ.⁴⁶¹

